


# Gjuha shqipe dhe leximi

5



Për klasën e pestë të arsimit fillor nëntëvjeçar

**Botues:**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
Rr. Mito Haxhi - Vasilev Jasmin p.n. Shkup

**Recenzues:**

Dr. Ismet Osmani - kryetar  
prof. Ibe Mustafa - antare  
Merita Koxhaxhiku - Kolçi - antare

**U shtyp në shtypshkronjën:** Evropa 92, Koçan

**Tirazhi:** 1.642 kopje

Me vendim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës të R. të Maqedonisë nr. 22-2402/ 1 të datës 26.04.2010, ky liber lejohet në përdorim.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

RUSTEMI, Xhezmi

Gjuha shqipe dhe leximi për klasën e pestë të arsimit fillor nëntëvjeçar /  
Xhezmi Rustemi, Resul Bekteshi. - Shkup : Ministria e Arsimit dhe Shkencës e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2020. – 146 стр. : илустр. во боја ; 26 см


ISBN 978-608-226-417-2

1. Bekteshi, Resul [автор]

COBISS.MK-ID 111811850



5



# GJUHA SHQIPE DHHE LEXIMI

# FUSHAT PROGRAMORE

NJOHIM GJUHËN TONË



LEXIM, LETËRSI

POEZI  
PROZË

## TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA



## KULTURA E MEDIËS

# AKTIVITETE



Vëmendje duhet t'i kushtohet pasurimit të fjalorit të nxënësve, sidomos me fjalë të fondit të përgjithshëm dhe përdorimi i tyre në jetën e përditshme.



Ky aktivitet u jep mundësi nxënësve të ndalen dhe të analizojnë me vëmendje përmbajtjen e tekstit, të dallojnë ngjarjet kryesore nga ato të dorës së dytë.



Këtu kërkohet që nxënësi të thellojë njohuritë e fituara, ti mbajnë në mend ato dhe t'i zbatojnë ato në praktikë.



Pas kryerjes së çdo aktiviteti, nxënësve u jepet detyrë, e cila do t'i thellojë, përfocojë dituritë e fituara...  
Të krijojë shprehi pune se detyrat duhet kryer.



Përmes këtij aktiviteti nxënësit orientohen drejt problemeve konkrete që lidhen me kuptimin e përmbajtjes së teksteve. Kjo kërkesë synon që nxënësi të thellohet në analizën e tekstit të lexuar.



Ky aktivitet aftëson nxënësit të lexojnë tekste letrare dhe joletrare, në pajtim me kërkesat e programit. Të ushtrojnë që të përsosin teknikën e leximit në heshtje dhe me zë.



Ky aktivitet kërkon nga nxënësit që të paraqesin me shkrim aspektet e ndryshme të jetës së tyre të përditshme, të shkruajnë porosi, njoftime, kërkesa, lutje, lajmërim, urime, letra etj.



Ky aktivitet kërkon nga nxënësit që të mësojnë atë që është qenësore, - thelbësore si p.sh. Gjuhë, letërsi, art, kultur etj.

# PËRMBAJTJA

## MODULI - 1.....10-11

1. Sytë e shkollës (Kalosh Çeliku).....	12-13
2. Ftesë për lexim .....	14-15
3. <b>Gjuha si mjet komunikimi .....</b>	<b>16-17</b>
4. Ti shkollë (Rami Tuda) .....	18-19
5. Mësuesi i sëmurë (Edmondo de Amicis).....	20-21
6. <b>Fjalët e ndryshueshme dhe të pa ndryshueshme .....</b>	<b>22</b>
7. Të shprehurit me shkrim .....	23
8. Mëmëdheu (A.Z. Çajupi) .....	24-25
9. Të shprehurit me shkrim .....	26
10. Fjalë të urta.....	27
11. Fjalët e qiririt (Naim Frashëri) .....	28-29
12. <b>Emrat e përvetëshëm dhe të përgjithshëm .....</b>	<b>30</b>
13. Plaku Zemërbardhë (Arif Demolli).....	31-32
14. <b>Emrat konkretë dhe abstraktë .....</b>	<b>33</b>
15. I pasuri dhe i varfëri (D. Bobani).....	34-35
16. Ne jemi (Fejzi Bojku).....	36-37
17. <b>Rasat e emrit .....</b>	<b>38-39</b>
18. Letra e parë ( Ibrahim Islami).....	40-41
19. Kurbeti (Xheladin Muça).....	42
20. <b>Lakimi i emrit.....</b>	<b>43-45</b>
21. Luli i vocër (Migjeni).....	46-47

## MODULI - 2.....48-49

22. <b>Mbiemrat cilësorë dhe marrëdhënior.....</b>	<b>50-51</b>
23. Në bibliotekë (Nexhat Zekirija ).....	52-53
24. Halili dhe Hajria (Kolë Jakova).....	54-56
25. Në liqenin e Ohrit (Esad Mekuli).....	57
26. Shkruajmë tekst .....	58-59
27. <b>Përemrat vetorë.....</b>	<b>60</b>
28. <b>Përemrat dëftorë.....</b>	<b>61</b>
29. Sa është ora xhaxha (Qamil Batalli).....	62-63
30. Në Manastir.....	64
31. Në kurs të gjuhës .....	65
32. Dëllinja e Skënderbeut (Abdylazis Islami).....	66-68
33. Komunikim me gojë .....	69
34. <b>Përemrat pyetës.....</b>	<b>70</b>
35. Imam efendiu (Ali Asllani).....	71
36. Këndezi, Pula apo veza (Nonda Bulka).....	72-73
37. Libri mbi princin e lumtur (Ibrahim Kadriu).....	74-76
38. <b>Folja, kuptimi mbi të.....</b>	<b>77</b>
39. Gjinkalla dhe miz'e dheut (Fabul).....	78-79



MODULI - 3.....80-81

40. <i>Ushtrime në klasë (Folja)</i> .....	82
41. Gjëegjëza.....	83
42. O sa bukur o sa mirë (Naim Frashëri).....	84-85
43. Pasuria më e çmuar (Dionis Bubani).....	86-87
44. Muji dhe zanat (Legjendë popullore).....	88-90
45. <i>Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë</i> .....	91
46. <i>Fjalia e përbërë</i> .....	92
47. Mëma ( Asdreni).....	93-94
48. Armiku i vjetër, Ujku delengrënës ( Rexhep Hoxha ).....	95-97
49. <i>Fjalët me kuptim Antonimik, Sinonimik dhe Homonimik</i> .....	98
50. Mëngjesi ( Omar Khami ).....	99
51. Kënga me lot ( K. Çeliku ).....	100-101
52. <i>Fjalët me kuptim zvogëlues dhe përkëdhelës</i> .....	102
53. Më fal kanarinë (V. Podgorec ).....	103-105
54. Përgjerimi për jug (K. Miladinov).....	106-107
55. <i>Ligjerata e drejtë dhe e zhdrejtë</i> .....	108
56. Macja e preferuar e padronës së shtëpisë ( Xhonatan Suift).....	109
57. Kultura e medias (Radioja, TV,etj.).....	110
58. <i>Pikësimi në ligjeratën e drejtë</i> .....	111

MODULI - 4.....112-113

59. Si e gjete folenë moj dallëndyshe (Adelina Mamaqi) .....	114-116
60. <i>Përdorimi i shkronjës së madhe</i> .....	117
61. Gabojnë prindërit ( Luigj Pirandello ).....	118-119
62. Nënë e madhe e kësaj bote ( Vitore Leka ).....	120-121
63. Festa e shkollës ( Agim Beqaraj ).....	122
64. <i>Shenjat e pikësimit</i> .....	123
65. Ideja mbi artin filmik.....	124
66. Prendvera (Ndre Mjeda).....	125
67. Për ditën e festës ( Ramadan Zeneli ).....	126-127
68. Njeriu mëson nga e bukura ( Rifat Kukaj ).....	128-129
69. <i>Përdorimi i pikës</i> .....	130
70. <i>Pikëpyetja dhe pikëçuditja</i> .....	131
71. Pal Golemi e Nik Peta ( Gavriil Dara -i Riu ).....	132-134
72. <i>Përdorimi i presjes</i> .....	135
73. Një letër dhe diçka tjetër ( A. Demolli).....	136-137
74. Bota do të jetë një (Adem Gajtani).....	138-139
75. Pulëbardha (Dritëro Agolli).....	140-141
76. <i>Përdorimi i drejtë i shkurtesave</i> .....	142
77. Mesazhi në celularë ( Viron Kona ).....	143-145





## MODULI - 1



1. Sytë e shkollës
2. Ftesë për lexim
3. *Gjuha si mjet komunikimi*
4. Ti shkollë
5. Mësuesi i sëmurë
6. *Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme*
7. Të shprehurit me shkrim
8. Mëmëdheu
9. Të shprehurit me shkrim ( ritregim)
10. Fjalë të urta
11. Fjalët e qiririt
12. *Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm*
13. Plaku Zemërbardhë
14. *Emrat konkretë dhe abstraktë*
15. I pasuri dhe i varfëri
16. Ne jemi
17. *Rasat e emrit*
18. Letra e parë
19. Kurbeti
20. *Lakimi i emrit*
21. Luli i vocërr





Shkolla e fshatit si një zgjua bletësh rrinte në kodrinë. Fytyrën e kishte kthyer nga dielli, ndërsa derën nga fshati. Rreth e rrotull i rrinin në këmbë disa pemë.

Një zog fluturoi me një këngë dhe u ndal në dritare. Në klasë pa mësuesin dhe nxënësit duke lexuar një tregim në “Fatosi”. E zgjati kokën të shohë, mirëpo e zuri xhami. Zogu u habit me këtë dorë të tejdukshme që rrinte në mur të shkollës.

-Kush je ti që s’më lë të hyj në klasë?-pyeti zogu

-Unë-dëgjoj një zë të ulët.

-Po,po,ti!-i tha zogu me zë më të lartë.

-Unë jam dritarja e shkollës.

Ih!-qeshi me ironi zogu. -Dritarja e shkollës ! Gjithë ditën e gjatë rri e s’bën asnjë punë.

-Kush?-pyeti dritarja,-Unë?

-Ti,ti!Edhe motrat e tua!

-Nuk është ashtu, zog!

Unë jam mjaft e nevojshme për shkollën.

Pa ne, a e sheh këtë mësues me nxënës, nuk do shkruanin e lexonin asnjë shkronjë.

Që të bindesh edhe vetë, qe po të jap një shembull.Mbylli sytë, o zog!

-A më sheh mua?

-Jo,nuk shoh asgjë,vetëm terr.

-Hapi tash sytë!Hë, më thuaj,ç’rëndësi kanë sytë për trupin tënd?

-Ju dritaret qenkeshit sytë e shkollës?!

-Po,po.Sytë e shkollës.

-Më fal, oj dritare!Nga mosdija bëra një gabim.-Dhe para se të fluturojë, tha:- Ju jeni jo vetëm sytë e shkollës, por edhe të fshatit...



### FJALOR

*dorë e tejdukshme* - dorë e nëpërdukshme që lejon të shihet nëpër të  
*ironi* - figurë stilistike që përqesh a e vë në tallje dikë apo diçka  
*qenkëshit* - folja jam  
*mosdija* - padituria



### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Ku ishte vendosur shkolla, përshkruaje atë?
- Kush u afrua te dritarja?
- Pse zogju nuk hyri brenda, kush e pengoi?
- Përshkruani dialogun zog-dritare?
- Pse ishin të nevojshme dritaret për shkollën?
- Ç' tha zogju kur e kuptoi rëndësinë e dritares?



### KOMENTOJMË

Gjatë orës së mësimet, fjalët e fundit të zogut:  
”Më fal, oj dritare! Nga mosdija bëra një gabim,-dhe para se të fluturojë tha:  
-Ju jeni jo vetëm sytë e shkollës, por edhe të fshatit.



### DETYRË

Në fletoret për detyrë shtëpie shkruani kuptimin e tekstit në pika të shkurtëra.



### TË MBAJMË MEND

Dialogu është biseda që zhvillohet ndërmjet dy ose më shumë personave. Është karakteristikë e gjinisë letrare të dramatikës. Llojet e dramatikës janë: **drama**, **tragjedia** dhe **komedia**.

# FTESË PËR LEXIM

## Ushtrime gojore - Komunikim me gojë

Sa lexon ? Çfarë lexon ? Kur lexon ? Pse lexon ? (Secili nxënës përgjigjet)

1 *Sa libra lexon gjatë një viti kalendarik ?*

↓  
një

↓  
dy

↓  
tre

↓  
katër

↓  
pesë

↓  
më shumë se pesë



2 *Çfarë librash lexon më shumë*

fantastik

legjenda

drama

përralla

komedi

Poezi

ndonjë lloj  
tjetër

3 *Pse lexon libër me atë përmbajtje ? Sepse*

- a) është më interesant
- b) i dua përrallat
- c) kënaqem me heroizmin e trimave
- d) më pëlqen poezia
- e) dëshiroj të imagjinoj veten në role...
- f) fantazia është interesante dhe e bujshme.

4 *A lexon gazetë a revistë dhe trego cilën ?*

Po →

Jo

5 *A vijnë në shtëpinë tënde ndonjë gazetë a libër ?*

Po →

Jo

6 *Librin e lexon pse dikush të detyron apo e lexon nga dëshira jote ?*

a) *i detyruar nga*

mësuesi

prindi

shoku

b) *nga dëshira për lexim*

7 *Sa herë në muaj shkon në bibliotekën e shkollës ose të qytetit për të marrë libra ?*

1 herë

2 herë

asnjëherë

8 *Si mendon a është i dobishëm leximi ?*

Po

Jo

9 *Cila është porosia jote për shokët / shoqet ?*

- a) Të lexojnë më tepër !
- b) Të lexojnë vetëm për një notë pozitive !
- c) Të mos lexojnë fare !
- ç) Të lexosh më shumë domethënë
  - a) të pasurosh mendjen
  - b) të fitosh dhembje koke.




# GJUHA SI MJET KOMUNIKIMI

Njohim gjuhën tonë



Gjuha është mjeti më i rëndësishëm dhe më i përsosur që njerëzit e përdorin në komunikim. Me anë të gjuhës, njerëzit çdo ditë pranojnë ose japin informata, pra kryejnë nevojat e tyre të përditshme.



Komunikimi mes njerëzve më shpesh kryhet me anë të gjuhës dhe ka këtë ecuri:



Kur pranuesi i mesazhit e kthen përgjigjen, atëherë ndërrohen edhe funksionet, pra pranuesi bëhet dërgues, kurse dërguesi bëhet pranues i mesazhit. Komunikimi realizohet me anë të tingujve, dritave, flamujve, do të thotë me anë të sinjaleve. P.sh. Çfarë tregojnë këto shenja?



Komunikimi mund të realizohet edhe me anë të shenjave, siç janë:

## Shenjat e pikësimit



Shenjat me mimikë e gjeste



Shenjat hartografike



## TË MBAJMË MEND




Gjuha është e folur dhe e shkruar.  
Gjuha e folur përdor tingujt e të folurit, kurse gjuha e shkruar përdor shkronjat.



## USHTRIME

Bisedoni rreth ilustrimeve,  
çka tregojnë ato?



*Përgjigjuni: Cilat janë sinjale, cilat janë shenja dhe cilët janë tregues.  
\*Në bazë të tabelave të lartshënuara\*.*

## MËSOJMË



- a- Treguesit janë shenja që nuk i drejtohen kurrkujt, por që tregojnë diçka.
- b- Sinjalet u drejtohen njerëzve dhe shërbejnë për marrëveshje.
- c- Shenjat janë figura, vizatime, tinguj që u drejtohen njerëzve dhe tregojnë diçka.

## DETYRË



Me mësuesen/mësuesin mundohuni të dilni nga klasa në natyrë, në rrugë ose diku tjetër, gjeni, vështroni dhe dalloni sinjalet, gjestet, shenjat dhe treguesit, gjithnjë sipas shembullit të dhënë më lart.

Këngën e zogjve,  
gjuhët e luleve,  
i di vetëm ti,  
burim që etjen shuan  
melhem që lëngatën e ndal,  
bar që zjarrminë e zhduk.  
Ti fluturimin ua mëson  
dallëndysheve...  
Lulet, bimët i mëson  
si të rriten  
si të ngrihen  
si të mplaken,  
si të shërohen  
si të vdesin.  
Ti i di të gjitha gjuhët  
dhe shkrimet  
alfabetët e popujve,  
urtitë e gjithësisë  
ndaj njësoj të duan  
zogjtë e Ballkanit,  
të Evropës,të Amerikës,  
të Azisë,të Afrikës,  
të Australisë,  
të tërë botës,  
.....

Prandaj akëcili të do  
si bukën, si ujin,  
si zjarrin, si ajrin,  
si dritën,si diellin,  
si rritën,si jetën,  
si gjakun  
se je burim i diturisë.



## FJALOR

**lëngatën** - dhembjen, lëngimin

**akëcili** - të gjithë, gjithsecili,

**rritën** - rriten,ngriten.



### BISEDË RRETH POEZISË

- Kujt i drejtohet poeti me këto vargje?
- Çka fiton nxënësi në shkollë?
- Pse shkolla i di të gjitha alfabetet dhe shkrimet?
- Cilët janë ata që duan shkollën?



### KOMENTOJMË

Së bashku me mësuesin/mësuesen përgjigju se çfarë do të thotë poeti me vargjet:

“Ndaj njësoj të duan  
zogjtë e Ballkanit,  
të Evropës, të Amerikës,  
të Azisë, të Afrikës,  
të Australisë-të tërë botës”

### MËSOJMË



Poeti në këtë poezi me mjeshtëri ka përdor figurën e krahasimit. Këtë e vërejmë në vargjet:

“ Prandaj akëcili të do  
si bukën, si ujin,  
si zjarrin, si ajrin...”

**Gjeni këtë figurë në vargjet tjera stilistike.**



### DETYRË

Vjershën mësoni ashtu që do të ndaheni në 3 grupe dhe çdonjëri prej tyre merr nga një pjesë:

1. deri te vargu : si të vdesin,
2. deri te vargu : të tërë botës
3. pjesën e fundit.

### SHËNIM



Në klasë recitoni sipas grupeve: 1,2,3 dhe përsëri 1,2,3...

### **Komunikim dhe shkrim**

Shkruani një hartim të shkurtër me temë:  
“ Shkolla, burim i diturisë”.



Dje pasdite, kur dola nga shkolla, shkova ta shoh mësuesin tim të sëmurë. Është sëmurë nga puna e tepërt. Pesë orë mësimi në ditë, pastaj një orë gjimnastikë, pastaj dy orë të tjera në shkollën e natës, çka do të thotë të flesh pak, të hash shpejt e shpejt dhe të të çirret zëri nga mëngjesi deri në mbrëmje dhe në këtë mënyrë ka shkatërruar shëndetin e tij.

Kështu thotë ime ëmë. Nëna ime më priti te dera, u ngjita vetëm dhe shkallëve ndesha mësuesi me mjekrën e madhe të zezë, Koatin ai që i frikëson të gjithë nxënësit dhe nuk ndëshkon asnjërin; më shikoi me sy të habitur dhe bëri zërin si të luante, duke u tallur, por pa qeshur. Unë qesha derisa arrita në katin e katërt dhe i rashë ziles, por menjëherë pastaj u trishtova kur më priti shërbëtorja në një dhomë të varfër, gjysmë të errët ku ndodhej ratë mësuesi im. Ishte shtrirë në një shtratë të vogël hekuri; ishte bërë i parruar. Vuri njërën dorë në ballë për të shikuar më mirë dhe klithi me zërin e tij të dashur:

- Oh, Enrik!

U afrova pranë shtratit, mësuesi ma vuri njërën dorë mbi shpatull e tha:

-Të lumtë, o bir! Ke bërë mirë që ke ardhur të shohish mësuesin tënd të ngratë. Siç po sheh, Enriku i dashur, më ka lodhur mjaft sëmundja. Ç'kemi të re nga shkolla? Si janë shokët? A është çdo gjë në rregull edhe pa mua? A është e vërtetë që mund t'ia dilni pa mua fare mirë në krye edhe pa mësuesin e vjetër.

...Fillova të shikojë disa fotografi që ndodheshin në mure.

-A po i sheh, më tha, janë të gjithë nxënësit e mi të dikurshëm, të cilët më kanë dhënë fotografitë e tyre para mëse njëzet vitesh, çuna të mirë! Këto janë kujtimet e mia.

Kur të vdes,shikimin tim të fundit do ta hudh aty, mbi të gjithë këta çapken, në mes të të cilëve kam kaluar jetën time.Edhe ti do të më japësh fotografën tënde kur ta kryejsh filloren,a nuk është ashtu?-Pastaj mori një portokall nga komodina dhe ma lëshoi në dorë.

-Nuk kam tjetër ç'të të jap,-tha,-është dhuratë e një të sëmuri.E shikoja dhe, nuk e di se pse,një trishtim ma kishte pushtuar zemrën.-Shiko...-foli përsëri,- shpresoj që do të bëhem më mirë,por nëse nuk shërohem më...kij kujdes të forcohesh në aritmetikë se në atë lënd je i dobët;përpiqu pak; e tërë puna është te përpjekja e parë, sepse shpeshherë nuk është se na mungon aftësia, por formojmë një paragjykim të gabueshëm ose si thuhet një ide fikse që nuk jemi të zotët.-Ndërkaq merrte frymë me vështirësi; shihej që vuante.

-Kam ethe të tmerrshme,-fshani-jam me një këmbë në varrë.Po të porosis,pra.Tërë kujdesin kushtoja aritmetikës,problemeve.Shko tani.Përsëritet nënën.Mos iu ngjit më këtyre shkallëve,do të shihemi përsëri në shkollë.Por, në mos u pafshim,kujtoje ndonjëherë mësuesin tënd të klasës, i cili të ka dashur.

-Kur m'i tha këto fjalë,më erdhi të qaj.

-Ule kryet,-më tha.

-Ula kryet deri te jastëku; mësuesi më puthi në flokë.Pastaj më tha:

-Shko!-dhe e ktheu fytyrën nga muri.

Fluturova shkallëve teposhtë,sepse kisha nevojë ta përqafoj nënën.



### FJALOR

*shkolla e natës* - kurs për të kryer shkollimin fillor,  
*aritmetikë* - matematikë  
*paragjykim* - paramendim (mendim i padrejtë)  
*ethe* - dridhje nga zjarrmi



### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Ku shkoi Enriku pasdite?
- Pse ishte shkatërruar shëndeti i mësuesit,shkruaj arsyet?
- Çka i tha mësuesi Enrikut kur e pa?
- Çka shihte Enriku në mur?
- Cila ishte këshilla që mësuesi ia dha Enrikut?
- Pse mësuesi kur e puthi Enrikun e ktheu fytyrën nga muri?



### KOMENTOJMË

Pasi ta keni lexuar tregimin në klasë komentoni tekstin sipas këtij plani:

Takimi Enriku-mësuesi.

Biseda rreth shkollës dhe fotografive.

Ndarja ose përshëndetja e fundit me mësuesin.



### DETYRË

Shkruani hartim me temë:

“Mësuesi/mësuesja prindi im i dytë”.

# FJALËT E NDRYSHUESHME DHE TË PANDRYSHUESHME

Njohim gjuhën tonë

## Lexoni me vëmendje tekstin

Gjithçka e tij ishte e bardhë. Edhe mjekra. Edhe mustaqet. Edhe flokët. Edhe plisi. Edhe tufa e deleve. Edhe shtëpiza. Edhe... Por më e bardhë ndër të gjitha ishte zemra e tij. Vërtet atë nuk ia kishte parë askush. Por tjetër nuk mund të kishte ai, i cili tërë jetën ishte përpjekur që çdo gjë rreth tij të ishte e bardhë si qumështi që milnin për drekën baritore.



Në fragment kemi disa fjalë që e ndryshojnë formën gjatë përdorimit në fjali. Të tilla janë: ishte, është, jam, e bardhë, të bardha, mjekra, mjekrën, mustaqet etj. Këto i quajmë **fjalë të ndryshueshme**. Por në tekst gjinden edhe disa fjalë të tjera që nuk e ndryshojnë formën. Të tilla janë: edhe, por, më, si, që, për etj. Këto i quajmë **fjalë të pandryshueshme**.



## TË MBAJMË MEND

Fjalët që ndryshojnë formën gjatë përdorimit në fjali i quajmë **pjesë të ndryshueshme**. Fjalët që nuk e ndryshojnë formën kur i përdorim në fjali të tjera i quajmë **fjalë të pandryshueshme**. Të ndryshueshme janë: emri, mbiemri, përemri, nyja, folja dhe numërori. Të pandryshueshme janë: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrat.

## USHTRIME

- Në tekstin e lartshënuar, gjeni pjesët e ndryshueshme dhe shkruani në fletore.
- Fjalët e poshtëshënuara ndani në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme: **bankë, afër, shok, edhe, lapsi miku, dora, sikur, bukur, mirë, i mirë, sa, libri.**

a)-të ndryshueshme: \_\_\_\_\_

b)-të pandryshueshme: \_\_\_\_\_



## DETYRË

Në orën e mësimi caktoni një pjesë nga libri dhe gjeni në të pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme. Të njëjtat shkruani në dërrasë dhe në fletore.

## KUJDES

Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme që përdoren gjatë të folurit ose gjatë të shkruarit janë gjithsej njëmbëdhjetë dhe i quajmë **pjesë të ligjeratës**.

# TË SHPREHURIT ME SHKRIM

Të shprehurit me shkrim

Të formulojmë një tekst nga fjalët e dhëna më poshtë:

Me këto fjalë formuloni një tekst të shkurtër.  
Lexoni në klasë mësuesja /mësuesi do të vlerësojë se kush e ka formuar më mirë tekstin.

Fjalët: ishte, një, lypsar, bredhte, që, në derë, derë.  
Një ditë, një fshat, në, erdhi, te dera, e trokiti, e një kamësi, e shoqja, doli, e pa, e Kamësit, e i tha, lypsarin, të priste, pak, hyri, prapë, brenda, në, shtëpi.  
Pas, dera, një copë, doli me një, përsëri, të ngrohtë, pite, e i tha, ia dha lypsarit, në duar.  
-Buka, në shtëpi, u ndodh, s'na



Detyrat e dyta dhe të tjerat në këtë temë, i bëni vetë duke provuar të shkruani tekst edhe pa fjalët e dhëna. Mundohu të shkruash vetë.

## *Përshkrimi:*

Kujdes

Lexojmë nga teksti, "Pranvera në vendin tim", që të kuptojmë përshkrimin:  
"Është sot një ditë e kthejllët dhe e shndritshme. Dielli shkëlqen posi xhevahir në mes të qiellit me një mënyrë të kaltërt madhështore...  
....Qengjat e vegjël, duke kërcyer e duke u hedhur nëpër livadhe, kullosin në barin e njomë që e ka gjelbëruar fusha....  
.....Përroi rrjedh me një ushtimë të lehtë....."

Sa bukur është përshkruar natyra në këtë tekst. Aty shohim si përshkruhet dita e kthjellët, dielli që shkëlqen posi xhevahir, qengjat plot gaz kërcëjnë nëpër livadhin e gjelbërt, përroi rrjedh me një ushtimë të lehtë.



## TË MBAJMË MEND



Përshkrimi vendoset në fillim të tekstit, në të cilën përshkruan rrethanat e fillimit të veprimit.  
Mund të vendoset edhe në brendi, kur përshkruan personazhin dhe karakteristikat e tij, pamjen fizike, tiparet pozitive dhe negative të tij.



## DETYRË

Përshkruani klasën tuaj dhe shokun / shoqen tuaj të bankës.

# MËMËDHEU

Andon Zako Çajupi

Të lexojmë

Mëmëdhe quhet toka  
Ku më ka rënur koka,  
Ku kam dashur mëm' e atë,  
Ku më njeh dhe gur' i thatë,  
Ku kam pasur shtëpinë,  
Ku kam njohur perëndinë.  
Stërgjyshët ku kanë qënë,  
Dhe varret qi kanë vënë,  
Ku jam rritur me thërrime,  
Ku kam folur gjuhën time  
Ku kam fis e ku kam farë,  
Ku kam qeshur, ku kam qarë,  
Ku rroj me gaz e me shpresë,  
Ku kam dëshirë të vdesë.




**ANDON ZAKO ÇAJUPI** (1866-1930) u lind në Sheper të Zagorisë. Jetoj dhe vdiq në Egjipt. Veprat e tij kryesore janë: "Baba Tomori", "Pas vdekjes", "Burri i dheut" dhe "Katërbëdhjetë vjeç dhëndër". Poezitë e tij kanë frymën e poezisë popullore.



## MËSOJMË

Kjo poezi është lirike. Është e shkruar nga poeti shqiptar Andon Zako Çajupi. Në të poeti shpreh ndjenjat e dashurisë ndaj atdheut. Poezitë ku poeti shpreh ndjenjat e dashurisë ndaj atdheut, gjuhës, flamurit, heronjëve etj. i quajmë **poezi lirike patriotike**.





### FJALOR

*rënurë* - kam lindur,  
*mëm e atë* - nënë e babë,  
*stërgjyshët ku kanë qënë* - stërgjyshërit ku kanë jetuar.



### BISEDË RRETH POEZISË

- Kujt i kushtohet kjo poezi ?
- Çka është mëmëdheu ?
- Çka kemi në mëmëdhe ?
- Sa është i dashur mëmëdheu për ne ?
- Pse në mëmëdhe jetojmë me gaz e me shpresë?



### KOMENTOJMË

Shpjegoni më gjerësisht se çfarë do të thotë Çajupi me vargjet:

“ Stërgjyshët ku kanë qënë,  
dhe varret ku kanë vënë,  
ku jam rritur me therrime  
ku kamë folur gjuhën time...”



### DETYRË

Mësoni poezinë përmendsh dhe recitoni në mënyrë artistike para shokëve të klasës. Mësuesi / mësuesja do të vlersojë recitim tuaj.

## Të shkruajmë

### KUJDES

- Keni dëshirë të bëni përshkrimin e përmbajtjes së një teksti që e keni lexuar më parë, duhet të keni parasysh:
  - Së pari lexoni tekstin ngadalë, rrjedhshëm që të kuptohet përmbajtja
  - Nëse nuk e keni kuptuar lexoni edhe një herë,
  - Tekstin, fabulën, novelën ose skicën i ndani në tërësi logjike, ( pjesë)
  - Për secilën pjesë nxirrni gjykimin kryesor,
- Sipas kësaj që u tha e bëni përshkrimin e tekstit, por duhet të keni kujdes që idenë kryesore të mos e ndryshoni d.m.th. mund të bëjmë përshkrimin më të shkurtër, por t'i përmbaheni konceptit ideor.



### DETYRË

Lexoni në libër tregimin “ Libri mbi princin e lumtur “ dhe hartoni e tekstit sipas shembullit të sipërm

#### a) *plani i tekstit*

Blank yellow box with horizontal lines for writing the plan of the text.

#### b) *kuptimi i tekstit*

Blank pink box with horizontal lines for writing the meaning of the text.



## TË MBAJMË MEND

Fjalët e urta janë krijime të shkurtëra popullore në ta shprehet përvoja jetësore e të moshuarve, e cila duhet t'u shërbejë si mësim gjeneratave të reja.

Ndryshe quhen edhe **proverba**

Fjalët e urta zakonisht përbëhen prej dy pjesëve që ndahen me presje.

Ja disa fjalë të urta:

- "E mira dëgjohet larg, e keqja edhe më larg"

- "Njeriu sa rron, mëson"

- "Dita e mirë, duket që në mëngjes"

- "Koka që s' dëgjon më shumë pëson"

- "Kush i bën varrin shokut, bie vetë brenda"

**Komentojmë:** Çfarë porosie përcjellin fjalët e urta?

Cili është mësimi i tyre?



## DETYRË

Në fletoren e detyrave të shtëpisë shkruani 5 fjalë të urta popullore.

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

Në mes tuaj kam qëndruar  
E jam duke u përvëlur  
Që t'ju ap pakëz dritë,  
Natën t'jua bënj ditë.  
Do të tretem, të kullohem,  
Të digjem, të përvëlohem,  
Që t'ju ndrinj mir' e të shihni,  
Njëri tjetërin ta njihni.  
Për ju do të rri të tretem,  
As një çikë të mos mbetem,  
Të digjem, të qajn me lot  
Se dëshirën s'e duronj dot  
Unë zjarrit nuk i druhem  
Dhe kurrë s'dua të shuhem,  
Po të digjem me dëshirë,  
Sa të mundt t'ju ndrinj më mirë.  
Kur më shihni se jam tretur  
Mos pandehni se kam vdekur:  
Jam i gjallë e jam në jetë,  
Jam në dritët të vërtetë;  
Unë jam në shpirtit tuaj,  
Mos më kini për të huaj.  
Më është falur durimi,  
Andaj po digjem si trimi,  
Se më kënda t'ju bënj mirë,  
Të mos mbeti n'errësirë.  
Jakëni, rreth meje rrini,  
Flisni, qeshni, hani, pini.  
Në shpirtit kam dashurinë,  
Pa digjem për njerëzinë...  
Me zjarr ta djek mushkërinë  
E të tretem për njerinë  
Unë dua njerëzinë,  
Mirësin' e urtësinë.  
Në bëhi shokë me mua,  
Në më doni si ju dua,  
Njëri tjetërinë në doni  
Të pa udhë mos punoni...  
Unë, duke përvëlur,  
Njerëzit i kam ndrituar;  
Kam qenë mik me njerinë,  
Andaj i di e më dinë...  
Dua shumë fjalë t'ju them,  
Po trembem mos ju bënj ujëm.  
E ku shkruhen në kartë  
Fjalët' e gjuhësë ' zjarrtë?



**NAIM FRASHËRI** (1846-1900) lindi në Frashër të Përmetitit. Jetoj dhe punoi jashtë atdheut. Ka shruar libra me vjersha si: "Bagëti e bujqësia", "Lulet e verës", "Historia e Skenderbeut" etj.





### FJALOR:

**duke përvëluar** - duke u përvëluar  
**as një çikë** - as një grimcë  
**druhem** - frikësohem  
**në shpirtët** - në shpirtin tuaj  
**me kënda** - më pëlqen  
**jakeni, jak** - ejani, eja  
**në bëheni** - në qoftë se bëhet  
**pa** - pastaj  
**të paudhë** - të pa drejtë ( të këqinj )  
**andaj** - prandaj



### BISEDË RRETH POEZISË

- Kush qëndronte në mes të njerëzve ?
- Pse e bënte atë sakrificë ?
- Cila ishte drita të cilën e bënte qiriri ?
- Në cilat vargje poeti flet për vete?



### SHËNIM

Në vjershën "Fjalët e Qiririt", qiriri është vetë poeti ynë i madh N. Frashëri.

Naimi digjet e përvëlohet pa e kursyer veten dhe me fjalët e tij të fuqishme dhe të singerta mundohet t'ua tregojë njerëzve rrugën e dritës dhe të së vërtetës.

Njëkohësisht Naimi përhap edhe dashurinë ndaj njerëzimit. Puna, fjala dhe vepra e tij janë shpresat për një jetë më të lumtur mes njerëzve.



### DETYRË

Çdo nxënës të mësojë nga një pjesë të vjershës përmendsh, me qëllim që poezia të mësohet e tëra ( Grupet e nxënësve i përcakton mësuesja/mësuesi ).

### Fjalë të urta për mësimin

1. "Mendja pa dituri, nuk ka fort bukuri"
2. "Njerëzit duke mësuar janë qytetëruar"
3. "Ai që nuk mëson, jetën e zezë e shikon"
4. "Pa pasur dituri, s'quhet njeriu njeri"
5. "Kalliri që ka bukë, nuk ngre kokën lart, ai që është fyll, del mbi të gjithë shokët"

# EMRAT E PËRVEÇËM DHE TË PËRGJITHSHËM

Njohim gjuhën tonë

## Të rikujtohem



Pjesa e ndryshueshme e ligjeratës që emërton frymorë, sende ose ide quhet emër.

Emri ka dy numra: numrin njëjës dhe numrin shumës

Emri ka tri gjini: mashkullore, femërore dhe asnjëse.

## SHËMBUJ

Emra në numrin njëjës dhe shumës në gjininë mashkullore dhe femërore:- në trajtë të pashquar **shok,laps,dhomë,gur,mur** etj.

**-mik-miq,zog-zogj,shkollë-shkolla,gomë-goma** etj.

## MËSOJMË



Lexoni me vëmendje vargjet dhe nënvizoni emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm:

“ Qani ju shpata e ju dyfeqe  
Shqiptari u zu si zog ndër leqe!  
Qani ju trima bashkë me ne,  
Se ra Shqipëria me faqe n’ dhe

.....  
Qysh prej Tivarit deri n’Prevezë  
gjithkund lshon dielli vap edhe rreze  
është toka jonë, prindi na e ka lënë...”



Shpata,shqiptari, zog, leqe, trima, rreze, prind etj. janë **emra të përgjithshëm**, kurse: Shqipëri ,Tivar , Prevezë - janë **emra të përveçëm**.

## TË MBAJMË MEND



Emri i përgjithshëm emërton frymorë ose sende apo ide të përgjithësuar ( shpata - cila shpatë ? ). Emri i përveçëm emërton një frymor, një send të veçuar. Emri i përveçëm shkruhet gjithnjë më shkronjë të madhe - ( Tivari,Prevezë...)

## DETYRË



Në fletoren e detyrave të shtëpisë shkruaj paragrafin e parë të tekstit “Sytë e shkollës” dhe klasifikoj emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm në kolona të veçanta!

_____
_____
_____

_____
_____
_____

Gjithçka e tij ishte e bardhë. Edhe mjekra. Edhe mustaqet. Edhe flokët. Edhe plisi. Edhe tufa e deleve. Edhe shtëpiza...Edhe...

Por më e bardhë ndër të gjitha ishte zemra e tij.

Vërtetë atë nuk ia kishte parë askush. Por tjetër zemër nuk mund të kishte ai, i cili tërë jetën ishte përpjekur që çdo gjë rreth tij të ishte e bardhë si qumështi që milnin për drekën baritore.

Prandaj e quanin të gjithë Plaku Zemërbardhë, kurse emrin e tij të vërtetë kishte shumë fëmijë që nuk e dinin.

Zemra e tij ishte e bardhë dhe e madhe, në të kishte vend për shumë, shumë dashuri. Tërë pranverën e kalonte duke shartuar. Nuk kishte fidan të egër që mund t'i shpëtonte syrit të tij. Për të nuk kishte: kjo është arra ime, ajo është e huaj. Ky është livadhi im, ai i tjetrit.

- Mjaft shartove, xhaxha! - i thoshin nganjëherë.

- Jo fëmijët e mi, nuk është mjaft - përgjigjej. - Dua që çdo pëllëmbë toke të jetë me pemë. Dua që, kur të vij behari, tërë fshati të duket i bardhë.

I pëlqente të shartonte, sidomos anës rrugëve dhe afë krojeve.

-Kalojnë këtej udhëtarët e lodhur dhe të etur duke vjelë pemët e arrira.

Ne rriteshim me shembullin e tij të punës dhe të dashurisë. Ai plakej, vinte dita-ditës duke u bërë dhe më i bardhë. Dhe sa më tepër e ndiente peshën e pleqërisë, aq më tepër ngutej të punonte.

- Jeta kalon shpejt, - na thoshte. - Pas mbeten vetëm puna dhe mirësia.

Një ditë, diku në të hyrë të vjeshtës, Plaku Zemërbardhë nuk u duk me tufën e deleve. Të gjithëve na therri diçka në zemër. Ku nuk ka shkoi mendja. Ishte plak dhe mund t'i ndodhte ndonjë e keqe. As lozëm, as qeshëm. Tërë ditën vetëm për të folëm.

Kur u ktheva në shtëpi, babanë dhe xhaxhanë i gjeta rreth oxhakut. Dukej se bisedonin diçka të rëndësishme. Thashë: hajt t'i dëgjoj, mos po flasim për Plakun Zemërbardhë. U ula në një kënd tërë sy e veshë.

- Kujt i kishte shkuar mendja tek ai?! - thoshte babai, - Atë as e thirrën në mbledhje! Plak i mbetur! Pa fëmijë dhe nipa për shkollë! Njeri që fort rrallë e sheh midis burrash, që pothuaj tërë jetën e ka kaluar pas deleve dhe me kalamajtë! Ja mu ai, nga i cili s'është pritur asgjë, të ngrihet dhe të thotë: "Burra, unë po e lëshoj odën time për fëmijët. Ato dy vajza që pata, i martova. Tani vetëm me plakën jam. Mundem edhe pa të. Le të hapet shkolla, le të ndrit mendja e fëmijëve, të cilët i dua si të ishin të mitë".

-Kështu tha? - u habit xhaxhai.

-Kështu, - u përgjigj babai. - Të gjithë ia shtrënguan dorën burrërishtë dhe e falënderuan për të mirën që po i bënte fshatit. E kuptova, flisnin për Plakun Zemërbardhë. U gëzova shumë që nuk i kishte ndodhur ndonjë e papritur? Por këtë punën e shkollës nuk e kuptova mirë.

-Babë, ç'u duhet fëmijëve oda? - pyeta.

-Për shkollë, - u përgjigj ai prerë. - Duhet ta festojmë sonte. Edhe fshati ynë do të bëhet me shkollë.

Edhe në shkollë ai ishte midis nesh. Pushimeve na sillte ujë të ftohtë. Për të na provuar zgjuarsinë, shpesh na pyeste sa bëjnë kaq edhe kaq, kaq herë kaq, kaq pa kaq. Ai që gabonte, merrte një thumb pas.

- Ore, po ta dija kështu, nuk do ta lëshoja odën, - thoshte ndonjëherë me shaka.

-Po si e harruat fare xhaxhanë? Kam mbetur fillikat. S'po më shkohet më andej nga Lugjet.

- Si i ke shartimet, xhaxha?

- Patën lule ato te Lugshtaja?

- Kanë lidhur ato në kodër?

- Ngjitemi sot pasdite deri te lëndinat?

Na përgjigjej me buzë në gaz. Por ngjitej andej gjithnjë e më rallë.

Ndoshta nga pleqëria, mendonim.

Mund të ketë qenë kështu, por edhe mund të mos ketë qenë. Me sa dukej, atje nuk i shkohej pa ne.

Na kishte dashur më tepër se qengjat, se zogjtë, se hijet, se krojet, se filizat e njomë...

Për ne kishte pasur më tepër vend në zemrën e tij të bardhë.



### FJALOR

**plis** - kësulë e bardhë

**sharton** - në një degë të pemës së egër vëndojmë një degë nga një pemë tjetër që duam të fitojmë nga ai dru.

**i arrirë** - i bëmë, i pjekur

**thumb** - tallje, fjalë thumbuese, fjalë tallëse

**kanë lidhur** - pemët kanë zënë kokërr.



### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Kush ishte Plaku Zemërbardhë, si dukej ai dhe çka punonte?
- Pse fëmijët e donin shumë Plakun Zemërbardhë ?
- Pse Plakut Zemërbardhë i pëlqente të shartonte pemët?
- Pse Plakut Zemërbardhë të gjithë ia shtrënguan dorën dhe e uruan?
- Ky plak mendonte më shumë për të tjerët. Gjeni pjesë në këtë tekst?
- Shkruani disa tipare të jashtme dhe të brendshme të Plakut Zemërbardhë.



### DETYRË

Ritregoni në mënyrë të lirë, kuptimin e këtij teksti.



### TË MBAJTMË MEND

” Plaku Zemërbardhë” është tregim dhe bën pjesë në llojet e prozës artistike. Në prozën artistike bëjnë pjesë romani, novela dhe tregimi. Tregimi është forma më e shpeshtë dhe më e popullarizuar e prozës.



# EMRAT KONKRETË DHE ABSTRAKTË

Njohim gjuhën tonë

Lexoni këtë tekst dhe vëreni çka tregojnë emrat e shkruara me ngjyrë?

Kaluan disa **ditë**. **Fshatarët** ndërtuan **torishte** dhe **ahura** për **bagëti**. **Gratë** për herë të parë filluan t'i mbushin **shekat** me **qumësht delesh**, **lopësh** dhe **buallicash**. Prej **qumështit** bën **kos**, **djathë** dhe **gjizë**. **Fëmijët** hanin me **ëndje** **bukë** me **bulmet** dhe loznin me **gëzim** e **hare**.



## TË MBAJMË MEND

Në këtë tekst fjalët: **ditë, gëzim, hare, ëndje** tregojnë ide, pra i marrim vetëm me mend. Ato janë **emra abstraktë**.

**fshatarë, torishte, ahura, bagëti, gra, shekë, delesh, lopësh, buallicash (lopë, dele, buallicë)** emërtojnë sende - janë **emra konkretë**.

**qumësht, kos, djathë, gjizë, bukë, bulmet** tregojnë lëndë dhe quhen **emra lëndë**.



## USHTRIME

*Fjalët që emërtojnë frymorë ose sende që mund të shihen apo të preken quhen emra konkretë.*

*Emrat abstraktë janë fjalë që emërtojnë ide apo gjë që e marrim me mend, ( nuk i shohim as i prekim ).*



Tregoni çka tregojnë emrat e poshtëshënuar; ( janë konkretë apo abstraktë ).

Nxënës, nënë, ushtar, vëlla, Agim, Hana  
qengj, lopë, qen, luan,  
libër, fletore, dritare, rrugë,  
bukuri, rreptësi, butësi

---

---

---

---



## DETYRË

Në fletore shkruani nga 5 emra që emërtojnë: njerëz, kafshë, shpezë, sende, ndjenja.

- Tregim i përshtatur nga letërsia popullore -

*„Pasuria dhe mençuria nuk dhurohen,  
por fitohen me punë ” (popullore)*

Njëherë jetonin dy miq: njëri ishte i pasur dhe tjetri i varfër.

Një ditë i pasuri i tha të varfërit:

- O miku im, më duket se ti je pak budalla...Dhe a e di pse? Ti je i varfër se fle shumë...

I varfëri ia priti:

-Jo,bre, jam i varfër, sepse kështu ka dashur Perëndia...

Pra, nuk paska shumë rëndësi nëse fle shumë apo pak...

Atëherë i pasuri tha:

-Po ta mbajti, le të vëmë bast se kush ka të drejtë. Unë po e vë tërë pasurinë time, kurse ti të vësh sytë dhe duart e tua...

I varfëri bisedoi me gruan e tij:

-Moj, kam vënë bast me të pasurin. Ai ngul këmbë që pasurohet kush ngrihet herët në mëngjes, kurse unë i thashë që pasurohet vetëm ai për të cilin Perëndia vë dorën në zemër...Më bluaj pak grurë dhe me këtë miell më piq një bukë, sepse nesër në mëngjes po nisem...

Gruaja e të varfërit ia plotësoi dëshirën dhe ai iku me të pasurin...

Si u larguan ca, takuan rrugës një kalorës.

-Ta pyesim kush pasurohet? - tha i pasuri.

Dhe përgjigjja erdhi shumë shpejt:

-Pasurohet kush ngrihet herët në mëngjes.

Ecën më tutje dhe aty nga perëndimi, takuan një tjetër, i cili po kështu u përgjigj, si i pari...

I varfëri e ndiente veten të humbur, por i pasuri pranoi që të pyesnin edhe disa të tjerë...Kështu ndodhi duke pyetur, arritën përpara një manastiri. Murgu, i cili u doli përpara, me ta dëgjuar pyetjen, u tha:

-Ta merr mendja se vetëm Perëndia vendos për fatin e njeriut...

Shkuan më tej dhe takuan një prift, i cili u përgjigj pors i murgu.

Atëherë vendosën të hetonin, të shikonin nga afër, se si jetonin njerëzit.

...Takonin njerëz që ngriheshin herët, por disa prej tyre nuk ishin të pasur.

Takonin, gjithashtu, njerëz që besonin Zotit, por ishin të varfër, kurse disa të tjerë të pasur...



Atëherë, vallë, cili prej të dyve kishte të drejtë? Ikën më tutje, qëndruan në një vend shumë kohë dhe aty panë mjaft gjëra. Një djalosh kishte trashëguar nga i ati një pasuri shumë të madhe, por ai, si dembel që ishte, bridhte natën dhe flinte gjithë ditën. Shërbëtorët e vidhnin vazhdimisht. I pasuri katandisi pa një kacidhe në xhep dhe jetonte duke lypur.

Një tjetër i ri, pa trashëguar asnjë pasuri, ngrihej pa zbardhur dita dhe punonte duke i mbledhur me durim paratë që i fitonte me djersën e ballit. Mblodhi një pasuri të madhe, por ia hëngri një grua e keqe që, fatkeqësisht, e takoi në jetë. Ajo, pasi e la trokë, u zhduk pa nam dhe pa nishan...

Si vranë mendjen që të dy, arritën në përfundimin se nuk u dashka vetëm të krijosh pasuri, por edhe të dish ta ruash. Njeriu duhet të punojë qysh herët në mëngjes, me vullnet, pa u lodhur kurrë... Por sikur papritur të vijnë njerëz të këqij dhe të të rrëmbejnë gjithçka? Apo të të shkretojnë zjarri, përmbytja, thatësira? Kush mund të të mbrojë? Perëndia! Domethënë edhe Zoti, edhe të ngriturit herët...

I pasuri nuk e humbi bastin edhe pasurinë, as i varfëri nuk i humbi sytë dhe duart, ... i pasuri e ndihmoi të varfërin duke i dhënë një shumë të hollash. I varfëri filloi të ngrihej herët dhe shkante në pazar ku i kishte veglat që i përgatiste në shtëpi. Zoti deshi që ai të pasurohej dhe pastaj filloi t'i ndihmonte edhe të tjerët të jetonin më mirë, pa pritur mëshirën e të tjerëve.

Pra mbajeni mend: duhet edhe Perëndia edhe të ngriturit herët.



### FJALOR

**murgu** - njeri i vetmuar, që bën një jetë të mbyllur, që rri në manastir

**i varfër** - skamnorr, fukara



### BISEDË RRETH TEKSTIT

Pasi të lexoni thëniet dhe shprehjet e mençura, përgjigjuni këtyre pyetjeve në fletore:

- Çka biseduan dy miqtë ?
- Pse i pasuri e kritikoi të varfërin ?
- Çfarë përgjigje i dha i varfëri ?
- Çfarë u tha murgu ?
- Cili fitoi në fjalën e vet ?
- Si mbaroi rrëfimi ?



### DETYRË

Kërkoni nga prindërit që t'u tregojnë ndonjë rrëfim për punën ose të lexoni në ndonjë libër dhe të njëjtin shkruani në fletore, kuptimin dhe porosinë.

Ne jemi ushtria më e re në botë,  
Që luftojmë kundër luftës, armatimit;  
Jemi ushtria më e madhe mbi tokë  
Në vallen e haresë dhe gëzimit.

Kazermat tona janë shumë të bukura,  
Janë vatra të paqes dhe lumturisë.  
Armët tona janë lapsat dhe librat.  
Jemi pishtarët të ditëve të lirisë

Ne jemi ushtria më e bukur në botë  
Milionat nxënës në shkollat fillore.  
Ne ngremë zërin deri në qiell,  
Kundër shtypjes dhe luftës mizore.

Uniformat tona janë laramane  
I kemi të gjitha ngjyrat e ylberit.  
Ne jemi vjollca dhe lulëkuqe,  
Që i gëzohemi dritës dhe Diellit.

Si një ushtri e bukur dhe e fortë  
Mësojmë dhe krijojmë botën e re ;  
Botë të lirë, të lumtur, pa lotë...  
Dhe qiell me diell - gëzim e hare.



### *Analizojmë poezinë duke lexuar pjesë- pjesë:*

- Ne jemi ushtria më e re në botë,
- Që luftojmë kundër luftës, armatimit
- Jemi ushtria më e madhe mbi tokë,
- Në vallen e hareshë dhe të gëzimit...

Në këtë strofë poeti bën fjalë për ushtrinë më të madhe mbi tokë, që lufton kundër dhunës dhe armatimit. Ata janë nxënësit dhe të rinjtë, të cilët duan jetë të qetë, të hareshme dhe të gëzuar.

Kështu vazhdoni edhe me strofat tjera!



#### **FJALOR**

**kazerma** - shtëpitë apo ndërtesat ku pushojnë dhe kryejnë aktivitete ushtarët

**uniformat** - veshjet e njëjta të nxënësve

**pa lotë** - shprehje figurative - pa luftë e gjakderdhje



#### **DETYRË**

1. Vjersha të mësohet përmendsh,
2. Hartim me shkrim me temë, “*Ne krijojmë botë të lirë, të lumtur dhe pa lot*”



#### **TË MBAJMË MEND**

Rima është veçori e llojeve letrare në vargje. Rima krijon harmoni mes vargjeve. Kjo arrihet kur rrokjet e fundit të vargjeve përputhen në rimë dhe ngjajshmëri, krijojnë muzikalitet dhe harmoni tingujsh. Në strofën e parë vargu i parë përputhet me të tretin, kurse i dyti përputhet me vargun e katërt - (ABAB). Këtë rimë e quajmë të alternuar. Kemi edhe rimë të kryqëzuar kur vargu i parë përputhet me vargun e katërt, kurse vargu i dytë përputhet me të tretin - (ABBA). Gjenero rimën në strofat tjera të vjershës, **NE JEMI**.

## Mësojmë duke analizuar tekstin e shkurtër

**Shkolla** jonë është e bukur. Klasat **e shkollës** sonë janë të mëdha. Për sukses, rregullshmëri dhe disiplinë, shkollës sonë shumë shoqe ia kanë zili. **Shkollën** tonë shpeshherë e marrin si model për mbarëvajtjen e mësimi.

**Prej shkollës** sonë çdo vit dalin nxënës të mirë.

Në këtë tekst emri shkolla është përdorur në forma të ndryshme. (shkolla, e shkollës, shkollës, shkollën, prej shkollës).



### TË MBAJTMË MEND

Format e ndryshme që merr emri gjatë përdorimit në fjali quhen **rasa**. (shih ndryshimin e emrit shkollë)

Rasat e emrit janë: rasa **emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore.**

## USHTRIME

Plotësoni vendet e zbrazëta ashtu që do ta përdorni emrin gjuetari në të gjitha rasat:

\_\_\_\_\_ shkoi në gjueti. Pushka e \_\_\_\_\_ është e re.

Kur gjuan me pushkë \_\_\_\_\_ nuk i dridhet dora. Fëmijët e fshatit e takojnë

shpesh \_\_\_\_\_ zagari nuk ndahet prej \_\_\_\_\_.



### SHËNIM

Teksti të plotësohet në fletoren e detyrave të klasës, jo në libër.

#### Njohuri plotësuese

Për t'i kuptuar më lehtë rasat, në vazhdim të temës do t'ua shkruajmë pyetjet e rasave. (përemrat pyetës përkatës)

Për rasën emërore përdoren pyetjet: **kush, cili, cilat, cilët**.

Për rasën gjinore përdoren pyetjet: **i kujt, e kujt, i cilit, i cilës, e cilit,**

Për rasën dhanore përdoren pyetjet: **kujt, cili, cilës, cilëve, cilave,**

Për rasën kallëzore përdoren pyetjet: **kë, cilin, cilën, cilët, cilat,**

Për rasën rrjedhore përdoren pyetjet: **prej kujt, prej cilit, prej cilës,**





**DETYRË 1** Në vazhdim të fjalive të mëposhtme shkruani rasën përkatëse të emrit nxënës

- Nxënësi shkruan.
- Libri i nxënësit është i pastër.
- Nxënësit i dhuruan një libër
- Nxënësin e mirë e lëvdojnë.
- Lektyrën e punova prej nxënësit të kl.III.

→ \_\_\_\_\_

→ \_\_\_\_\_

→ \_\_\_\_\_

→ \_\_\_\_\_

→ \_\_\_\_\_



**DETYRË 2**  
Formoni fjali duke përdorur emrat *shoku* dhe *motra* në pesë *rasa* - (shih detyrën 1)

*shoku*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Motra*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

I dashuri baba!

Ti prore je në zemrat tona dhe për çdo ditë të kujtojmë me mall e dashuri. Sapo zgjohemi nga gjumi, mendimet, mu si rrufeja, ikin dhe vijnë tek ti, atje në skaj të botës. Ndonëse me trup je larg nesh, ne kurrë s'të largojmë nga zemrat tona. Shpesh të shohim edhe në ëndërr. Edhe unë edhe Drita, Në mëngjes i rrëfejme mamit. Ah, sikur ta dish sa me ndjenja dëgjon ajo, kur i tregojmë për ty, baba. Pastaj na ledhaton duke na thënë: "mos u brengosni loçkat e nënës. Së shpejti do të kthehet babai. Do t'ju sjellë shumë gjëra të bukura..."

"Dje në shtëpinë tonë erdhi babai i Gencit. Ai rrëfeu shumë gjëra të bukura për Gjermaninë dhe qytetin ku punoni. Na tregoi se punoni së bashku në një fabrikë dhe se keni edhe shokë të tjerë. Megjithatë ju djeg malli për vendlindjen.

Ashtu siç na digjet shpirti edhe neve për ju. Për lodrat çokolladat u gëzuam shumë edhe unë edhe Drita, por na erdhi keq pse nuk kishe ardhur edhe ti baba. Mirëpo, kur babi Gencit na tregoi lajmin e gëzuar se së shpejti do të vish edhe ti, zemra na u bë mal.

Të lutem eja sa më parë. Ah, sa jemi mërzitur pa ty! Mos na sjell asgjë. Vetëm kemi dëshirë të të shohim, se ka gjashtë muaj që s'të kemi parë. Duam të të kemi pranë. Në fund, prano përshëndetjet tona.

Të përqafojnë me mall:

Dritoni dhe Drita



## BISEDË RRETH TEKSTIT

- Kujt ia drejtonte letrën Dritoni dhe Drita ?
- Ku ishte babai i tyre dhe pse kishte shkuar ?
- Kush erdhi në shtëpinë e tyre?
- Çka u solli Dritonit dhe Dritës ?
- Cila ishte dëshira më e madhe e fëmijëve ?





### FJALOR

**rrufeja** - më ikin mendimet, me shpejtësi të madhe (drita e rrufesë)

**rrëfeu** - tregoi

**prore** - çdoherë, gjithmonë



### TË MBAJMË MEND

Letra është formë e komunikimit me shkrim. Atë ia drejtojmë prindit, shokut, mikut, por mund t'ia drejtojmë edhe një institucioni shtetërorë. Letrat që ia drejtojmë ndonjë të afërmi janë **letra private** ( shoqërore ). Letra që ia drejtojmë një institucioni shtetëror, duke parashtruar një ide, mendim ose kërkesë zyrtare janë **letra zyrtare**.



### DETYRË

Nxënësit e klasës i ndani në dy grupe dhe secili grup ka për detyrë të shkruaj një letër drejtuar:

**Grupi A:** shokut / shoqes


**Grupi B:** një institucioni shtetëror ( prefektit të komunës, drejtorit, ministrit).

### KUJDES

Letra ka qëllim të caktuar.

Gjatë hartimit të letrës kujdesemi për stilin dhe përdorimin e gjuhës standarde shqipe. Kërkoni ndihmë nga mësuesi/mësuesja.

Era myk  
I vjen një shtëpie  
Në Veleshtë  
Mbetur ka  
Si flamur partie  
Pas një fushate  
Si një fabrikë  
E konsumuar  
Nga koha.  
Dasëm bëjnë minjtë,  
Brenda kësaj  
Shtëpie.  
Mërimangat  
Më kotë thurrin  
Rrjetën,  
S'ka lëvizje  
Ka brengë  
Në shpirt poeti  
Kotë  
Bëjmë grim  
Me politikë  
Mërgimi  
Si kë kup  
Pi gjakun tim.



## FJALOR

**kurbeti** - mërgim në dhe të huaj për bukën e gojës e të fëmijëve

**konsumuar** - e harxhuar

**brengë** - mërzë



## BISEDË RRETH POEZISË

- Çfarë teme trajton autori në këtë poezi?
- Kush largohet nga vendlindja e poetit?
- Me largimin e fëmijëve, shkollat dhe rrugët ngelin të boshatisura, a e arsyetoni ju këtë?
- Çka është kurbeti për popullin shqiptar?

## KUJDES

Tema që trajton autori në këtë poezi është **sociale**. Kurbeti është një plagë e pashërueshme e popullit shqiptar, sepse shqiptarët me shekuj kanë marrë rrugën e kurbetit. Tani për fat të keq në botën e jashtme shkojnë edhe të rinjtë, bile edhe ata që kanë kryer shkollimin e lartë. Kjo lë një pasojë të rëndë, sepse boshatis familjet, shkollat, rrugët, fshatin në tërësi. Në përfundim poeti jep një mesazh të qartë se kot mashtrohemi me jetën e përditshme, me politikë, kurbeti po asimilon një pjesë të popullit tonë. ( Nxireni vetë porosin e kësaj poezie )

## Të rikujtohemi

Në temën e kaluar emrat shkolla dhe gjuetari kishin marrë forma të ndryshme nëpër rasi, nga kjo rrjedh përkufizimi: Ndryshimi i emrit nëpër rasi në numrin njëjës dhe shumës në trajtën e shquar dhe të pashquar quhet **lakim**.



## MËSOJMË

Emrat e gjinisë femërore dhe mashkullore në trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar nëpër rasi marrin mbaresa të ndryshme.

Në bazë të mbaresave që marrin emrat në rasën emërore në numrin njëjës, në trajtën e shquar, ato ndahen në tri lakime:

**Lakimi i parë:** përfshin emrat e gjinisë mashkullore që marrin mbaresën - **i** p.sh. Laps**i**, mësues**i**, shkum**s**i etj.

**Lakimi i dytë:** përfshin emrat e gjinisë mashkullore që marrin mbaresën - **u** p.sh. ujku**u**, bariu**u**, peshku**u**, zog**u** etj.

**Lakimi i tretë:** përfshin emrat e gjinisë femërore që marrin mbaresën - **a**. p.sh. Shtëpia**a**, lulja**a**, klasa**a** etj.

## USHTRIME

Në këtë tekst gjeni emrat dhe ndani në lakime sipas mbaresave:

- Visari lunate në një kënd të rrugës. Befas pranë tij u ndal një zog. Visari vrapoi nga ai. Zogu u frikësua dhe desh të fluturonte, por nuk mundi. Dikush ia kishte plagosur krahun. Zogu përpiqej të ikte, të fluturonte.
- Mos u frikëso, - i tha vogëlushi. Visari u përkul e kapi zogun dhe filloi ta ledhatoj nga koka.



## DETYRË

Në fletoren e detyrave të shtëpisë shkruani nga pesë emra për secilin lakim:

Blank lines for writing answers.

# LAKIMI I EMRIT ( USHTRIME )

Njohim gjuhën tonë

Të rikujtohemi:

Emri lakohet në numrin njëjës dhe shumës në trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar. Në vazhdim do të ushtrojmë lakimin e emrit.

## a) Lakimi i parë

### Trajta e pashquar

numri njëjës

numri shumës

Emërore një laps  
Gjinore i, (e) një lapsi  
Dhanore një lapsi  
Kallëzore një laps  
Rjedhore prej një lapsi

(disa) ca lapsa  
i, (e) ca lapsave  
ca lapsave  
ca lapsa  
prej ca lapsash

### Trajta e shquar

numri njëjës

numri shumës

Emërore lapsi  
Gjinore i, (e) lapsit  
Dhanore lapsit  
Kallëzore lapsin  
Rjedhore prej lapsit

lapsat  
i, (e) lapsave  
lapsave  
lapsat  
prej lapsave

## b) Lakimi i dytë

### Trajta e pashquar

numri njëjës

numri shumës

Emërore një shok  
Gjinore i, (e) një shoku  
Dhanore një shoku  
Kallëzore një shok  
Rjedhore prej një shoku

(disa) ca shokë  
i, (e) ca shokëve  
ca shokëve  
ca shokë  
prej ca shokësh

### Trajta e shquar

numri njëjës

numri shumës

Emërore shoku  
Gjinore i, (e) shokut  
Dhanore shokut  
Kallëzore shokun  
Rjedhore prej shokut

shokët  
i, (e) shokëve  
shokëve  
shokët  
prej shokëve

c) Lakimi i tretë

Trajta e pashquar

numri njëjës

Emërore	një nxënëse
Gjinore	i, (e) një nxënëseje
Dhanore	një nxënëseje
Kallëzore	një nxënëse
Rjedhore	prej një nxënëseje

numri shumës

(disa) ca nxënëse  
i, (e) ca nxënëseve  
ca nxënëseve  
ca nxënëse  
prej ca nxënësesh

Trajta e shquar

numri njëjës

Emërore	nxënësjë
Gjinore	i, (e) nxënëses
Dhanore	nxënëses
Kallëzore	nxënësen
Rjedhore	prej nxënëses

numri shumës

nxënëset  
i, (e) nxënëseve  
nxënëseve  
nxënëset  
prej nxënëseve



SHËNIM

Kështu lakohen edhe emrat: peri, freri, druri, mulliri, dushku, breg, shtogu, qiri, njeriu, ideja, foleja, shtëpi, lule etj.



DETYRË

Në këtë strofë gjeni emrat dhe tregoni në cilin lakim bëjnë pjesë:

“Ylli i vogël lartë në qiell  
duke parë si zjarr në pyll,  
sipas dheut larg qëndron  
xixa-xixa-xixëllon”

Pasi t’i gjeni emrat, në fletoren e detyrave të shtëpisë lakoni në trajtën e shquar njëjës dhe shumës emrat e vargut të parë, kurse në trajtën e pashquar njëjës dhe shumës emrin e vargut të tretë.

USHTRIME

Në klasë së bashku me mësuesen/mësuesin caktoni një tekst nga libri dhe emrat që aty do t’i gjeni t’i shënoni në dërrasë dhe t’i klasifikoni sipas lakimit ( teksti mund të ndahet në pjesë dhe të punohet në grupe).

KUJDES:

Ushtrimin e ndjek mësuesja/mësuesi dhe i përmirëson gabimet.

## Novelëzë

Askush s'e njeft Lulin. As shokët e tij, që për para tij lozin, nuk e njoftin. Ma mirë me thanë se e njoftin, por ata lozin për hesap të vet e Luli i shikon për hesap të vet. Sot gjithkush ka punët dhe telashet e veta, ashtu edhe fëmijët, ashtu edhe Luli. -More Lul! Shumë herët ke fillue me shikue punën tande.

Kur Luli hyn n'oborr të shkollës, buza i qeshet nga pak, por askujt as një fjalë s'i thotë. Ecën ngadalë, tue shikue djathtas e majtas, por gjithnjë tue ecë, deri sa të mrrijë në cak të vet. Aty te dera e rruginës shkollore shumë i pëlqen te qëndrojë.

Aty asht caku i tij, i prarume me rrezet e ngrofta të diellit në këto ditët e vjeshtës.

Mbshtetet Luli për mur, grushtat e vegjël i shtije ndër xhepa, hundën picrrake të kuqun nga i ftohti i mëngjezit ja sjell diellit dhe...shikon. Gjaja që ma tepër ja tërhjek vrejten janë çizmet, që i kanë të veshun disa shokë të tij.

Sa të bukura janë! Si shkëlqejnë! — mendon Luli dhe pa dashje i shkojnë syt ndër tollumbat e veta, nëpër të cilat shifen mirë të pesë gishtat e kambve të zbatuna. Nga kureshtja i afrohet një shoku që ka çizmet më të reja.

Ulet dhe shef në lustrin e çizmes kambët e veta të zbatuna - aq shumë shkëlqejshin çizmet !!! Mbas shoku me çizme fluturoi, Luli ngadalë shkoi te caku i vet, në diell, ti ngrofi kambët . - Po kur nuk ka diell, si ja bën i shkreti Lul!

Ndoshta ja bajnë disi hallin apostujt e mëshirës apo të dashunis'...

Ndoshta,ndoshta...

Nga një herë i afrohet mësuesi Lulit. Dhe kur e ka ftyrën e dlirtë dhe pa puça, mësuesi ja ledhaton faqet,gushën,e Luli i afrohet,ja merr dorën, e shikon me sy pllumbi dhe kishte dashtë t'i fali diçka mësuesit.

Por vjollca nuk ka. E Luli i vocër çka mundet t'i fal mësuesit tjetër? Veç në ja faltë tollumbat e veta që kanë hapun gojën si me dashtë me e hangër mësuesin.

Po, po, tollumbat e Lulit të vocër kanë me e hangër mësuesin.

Luli i vocër - titulli origjinal i autorit



## FJALOR

**zbatuna** - këmbëzbathur (pa këpucë e pa çorape në këmbë)

**lustrin e çizmes** - shkëlqimin e çizmes

**kureshtja** - dëshirë e madhe për të parë diçka

**lozin** - luajnë

**hesap** - logari



## BISEDË RRETH TEKSTIT

- Me cilin vogëlush u njohët në këtë tekst ?
- Ku qëndronte Luli kur shkante në shkollë?
- Si i shihte shokët e pasur Luli?
- Në çfarë gjendje ishte mësuesi ?
- Mësuesi e ledhatonte Lulin, e donte dhe e shihte me keqardhje, pse ?



### KOMENTOJMË

Cilët nxënës ( fëmijë ) i përfaqëson Luli në tekst?  
Pse teksti mbaron : “*Po po tollumbat e Lulit të vocërr kanë me hangër mësuesin*”?



### TË MBAJMË MEND

Novelëzën “Luli i vocër” e ka shkruar shkrimtari shqiptar Migjeni ( 1911-1938 ). Migjeni ka shkruar poezi dhe prozë. Në veprën e vet ai përshkruan jetën reale të shqiptarit në atë kohë, prandaj edhe mban epitetin “ Poeti i mjerimit “. Vepra e Migjenit titullohet “ Vargjet e Lira”.



### DETYRË

Në orën e leximit plotësues, lexoni edhe një prozë tjetër nga Migjeni, sepse janë mbresëlënëse.

- *Tregimin përshtateni në gjuhën standarde në fletore?*







## MODULI - 2



22. *Mbiemrat cilësor dhe marrëdhëniorë*

23. Në bibliotekë

24. Halili dhe Hajria

25. Në liqenin e Ohrit

26. Shkruajmë tekst

27. *Përemrat vetorë*

28. *Përemrat dëftorë*

29. Sa është, ora xhaxha

30. Në Manastir

31. Dëllinja e Skënderbeut

32. Komunikim me gojë

33. *Përemrat pyetës*

34. Imam efendiu

35. Këndezi, pula apo veza

36. Libri mbi princin e lumtur

37. *Folja, kuptimi mbi të*

38. Gjingalla dhe miz'e dheut

# MBIEMRI CILËSORË DHE MARRËDHËNIORË

Njohim gjuhën tonë

## Të rikujtohem

Mbiemër quhet pjesa e ndryshueshme e ligjeratës, që shërben për të treguar një cilësi të një emri;

Mbiemri përshtatet me emrin në numër, gjini, rasë;

Cilësinë e një sendi mbiemri mund ta tregoj drejtëpërdrejt ose nëpërmjet marrëdhënieve (lidhjeve) të sendit të cilësuar me një send tjetër, me rrethana vendi, kohe etj.

Mbiemrat që tregojnë cilësinë e një sendi drejtëpërdrejt quhen **mbiemra cilësorë**.

Mbiemrat që tregojnë cilësinë e sendeve tërthorazi, d.m.th. nëpërmjet marrëdhënieve të sendeve të caktuara me sende të tjera apo rrethanorë vendi, kohe, lënde etj. quhen **mbiemra marrëdhëniore**.

## SHEMBUJ

Mbiemra cilësorë

I bardhë, i zi, i kuq, i verdhë, i gjatë, e lartë, i thatë e fortë, i ri, e re, plak, besnik, i ndershëm, i martuar, e trashë

Mbiemra marrëdhëniore

Marrëdhënie lënde - i hekur, e drunjtë, e leshtë, i florinjte  
Marrëdhënie kohe - i motshëm, e djeshme, i sotëm, i hershëm  
Marrëdhënie vendi - i këtushëm, i atyshëm  
Marrëdhënie sasi i dyfishtë, e pesfishtë, e trefishtë

## DETYRË

1 Mbiemri: shallë **i kuq**, është në gjininë \_\_\_\_\_ dhe në numrin \_\_\_\_\_

Mbiemri: dhëmbi **i madh**, është në numrin \_\_\_\_\_ të njëjtin ktheni në numrin shumës \_\_\_\_\_

2 Plotësoni vendet e zbrazëta me mbiemrat gjegjës:

Ato ishin vajza \_\_\_\_\_. Ishin veshur me fustane \_\_\_\_\_. Fytyrat e tyre dukeshin \_\_\_\_\_.

Në sytë e tyre \_\_\_\_\_ vërehej gëzimi. Dy nga ata ishin më \_\_\_\_\_ kurse tre të tjerët ishin më \_\_\_\_\_

3 Në paragrafin nga teksti: “Pal Golemi dhe Nik Peta”, nënvizoni mbiemrat dhe shënoni në fletore.

Pranë kalit ishte edhe një luftëtar i mbytur në gjak me dhjetë ushta të ngulura në krahor. Flamurin e mbante me dhëmbë dhe pëlhurën e kuqe me shkabën në mes e valëviste flladi. Në dorë shtrëngonte ende kordhën, ashtu siç e shtrëngonte kur luftonte.

# USHTRIME RRETH MBIEMRIT

Njohim gjuhën tonë

a) Shkruani fjali me mbiemrat; i urtë, i dalluar, e mirë, e fortë, e edukuar, dinake, besnik dhe besnike.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

b) Lidhni emrat me mbiemrat përkatës.

njeri  
bukë  
nxënës  
burrë  
grua  
vajzë  
shoqe  
pemë  
gazetë  
motoçiklist  
mësues



e pjekur,  
i verbër,  
plak,  
e dalluar,  
i sjellshëm,  
plakë,  
e sotme,  
i shpejtë,  
i rreptë,  
zemërmirë  
e hershme,



## DETYRË

1. Sipas shembullit nën pikën **b**, në shtëpi shkruani edhe pesë shembuj.
2. Në këto fjali gjeni mbiemrat dhe tregoni numrin dhe gjinin e tyre:
  - Struga ka lagje të reja, rrugë të gjera dhe pallate të larta.
  - Ti je si një kopsht me lule të bardha, të kuqe e të kaltra.
  - Qytetarët e tu janë të urtë, të vyeshëm dhe krenar.

Në mëhallën tonë është hapur biblioteka e re. Fëmijët janë gëzuar shumë për bibliotekën e hapur si dhe për tezen që punonte në të. Njëherë dikush duke biseduar tha:

-Si duket,kjo tezja i di te gjithë, mu të gjithë.

-Po, s'ka gjë që nuk e di ajo - u përgjigj fëmija tjetër.

Sikur t'i kishte lexuar të gjithë librat ,cilindo që ta kërkosh, menjëherë ta gjen. Nëse dëshiron ajo edhe do të të tregoj se për çka shkruan në libër, mu si mësuesja...

Këtë bisedë e kishte dëgjuar edhe djaloshi ynë më i vogël në rru-gë, Orhani. Mendoi: "Të shkoj edhe unë në bibliotekë dhe ta shoh tezen". Veshi rrobat më të mira dhe u nis të shkojë në bibliotekë.

Tezja e bibliotekës e priti me buzëqeshje.

- Eja, djalosh , edhe për ty do të gjejmë ndonjë libër.

- Ma jepni ! i tha Orhani.

- E, cilin libër e dëshiron ?

- Cilin ma zgjidhni ju, por le të jetë i bukur...

- Mirë, ndoshta e do "Të përhiturën"?

- E di atë tregim - tha Orhani ma jepni një tjetër.

- Ndoshta e do "Kësulëkuqen"?

- E di edhe atë përallë...Vajza e cila nuk e ka dëgjuar nënën dhe..!

- Po, po, ashtu, por a e di përallën për "Borëbadhën"?

- Jo, atë përallë nuk e di...a është e bukur ?

- Shumë e bukur - tha bibliotekarja.

- A do të ma tregoni. Fëmijët e lagjes sime tregojnë shumë gjëra për ju, prandaj ma tregoni...

Bibliotekarja pranoi, sepse edhe Orhani i pëlqeu shumë, por edhe punë të tjera atë ditë nuk kishte aq shumë, kështu që ia tregoi për-allën aq mirë si asnjëherë deri tash. Kur e përfundoi tregimin, Orhani e falënderoi dhe i tha:

- Uh, sa e bukur, menjëherë do t'i tregoj edhe nënës, - dhe vrapoi kah dera.

- E librin a nuk do ta marrësh ? - e pyeti bibliotekarja.

- Jo - u përgjigj Orhani - E çka më duhet! Unë ende nuk di të lexoj.

Në derë u ndal pak, buzëqeshi, edhe një herë e përshëndeti bi-bliotekaren, e mandej si ndonjë raketë vrapoi në shtëpi që t'ia tregon-të këtë tregim të bukur s'ëmës.





## FJALOR

*Bibliotekarja*- gruaja që punon në bibliotekë  
*mëhallë* - lagje



## BISEDË RRETH TEKSTIT

Sikurse shihet nga përmbajtja e tekstit, biblioteka është lokal i mbushur me libra të llojllojshëm.

Çdo qytet e ka bibliotekën e vet, po ashtu çdo shkollë ka bibliotekën e saj. Edhe çdo shtëpi duhet të ketë bibliotekë shtëpiake.

Çka i kishte gëzuar më shumë fëmijët ?

Si sillej bibliotekarja?

A ke edhe ti bibliotekë shtëpiake ?

Cili libër të pëlqen më shumë nga biblioteka jote ?



## DETYRË

Shkoni dhe vizitoni bibliotekën më të afërt, merrni ndonjë libër interesant dhe lexojeni.



Fragment nga drama e Kolë Jakovës

( Hyjnë fshatarët me Shpendin në krye )

**Shpendi:** ( fshatarëve ): Mos harroni rojen e mos u habitni pas plaçkes. Çdo rrezik të më thuhet menjëher. A u vranë të gjithë ?

Një fshatar: Nuk ka tepruar asnjë për fare.

**Shpendi:** ( sheh Hajrijen ): Hajrije, ku e ke burrin ?

**Hajrija:** S’kam burrë.

**Shpendi:** Ku është Bejtash Sylja ?

**Hajrija:** Pse e doni ?

Disa : Duam ti marrim hakun Halilit.

**Shpendi:** Duam t’ia shkurtojmë kryet.

**Hajrija:** S’është nevoja. Ja Bejtash Aga ( e zbulon ).

**Shpendi:** E vrave ?

**Hajrija:** Po

( Fshatarët shikojnë njeri tjetrin. Shpendi shikon të gjithë.)

**Shpendi:** Atëherë gjaku u muar.

**Hajrija:** Jo, krejt Shpend Gjeto Plaku.

**Shpendi:** Çka ka mbetur më ?

**Hajrija:** Halili ka thënë : „Mos t’u përkundtë fëmija në djep !”

**Shpendi:** Mblidh mendjen. Më duket se djajt kanë pushtuar sonte trupin tënd. Qëndro burrërisht. Burrat e kanë gjithmonë me burra.

**Hajrija:** Jo...Më falni, me gjykoni si të doni, Unë do ta këpus përmes nyjen që ma ze fytyrën.

Bishë më quani, drej më quani, hakmerrem kundër tradhtisë.

**Shpendi:** Mbajeni burra! Kjo është tërbuar sonte ( e mbajnë )

**Hajrija:** Më lëshoni! Do t’ju dëmtoj ( I shtyn dhe lirohet ).

**Rushja:** Motër, të plaçin sytë !. ( Hajrija sulmon djepin, por s’arrin dot dhe bie mbi të ).

**Hajrija:** Jo se mbytet dot. Mos u çuditni sonte kam forcë ta rropos kulm e themel këtë shtëpi. Këtë fëmijë se përkas dot.

**Rushja:** Hajrije, Motër !

**Hajrija:** Më thuaj Shpend Gjeto Plaku çka të bëj unë tashti ?

**Shpendi:** Eja bijë të të puth ( në këtë kohë Rushja ka larguar djepin jashtë).

**Hajrija:** Po më puth !

**Shpendi:** Po. ( e puth ). Ti je bijë e maleve tona. Ti je nënë, por është i huaji që po na bën bishë. Bishë e malit do të bëhemi, gjarpërinj do të jemi për ta. Kështu të parët tanë kanë ruajtur tokë e zakone. Na lini të qetë të jetojmë dhe si biem më qafe kujt. Mos na përkisni se tërbohemi si bisha në mal.

**Hajrija:** Atëherë Shpend, babë, a më le edhe mua të të përqafoj një herë ?

**Shpendi:** Pse bijë ? ( Hajrija e përqafoi dhe e puth ).

**Hajrija:** A ma bën një amanet.

**Shpendi:** Ç’farë amaneti ?

**Hajrija:** Ta çosh këtë puthjen time shtëpi për shtëpi katundeve tona. Puth burr e kalama, puth grua e plakë, e thuaju ua çon Hajrija. Puth lisat nëpër pyll, shkëmbinj

nëpë male e thuaju ju puth Hajrija. Merrni këtë zemrën time bëreni thërime, thërime, shpërndajeni maleve tona e thuaju se me ju do të rri gjithmonë Hajrija.

**Shpendi** : Jo bijë ashtu jo. Mbajeni djema. Do ta mbys veten ( shokët e mbajnë ).

**Hajrija** : Më lëshoni ! ( çlirohet ).

**Shpendi** : Bijë, ti duhet të jetosh. Në fytyrën tënde po e shoh Halilin e gjallë.

**Hajrija** : Jo, Halili ishte i fortë si malet tona. Halili mbante amanetin.

**Shpendi** : S'është burrëri, të vrasësh veten. Nuk është zakon i yni ky. Ti s' duhet ta bësh këtë. Halili nuk thoshte kështu.

**Hajrija** : Si të jetoj Shpend Gjeto Plaku?

**Shpendi** : Si kulçedër për turkun e si nëna për malet tona.

**Hajrija** : Mos t'u përkundtë fëmijë në djep.

**Rushja** : Hajrije motër, mos e bën këtë kob.

**Disa** : Të vish me ne Hajrije.

**Shpendi** : Gjaku i vëllezërve tonë nuk mirret me një të shtënë. Atje në mal ne do të marrim shokët e do luftojmë kundër pashës sa të rrojmë. Andej është rruga.

**Rushja** : Eja Hajrije.

**Shpendi** : Forca e krahut tënd le të mbroj katundet si mbrojti Halili. Le të vras armiqtë si i vrau Halili.

**Shumica** : Eja Hajrije eja.

**Hajrija** : Të digjet shtëpia, kështu na ka thënë Halili gur mbi gur mos të jetë!

**Shpendi** : Vëreni zjarrin shtëpis, djema ( të gjith dalin ).

**Hajrija** : Ashtu, ashtu ... Sa bukur ! Zjarr përmbrenda zjarr përjashta. Kështu është sot jeta jote!



## FJALOR

*të tërbuar* - është egërsuar

*rropos* - shkatëroj diçka, e rrafshoj

*bishë e malit* - egërsirë mali

*amanet* - porosi

*kalama* - fëmijë

*prinja* - udhëheq

*kukuvajkë* - zog grabitqar, me kokë të gjerë dhe pak si të shtypur, me sy të verdhë e të rrumbullakët, me sqep të thyer, këndon me një zë sikur vajton, del natën ,( sipas besimeve të kota se kukuvajka ndjell zi, të keqe)



## BISEDË RRETH FRAGMENTIT

- Me cilat fytyra u njohëm në këtë fragment të dramës ?
- Me kë bisedon Shpendi?
- Cilin e kërkonin ata ?
- Kush e kishte vra atë ?
- Pse Hajrija donte ta vras të birin në djep ?



## DETYRË

Këtë fragment lexoni sipas fytyrave ( roleve ) . Improvizoni një skenë në klasë nga pjesa e dramës.

Fjalët e fundit të Hajrijes t’i mësoni të gjithë.



## TË MBAJMË MEND

„Halili dhe Hajrija” është dramë.

Tema e dramës është marrë nga kënga e njohur popullore

“ Fryni era u çel taraba “

Ngjarja ka ndodhur në shek XVIII në Malësinë e Shkodrës.


Kërkoni nga mësuesja t’ua shpjegojë fabulën e shkurtër të dramës ose merrni veprën “Halili dhe Hajrija” në bibliotekë dhe lexoni, se do t’u lënë përshtypje të mira për të diskutuar.

Shkruani përshtypjet nga libri apo fragmenti i lexuar.



## Muzgu

Para se të bjerë, dielli, rrobat e bardha zdash  
Dhe ngadale pixhamen e përpurtë e vesh...  
Hijet tani zgjaten mbi ujë e zbehen,  
Mandej në sybrinë me radhë palohen, thehen.  
Ngjyrë vjollce, malet marrin në qetine  
Rradhas dhe qielli përhimët n'perëndim.  
Tani jele bardhe, valët ja nisin vallen  
Dhe bregut ninullat e tyre nuk ndalen



## FJALOR

**zdash** - zhvesh ( i nxjerr rrobat)

**qetinë** - qetësi

**rrobat** - teshat

**muzgu** - gjysmerrësirë, që bie pas perëndimit të diellit



## BISEDË RRETH POEZISË

- Çfarë na mëson poezia “ Në liqenin e Ohrit”?
- Çka përshkruan poeti aty?
- Çka dini Ju për liqenin e Ohrit?
- Si e përshkruan poeti natyrën?

## Komunikim me shkrim :

Bëni një hartim të shkurtër me temë “I bukur është atdheu im...”

# SHKRUAJMË TEKST

Të shprehurit me shkrim


## Shkruajmë tekste

Nxënësit duhet të përgaditen për të shkruar një tekst.

- Ata duhet të respektojnë përmbajtjen.
- Si shkruhet teksti ?
- Çfarë teksti dëshiron të shkruaj ?
- Shkruaj tekst sipas figurave të dhëna ?
- Shkruaj disa proverba, sepse ato janë tekste ?

Tipi i tekstit	Lloji i tekstit	Veçoritë e tekstit
Teksti në poezi	Tekst poetik	Të përshkruaj ndjenjat emocionet, përjetimet e autorit (nxënësit)
Teksti në prozë	- tregim, skicë	Të tregojë ngjarje, përjetime të personazheve
Teksti dramatik	Tragjedi, komedi, dramë	Teksti të shkruhet në formë të dialogut, do të zhvillohet bashkëbisedim në mes personazheve

- 1 (Katër figura për tekstin, “Muji te zanat” )  
Plotëso tekstin sipas figurave me katër paragrafë.




---



---



---




---



---



---





---



---



---




---



---



---



## DETYRË

a) Shkruaj 5 proverba popullore

---

---

---

---

---

Dallo këto tekste:

- 1 Mbrëmë bija ime  
Dy lule i pruri,  
Njërën ma dha mua  
Tjetrën në gjoks e vuri....
- 2 ...Pushimet po mbarojnë. Drita është sa e lumtur aq edhe e pikëlluar.  
Ajo bëri shëtitjen e fundit nëpër fshat. Më shumë mbresa dhe kujtime të këndshme ajo largohej nga fshati...
- 3 ...Miranda: Shko, shiko se ç' duar të bukura kam unë( ia tregon shoqes ).  
Lirika: Më të bukura se të miat nuk i ke kurrë. Shiko se ç' gishtërinj të hollë e të gjatë kam unë.  
Miranda : Oj ç' na thënke!  
Lirika : Ashtu si të thashë ashtu është.

### Përgjigju:

Shembulli nën 1 është i shkruar në  
Shembulli nën 2 është i shkruar në  
Shembulli nën 3 është i shkruar në

---

---

---

# PËREMRI VETOR

Njohim gjuhën tonë

Lexoni fjalitë dhe vëreni fjalët e ngjyrosura me të kuqe. Çka tregojnë ato?

1. **Unë** shkova në shëtitje me shokët e klasës.
2. **Ti** shkove në shëtitje me shokët e klasës
3. **Ai,ajo** shkoi në shëtitje me shokët e klasës.
4. **Ne** jemi bërë gati për hartim me shkrim.
5. **Ju** jeni bërë gati për hartim me shkrim.
6. **Ata,ato** janë bërë gati për hartim me shkrim.



Në fjalitë e shkruara fjalët:unë,ti,ai,ajo,ne,ju,ata,ato janë **përemra vetorë**.

## TË MBAJMË MEND

Përemrat vetorë janë fjalë që tregojnë vetat.

- përemrat vetorë unë dhe ne janë në vetën e parë.
- përemrat vetorë ti dhe ju janë në vetën e dytë,
- përemrat vetorë ai (ajo) dhe ata (ato) janë në vetën e tretë,
- përemrat vetorë unë, ti,ai,ajo janë në numrin **njëjës**, kurse përemrat ne, ju, ata, ato janë në numrin **shumës**.

## KUJDES

Përemri në vetën e parë tregon personin që flet, ose personat që flasin.

Përemri në vetën e dytë tregon personin me të cilin flasim, ose personat me të cilët flasim.

Përemri në vetën e tretë tregon personin për të cilin flasim, ose personat për të cilët flasim.

## USHTRIME

Plotësoni vendet e zbrazëta me përemra vetorë:

Unë dhe \_\_\_\_\_ jemi shokë. \_\_\_\_\_ është në klasën e tretë,kurse \_\_\_\_\_ jam në klasën e dytë. \_\_\_\_\_ jemi të pandashëm, \_\_\_\_\_ shpeshherë na shohin me xheloz,po \_\_\_\_\_ u themi po të duan ne të na bashkohen dhe \_\_\_\_\_ mund të organizojmë edhe ndonjë ekskursion të përbashkët.



## DETYRË

Shkruani nga një fjali me të gjitha përemrat vetorë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## Ushtrime plotësuese

Në librin e leximit gjeni një tekst dhe nënvizoni përemrat vetorë (në klasë së bashku me mësuesin/mësuesen).

# PËREMRI DËFTOR

Njohim gjuhën tonë

## TË MBAJME MEND

Përemrat dëftorë përcaktojnë një emër. Ata tregojnë frymorin a sendin që ndodhet afër ose larg folësit. Përemrat dëftorë përcaktojnë një emër dhe përshtaten me emrin në numër, gjini dhe rasë.

Përemra dëftorë janë:

- a) ky, kjo, këta, këto - **për afër**,
- b) ai, ajo, ata, ato - **për larg**.



## Shembuj

- Kjo** vajzë është e zellshme.
- Ky** djalë është i shkëlqyeshëm.
- Kjo** ndërtesë është e re.
- Këta** janë shokët e Fatosit.

## Nënvizoi përemrat dëftorë në fjalitë e poshtëshënuara!

- Ai djalë është i dalluar.
- Ajo vajzë është shembullore.
- Ato ndërtesa janë të reja.
- Ata plepa janë të lartë.

Përemrat e lartëshënuar tregojnë frymorë apo sende që ndodhen **larg** ose **afër folësit**.




## DETYRË

Shkruani nga dy fjali me përemrat dëftorë: ky,kjo,këta/këto; ai,ajo,ata/ato, ( në fletore ).

Vogëlushja e lagjes sime po kalon rrugës. Fustani saj më i bukur është ai me pika të kuqe. Sot ka veshur pikërisht atë fustan.

Edhe rrobaqepësi i lagjes sime po kalon kësaj rruge. Kravatë e tij më e bukur është ajo me pika të kuqe. Sot ka veshur pikërisht atë kravatë.

- Xhaxha - e thërret vogëlushja rrobaqepësin dhe e pyet
- Sa është ora ?
- Ora ? - thotë rrobaqepësi dhe i përgjigjet pa e shikuar fare: -Dymbëdhjetë. Vogëlushja ja kthen menjëherë.
- Nuk është dymbëdhjetë, por dymbëdhjetë pa dhjetë minuta.
- Rrobaqepësi me kravatë pika pika ndalet dhe shikon me habi.
- Ti paske orë ! - i thotë.
- Po, kam - i përgjigjet vogëlushja me fustan pika- pika.
- Ti më pyet vetëm të më tregosh se edhe vet ke orë...-shtoi rrobaqepësi.
- O jo Xhaxha!
- Pse më ndale pra?
- Mos u hidhëroni - desha të vërtetoj diçka tjetër...
- Çke pasur të vërtetosh a është e saktë ora ime ?
- Jo
- A deshe të tallesh me mua, pra?
- Jo Xhaxha...Mos u hidhëroni...Desha të vërtetoj diçka tjetër...
- A është ora jote e sakt, këtë deshe ta vërtetosh?
- As këtë jo e di se ora ime është e saktë.
- Atëherë?
- Njashtu....
- Më trego, të lutem.
- Desha të vërtetoj se a pritoni të shikoni orën kur u pyet ndonjë fëmijë...






## FJALOR

**priton** - a të mërzhitet

**kravatë** - rrip pëlhure (mëndafshi, leshi, pambuku) i gjatë dhe i ngushtë, që e lidhin burrat si një rreth qafës nën jakën e këmishës



## BISEDË RRETH TEKSTIT

- Si ju duket vogëlushja e lagjes ?
- Po rrobaqepësi si duket ?
- Çka e pyeti vogëlushja rrobaqepësin ?
- Pse ajo kërkonte orën e saktë ?
- Pse rrobaqepësi u hidhërua me vogëlushen?
- Çka i tha në fund vogëlushja ?



## SHËNIM

Teksti është realizuar përmes dialogut. Veçoni një pjesë të dialogut rrobaqepës - vogëlushe që ju ka pëlqyer më tepër:

---

---

---

---

---

---

---

---

Ky tekst është mjaft i pasur edhe me shenja të pikësimit. Vëreni ato dhe mundohuni të tregoni ku dhe pse janë përdorur?

---

---

---

---

# NË MANASTIR MË 1908

Të lexojmë

Manastiri qytet rrëzë Pelisterit për shqiptarët ka një rëndësi të veçantë me vlerë të madhe kombëtare.

Aty nga 14 nëntori i viti 1908 e deri më 22.XI. u mbajt Kongresi i Alfabetit unik të shqipes.

Iniciativën për organizimin e Kongresit të Alfabetit e mori Klubi “ Bashkimi” i Manastirit, por iniciativa u mirëprit dhe u përshëndet nga shumë klube e shoqëri shqiptare në vend dhe në botën e jashtme.

Në Kongresin e Alfabetit të gjuhës shqipe morën pjesë 32 delegatë, që përfaqsonin 26 klube, shoqëri... Aty si delegatë morën pjesë delegatë që u takonin grupeve të ndryshme patriotike përparimtare dhe demokratike si: Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Shahin Kolonja, Gjergj Qirizi, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda e shumë të tjerë.

Pas shumë diskutimeve për të përpiluar një alfabet sa më të përshtatshëm për shkrimin e gjuhës shqipe si dhe për të pasur një variant sa më të mirë që do tu përshkohej të gjithë trojeve ku jetojnë shqiptarët, delegatët zgjodhën një Komision për hartimin e alfabetit... tonë të shqipes. Kryetar i këtij komisioni u zgjodh Gjergj Fishta.

Komisioni për alfabet pas shumë diskutimeve rreth propozimeve të ndryshme për ta zgjedhur si më të përshtatshëm njërin nga tri alfabetet që ishin propozuar mori qëndrim për krijimin e njëalfabeti të ri mbi bazën e alfabetit latin.

Sot shqiptarët kudo që jetojnë e veprojnë përdorin nëpër tekstet e tyre Alfabetin e gjuhës shqipe. Alfabeti ynë ka 36 shkronja të ndara në 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore.

Qyteti i Manastirit në ditët e Kongresit të Alfabetit kishte fituar një gjallëri të veçantë dhe një pamje madhështore. Pjesëmarrësit në Kongres i kishin dhënë një dekor të veçantë këtij qyteti të pasur me tradita historike, kulturore e të tjera shqiptare.

Kongresi i Alfabetit të gjuhës shqipe i vitit 1908 kurorëzoi me sukses përpjekjet që u bënë gjatë shekujve për lëvrimin e gjuhës shqipe, për të përpiluar një alfabet sa më të saktë e më të përshtatshëm për shkrimin e shqipes.

## FJALOR



*iniciativë* - nismë

*Kongres* - mbledhje e gjerë me karakter kombëtar



## BISEDË RRETH TEKSTIT

- Kur u mbajt Kongresi i Alfabetit të shqipes?
- Në cilën qytet u organizua Kongresi ?
- Sa delegatë merrnin pjesë në Kongres dhe nga vinin ata ?
- Cili ishte vendimi që solli Komisioni i Alfabetit ?
- Cila është Dita e Alfabetit të shqipes ?



## MËSOJMË

Prej 14 nëntor i vitit 1908 e deri më 22.XI. u mbajt Kongresi i Alfabetit të shqipes. Në Kongresin e Alfabetit të gjuhës shqipe morën pjesë 32 delegatë.

## DETYRË

Shkruaj një hartim të shkurtër në temë:  
“ Alfabeti ynë është i përjetshëm ”



Në qytetin tim çdo vitë organizohen kurse për mësimin e gjuhëve të huaja. Shumë nxënës, shokë dhe shoqe të shkollës sime në orët e lira ndjekin kurs nga gjuha angleze.

Profesoresha e kursit të gjuhës angleze që në orën e parë u njoh me kursistët me qëllim që të shohë se çfarë kandidatësh ndjekin kursin e gjuhës angleze.

- Mirëdita - u tha profesoresha kursistëve, posa hyri në kabinet.
- Mirëdita - iu përgjegjën kursistët në një zë.
- Unë jam profesoresha Sindi, por do tu lutem që edhe Ju të prezentoheni.
- Unë jam Arta Jusufi, jam shqiptare nga Gostivari.
- Unë jam Ylker Ali, jam turk nga Vrapçishti.
- Unë jam Ivica Risteski, jam maqedon nga Gostivari.
- Shumë mirë u tha profesoresha kursistëve të rinj. Ju përfaqësokeni grupet e ndryshme etnike që jetojnë në Gostivar, Maqedoni. Po, përveç jush a ka edhe të tjerë pyeti e habitur profesoresha.
- Po - u përgjegjën ata. Në mesin tonë ka edhe boshnjak, romë dhe myslimanë.

Profesoresha pasi kuptoi përbërjen etnike të grupit të kursistëve, i njoftoi ata se gjatë këtij kursi që do të zgjasë gjashtë muaj nuk do të kemi kurrfarë problemi.

- Unë do të mundohem tu shpjegoj në gjuhën shqipe dhe maqedone. Besoj se kjo nuk do të paraqes kurrfarë problemi - u tha profesoresha.
- Jo - iu përgjegjën njëzëri kursistët. Ne të gjithë e njohim gjuhën e njëri tjetrit. Jemi shokë të mirë dhe tërë kohën gati jemi bashkë.

Pasi dëgjoi këtë përgjigje nga kursistët, profesoresha e gëzuar ia filloi punës.

*Nga ditari i një shkollari*



## FJALOR

**kursistë** - persona që mësojnë gjuhën ose mbajnë orë të ndonjë lënde tjetër,


## BISEDË RRETH TEKSTIT



- Çka organizohet në qytetin tim?
- Cilët ishin ata që e ndiqnin kursin e gjuhës angleze ?
- Cilës përkatësi kombëtare ishin kursistët?
- A u pengonte gjuha e njëri - tjetrit ?
- Si mendoni ju, a kanë vepruar mirë kursistët që kanë njohur gjuhën e njëri - tjetrit ?
- A ke shokë të përkatësive tjera etnike në shkollë?

## DETYRË

Shkruaj një hartim të shkurtër me temë:  
“Toleranca”



Abdylazis Islami lindi më 29 korrik 1930 në fshatin Gajre të Tetovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Vdiq më 16 gusht 2005 në Tetovë. Ka shkruar këto vepra : „ Feniks” poezi për të rritur , 2001, Tetovë, „ Shira dhe Vërshime” roman për të vegjël e të tjera.



Fusha e Pollogut shumë herë ishte larë me gjak, kështu që kudo që ta ngulje shtizën e nxirrje të kuqe si gjaku. Por kësaj here lufta kishte qënë shumë e rreptë, si asnjëherë tjetër. Qenë thyer shumë shtiza, qenë hedhur shumë mizdraqe dhe patën vërshtëlyer shumë shigjeta. Zhurmërima e shpatave paska qenë shumë e tmerrshme, paskan nxjerrë xixa nga fërkimi e paskan rënë shumë viktima. Ushtria e Skënderbeut kësaj radhe kishte qenë e ngjeshur edhe me radhët e fshatarëve të rinjë të Pollogut. Paskan marrë pjesë mandej edhe vajzat, u paskan dhënë ujë luftëtarëve dhe ua paskan lidhur plagët me fasha të përgaditura që më parë. Edhe kësaj here osmanët pësuan disfatë. Në arenën e luftës mbetën shumë ushtarë të vrarë e të plagosur për vdekje. Shumë kuaj qenë shpërndarë nga harlisja, nga tmerrri i luftës, nuk paskan ditur ç'të bënin dhe qenkan strehuar ku paskan arritur nëpër oborret e fshatarëve të Pollogut: paskan tërfëlluar dhe paskan rrëmihur dheun nga pikëllimi i thellë për humbjen e kalorësve. Hingëllima e tyre i paska përngjarë vajit.

Skënderbeu, me ushtrinë e vetë triumfalisht iu ngjiti Malit të Thatë- në mes dy fshatrave të mëdha. Në një rrafshëllartë e lidhi kalin për një dëllinjë të lartë nja tri metra e gjysmë, me një kurorë gjysmë harkore të kthyer nga jugu, e tha: „Kam dëgjuar se dëllinja jeton shumë, prandaj le të mos mbetet anonime, le ta ketë historinë e vetë si luftëtarët e kësaj ane. Me siguri do ta mbajnë mend fshatarët e këtij vendi duke bartur brez pas brezi nëpër shekuj me rrëfejat e tyre..”

- Po, o i madhi Skënderbe, do ta përmendim, do ta thërrasim “Dëllinja e Skënderbeut”, - tha një luftëtarë i kësaj ane, i cili u çua në këmbë e bërtiti: “Rroftë Skënderbeu!”

- Rroftë sa malet legjendare të Sharrit! - brohoritën të tjerët, pasi u çua në këmbë, sepse udhëheqësin e tyre, Skënderbeun, e donin shumë.

- O të dashurit e mi, s'ka ç'bën Skënderbeu, po s'ju pati juve të besës e trima siç jeni. Pa shihni si venë ushtarët osmanë grykës së Dërvenit: të thyer e të tutluar, si vala më valë, vetëm se ju triumfuat mbi ta. Po të mos ishit ju, ç'bëja unë vet? - u tha Skënderbeu, i cili qëndronte madhështorë me atë përkrenare e me atë parzmorë në të cilën që gravuar shqiponja dykrerëshe.

Prej kolikut shihej rruga nëpër të cilën tërhiqeshin ushtarët osman të thyer keqas. Ushtarët e Skënderbeut morën urdhër të uleshin, të drekonin afër Dëllinjës së

Skëndërbeut e mandej të niseshin për në Krujë.

Fshatarët, kur venin në punë, me qëllim kalonin përbri Dëllinjës së Skëndërbeut që toka të shkelej e të bëhej udhë, të kalonin gjithmonë nëpër të dhe emri i dëllinjës të mos harrohej kurrë.

Dhe s'u harrua.

Kështu Dëllinja e Skëndërbeut në këtë vend qëndroi më se pesëqind vjet, por dikur, në gjysmën e parë të shekullit njëzet, nga pakujdesia e dikujt, që mund ta ketë prerë, ose nga ngaqë që plakur dhe ashtu të thatë era mund ta ketë rrëzuar, ajo u tret, por vendi vazhdoi të mbajë të njëjtin emër edhe sot e kësaj dite.



### FJALOR

*dëllinjë* - dru a shkurre me gjethe halore gjithnjë të blerta që bën kokrra të vogla e të rumbullakëta me ngjyrë zakonisht të zezë, të kuqërremtë ose blu të errët

*triumfalisht* - si fitues

*brohoritën* - duartrokitën dhe bërtitën me zë „, roftë...”

*drekonin* - hanin drekë

*përbri* - afër ( përkrah )

*koliku* - shpat mali

*vërshëllyer* - fishkëllues



### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Në cilën kohë dhe në ç'vënd ka ndodhur ngjarja ?
- Çfarë i dhanë vajzat e Pollogut kësaj lufte ?
- Pse tregimi quhet Dëllinja e Skëndërbeut ?
- Çka u tha Skëndërbeu luftëtarëve pas fitores ?
- Si vepruan fshatarët ndaj Dëllinjës së Skëndërbeut ?
- Tani pas pesëqind vjetësh ku gjindet “ Dëllinja e Skëndërbeut “?



### KUJDES

Mësuesi gjatë orës së leximit plotësues do t' u tregojë diçka më tepër për kryetrimin shqiptar Gjergj Kastriot - Skëndërbeu.



### DETYRË

Shkruani kuptimin e tekstit në fletoren e detyrave të shtëpisë dhe lexoni në klasë.



### TË MBAJMË MEND

Gjergj Kastriot Skënderbeu është kryetrimi shqiptar, i cili plot 25 vjet u bëri ballë ushtrisë osmane. Ai ishte i biri i mbretit shqiptar, Gjon Kastrioti. Turqit Gjergjin dhe vëllezërit e tij, Stanishin dhe Raposhin i morën haraç nga mbreti me premtimin se do t'ia kthejnë, por nuk e mbajtën fjalën. Skënderbeu ka lindur në vitin 1405 e u kthye në Krujë në vitin 1443. Populli shqiptar kthimin e tij e priti me gëzim të madh. Për Skënderbeun janë shkruar shumë vepra, më të njohura janë: “ Historia e Skëndërbeut ” nga Marin Barleti, Naim Frashëri, Fan S. Noli, por për të kanë shkruar edhe të tjerët, sepse asaj kohe ai u njoh edhe si kryetrim evropian.

# KOMUNIKIM ME GOJË

## (KULTURA E TË SHPREHURIT ME GOJË)

### Ritregojmë një ngjarje që e kemi përjetuar

Para nxënësve parashtrojmë, këto pyetje me gojë:

Në rrugë, është një plak i pamundur, nuk mund te kalojë rrugën. Ç'bëjmë ne në raste të tilla, si duhet të veprojmë?



Ishit duke u rrezitur ne plazh. Papritmas u dëgjua një britmë, ishte zëri i nënës së një fëmije që po mbytej. Si do të veproje ti ?



Nëna hyri në shitore të blejë ushqime, fëmijën e afroi pranë derës, fëmija vrapoi në rrugë, i doli përpara një makine. Si veproje ti ?



Ti dhe nëna ishit në treg. Para jush një zonjë bleu banane dhe pagoi. Paratë e kthyerë i vuri në portofol dhe e futi në torbë. Por portafoli i ra poshtë. Ti e pa. Si veproje?

Zgjidhe një rën nga këto tema, përpilo një tregim dhe pastaj atë rrëfeja shokëve.

### KUJDES

Kemi komunikim gojor, pra tregimin që e përpiluam e rrëfejme me gojë.

# PËRMERAT PYETËS

Njohim gjuhën tonë

Lexoni fjalitë dhe vëreni çka tregojnë fjalët e *shkruara me të kuqe*?

1. *Kush* trokiti në derë?
2. *Kush* mungonë këtë orë mësimi?
3. *Cili* qe miku që erdhi mbrëmë ?
4. *Cilat* vajza e vizituan shoqen e sëmurë?
5. *Me se* udhëtoni nga fshati?



Fjalët e hijëzuar ( me të kuqe) janë *përemra pyetës*.



## TË MBAJMË MEND

Përemrat pyetës përdoren për të pyetur për frymorë, për sende ose për tipare të tyre.

Në gjuhën shqipe si përemra pyetës përdoren fjalët: *kush? cili?ç? çfarë? sa? me se?*

Përemri pyetës *kush* përdoret për të pyetur për njerëz ose për sende p.sh.: Kush ishte? Kush mungon?

Përemri pyetës *cili* përdoret si përcaktues i një emri, p.sh. Cili këngëtar këndoi? Cili erdhi dje?

Përemri pyetës *kush* ndryshon sipas rasave, pra lakohet.

Përemri *cili* ka trajta të veçanta të gjinisë, p.sh. Cili trokiti? Cila trokiti?

## USHTRIME

Plotësoni vendet e zbrazëta me përemra pyetës

1. \_\_\_\_\_ erdhi i fundit në klasë?
2. \_\_\_\_\_ vajza udhëtuan me tren?
3. \_\_\_\_\_ ka qënë pasdite në qytet?
4. \_\_\_\_\_ doni,ju lutem?



## DETYRË

Shkruani nga dy fjali me përemrat pyetës: *kush?bcila? cilët?ç' do, çfarë?*

## KUJDES

Në librin tuaj gjeni një tekst ku ka përemra pyetës dhe nënvizoni ata.

...Kur e thërrasin këtu aty,  
Efendiu fjalën s'ta bënte dy,  
Në dasmë e valle, nëpër zifafete  
Lugën nën mëngë ai vjen e vete.

Plasi një ditë pushka - populli në sulm  
Eja thonë shokët - lufta është në kulm  
Mirëpo efendiu qenka lodhur tepër,  
Unë - thotë kurdoherë, s'paska njeri tjetër...



## FJALOR

*zifafete* - ahengje  
*plasi* - krisi



## BISEDË RRETH POEZISË

- Cili është i pari në dasmë e valle ?
- Ç'ndodhi një ditë ?
- Si e pranon efendiu ftesën për luftë ?
- Në cilin lloj të poezisë mund ta radhisim këtë poezi ?



## TË MBAJMË MEND

Kjo është poezi satirike. Poezia satirike kritikon dhe përqesh të metat e një njeriu ose të mbarë shoqërisë. Vjershëtari sulmon këto të meta, sepse janë të dëmshme për shoqërinë. Satirën e shoqëron kurdoherë humori. Satira mund të jetë : personale dhe shoqërore. Poezi satirike kanë shkruar : H.Z.Kamberi, Ali Asllani Çajupi, Filip Shirokra, Fan S. Noli, etj.



## DETYRË

Këto dy strofa mësoni përmendsh dhe recitoni në klasë.

Sot kemi një muhabet serioz. Do të hyjmë pak si në të thella, po mos u trembi se për së shpejti do të dalim.

Duam të dimë se kush erdhi më parë në botë: këndesi apo veza ?

Mos pandehni se është aq e lehtë zgjidhja e këtij problemi.

Megjithatë unë me ndihmën tuaj, do të përpiqem ta zgjidh. Në kohët më të vjetra, thotë legjenda, këndesi u martua me pulën, pula nxori vezën, nga veza dualën pula dhe këndesa. Kështu që më së fundi hesapet u ngatërruan dhe u bënë çorbë.

Mendja njerëzore e humbi toruan.

Pula doli më parë apo veza? Le ta marrim problemin shtruar , dhe le të thellohemi duke pirë duhan.

E zëmë se pula nxori vezën. Po pulën kush e bëri ? Nuk besoj ta pjelle këndesi se pastaj del pyetja: - Kush djall e bëri këndesin ?-

Tashti le ta zëmë se pula doli nga veza. Po vezën kush e bëri ? S'besoj ta ketë bërë këndesi, se të gjithë e dimë që këndesi s'pjell vezë. E po atëherë ç'bëhet ? Si djall filloi kjo punë?

Vetëm një shpjegim na mbetet po dhe ai është pakëz si errët. Thonë plakati, dhe jo vetëm plakati, se në atë kohë kur zoti u zemërua kundra Evës, se hëngri fruta “ nga molla e ndaluar “ i dha një shkelm dhe e hodhi në tokë.

Mirëpo, siç dihet, Perëndia është shpirtmirë dhe s'kish qejf që Eva të vdiste rrugës nga uria.

Prandaj, meqenëse udhëtimi i Evës do të ishte i gjatë, Perëndia i dha një shportë me vezë që t'i hante rrugës. Të gjithë e dimë se sa i gjatë dhe i të merrshëm është inati i grues. Eva si grua që ishte, nga inati nuk i hëngri vezët që i dha zoti. Kur po zbriste nga qielli në tokë rrezet e diellit i ngrohën vezet e shportës. Kështu që, Eva vuri në tokë këmbën e mendjen ( se bota filloi se prapmi ) shporta e ngrohur nga rrezet e diellit ishte mbushur plot me pula dhe këndesa.

Këtë shpjegim shkencor e japin plakati problemit të koklavitur të vezës, të pulës dhe të këndesit.




## FJALOR

*e humbi toruan* - u hutua fare,u shastis, e humbi pusullën

*këndesi* - gjeli

*koklavitur* - ngatruar





*Pasi të lexohet disa herë tregimi, përgjigjuni në këto pyetje:  
Sipas temës çfarë tregimi është ky ?*

---

---

---

*Çka thoshte legjenda për këndesin dhe pulën ?*

---

---

---

*Nëse pula bëri vezë, atëherë pulën kush e bëri ?*

---

---

---

*Çka thonë plakat ?*

---

---

---

---

---

---

*Cili është përfundimi sipas jush ?*

---

---

---

Ku ta di unë se kush i kishte treguar se në librari gjendet ai libër, në të cilin bëhej fjalë për një princ të lumtur. I kishin thënë se një shkrimtar i vjetër e kishte shkruar atë përrallë për një princ, që në fëmijërinë e tij kishte qenë shumë i varfër.

Vetëm kaq dinte për atë përrallë të atij libri dhe as gjë më tepër. I kishin thënë se po të kishte dëshirë të mësonte më shumë për jetën e tij duhej ta blinte librin.

Mirëpo vogëlushi për të cilin e shkruaj këtë tregim, nuk kishte para. Ishte shumë i varfër, ndoshta edhe më i varfër se sa princi në fëmijërinë e tij. I qe lutur s'ëmës t'i jepte diçka nga shtëpia për ta shitur dhe me ato para ta blinte librin, por ajo i ishte përgjigjur se edhe ato pak plaçka ishin tepër të pakta.

Ëndërronte, vazhdimisht ëndërronte sesi të gjente paratë për të blerë atë libërth në librari. Por ëndërrimet nuk i sillnin gjë tjetër veçse shtimin e brengës dhe dëshirën për ta lexuar atë libër.

Një ditë vogëlushi i tha s'ëmës:

- Do të bëhem lustraxhi, nënë.

Gjeti një arkë të vogël dhe e rregulloi si lustraxhinjtë. Pastaj mori hua te fqinjët dy furça të mëdha. Diku gjeti edhe një stofë kadifeje për lustër.

Me të gjitha doli e zuri vend në kënd të rrugës kryesore, aty përbri librarisë, në vitrinën e së cilës ishte vendosur ai libër që bënte fjalë për princin e lumtur.

Por shumica e kalimtarëve, sikur ta bënë me qëllim, kur kalonin përbri tij, i shpejtonin hapat... ky nuk ishte si lustraxhinjtë e tjerë, të cilët pothuaj i detyronin me zor kalimtarët të ndaleshin për të lustruar këpucët. Nuk thërriste por as nuk e qëllonte arkën me furça për të tërhequr vëmendjen e kalimtarëve.

E ëma e luti të mos dilte më në rrugë.

- Ç'po të duhet ai libër? Rri më mirë në shtëpi. Bukë, sa për të ngrënë, kemi, biro. Kur të bëjmë para më shumë do të ta blejmë edhe librin.

Megjithatë, vogëlushi i bindej më tepër dëshirës së tij, sesa lutjeve të s'ëmës, dhe vazhdoi të dilte në rrugë edhe të nesërmen, edhe të pasnesërmen, e kështu me radhë.

Një ditë, i kënaqur se kishte arritur të tërhiqte disa kalimtarë, mendoi se i kishte grumbulluar paratë e mjaftueshme sa për të blerë librin dhe vendosi të hiqte dorë nga ajo mjeshtëri.

Por, pikërisht kur po bëhej gati të mblidhte plaçkat, u afrua një kalimtar.

- Për sa para i lustron këpucët ti, vogëlush?

- Sa të duash, xhaxha, sa të duash... unë s'kam çmim të caktuar.

- Mirë, lustroji.

Ai u ul, rrëmbeu shpejt furçat me të dyja duart dhe u mundua t'i tregonte kalimtarit se në atë punë ishte mjeshtër i përkryer.

Kalimtari, kur vuri këmbën në arkë, pyeti:

- Ke kohë që ke filluar të dalësh e të lustrosh këpucët?

- Jo, s'ka shumë që kam filluar këtë punë...

- ia ktheu dhe ngriti kokën për ta shikuar të huajin në fytyrë.

- Ti je i vogël ende. Përse e ke zgjedhur këtë punë?



- Unë jam në shkollë, xhaxha. Tani, në kohën e verës, s'kam ku të shkoj...Kjo nuk është mjeshtëria ime. Unë po e kryej sa të fitoj aq para sa për të blerë atë librin që duket në vitrinë. E shikon ? - dhe ia bëri me gisht andej.

- Më kanë treguar se në atë libër flitet për një princ, i cili në vogëli ishte i varfër. ...dhe unë i varfër jam. S'kam para as sa për ta blerë një libër.

I huaj vuri këmbën tjetër në arkë.

- I kujt je, vogëlush ?

- S'kam baba. Më kanë thënë se im atë ka shkuar diku larg për të punuar, se këtu nuk kishte punë...ai nuk është kthyer më...nëna ime lan rrobat e studentëve. Ajo është shumë e mirë. Asnjëherë nuk më ka rrahur.

I huaj lëpiu buzët, e buzëqeshja iu zhduk nga fytyra.

- Xhaxha, - thirri vogëlushi kur e pa ashtu të zymtë - Mos u zemëruat se nuk jua lustrava këpucët mirë?

- Jo, vogëlush, jo. Shumë mirë i lustrave, po më thuaj, ku banon ?

- Atje, në atë lagjen e vogël, atje ku kalon treni.

- Ke vëllezër e motra ?

- Kam një motër, por ajo është martuar. Unë jetoj vetëm me nënën.

I huaji lëvizi me shpejtësi.

- Ngrehu që këtu, shpejt, ngrehu, - i tha me një zë lutës.

- Pse xhaxha? Çfarë ju bëra ? Më lini edhe pak. Duhet të fitoj ca para për të blerë librin...këto që kam , s'më dalin...përse të ngrihem ?



- Eja, ngrehu të hyjmë në librari ta blejmë atë libër...eja,biri im...eja te babi! - e luti përsëri i huaji dhe hapi krahët, ndërsa nga sytë e tij rrokulliseshin lotët.

Vogëlushi shtangu në vend nga habia, kur u gjet në krahët e të huajit dhe i erdhi disi e papritur kur dëgjoj përsëritjen e asaj fjale:

-Biri im! Biri im! Atëherë thirri:

- Ju?! Ju babai im?

- Po, bir. Kur linde ti, unë ika nga shtëpia dhe shkova larg, shumë larg për të siguruar bukën...



### FJALOR

*lustraxhi* - pastrues i këpucëve në rrugë

*furça* - mjete për pastrimin dhe ngjyrosjen e këpucëve

*të zymtë* - të vrenjtur ( pa buzëqeshje )

*zemëruar* - i hidhëruar (i inatosur )



### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Çka kishte dëgjuar vogëlushi ?
- Në çfarë gjendje ekonomike ishte vogëlushi?
- Çfarë ëndërronte ai ?
- Me kë jetonte vogëlushi ?
- Pse vogëlushi u bë lustraxhi ?
- Me kë takohej vogëlushi derisa lustronte këpucët?



### DETYRË

Tregimin ndani në tri pjesë edhe për secilën shkruani nga disa fjali sipas përmbajtjes ?

Çfarë mësojmë nga tregimi “Libri mbi princin e lumtur”?

Ku kishte shkuar babai i vogëlushit dhe pse ?

Komentoni me fjalë tuaja takimin e vogëlushit me të huajin.  
Çka biseduan dhe si mbaroi biseda?

# FOLJA, KUPTIMI MBI TË

Njohim gjuhën tonë

Në tekstin e shkruar më poshtë, çfarë tregojnë fjalët e hijëzuara?

-*Ishte* një dimër e një dëborë,  
në mes të shëndëreut,  
gjinkalla mbetur fort shumë e gjorë,  
*erdhi* te miza e dheut...  
...ta *jap* më vonë që vjen  
dhe miza i tha : ç'bërë në verë ?  
as më thua ta di.  
Këndoja - i tha - unë atëherë



Fjalët me shkronja te kuqe tregojnë veprim, të qenë apo gjendje dhe i quajmë *folje*.

-folja  *ishte* tregon të kaluarën,  
folja *erdhi* tregon të tashmen,  
folja *ta jap* tregon të ardhmen.  
Folje janë: mbetur,bërë,di,këndoja.



## TË MBAJTMË MEND

Fjalët që tregojnë veprim, gjendje ose të qenë quhen *folje*. Foljet kanë numër vetë, kohë, zgjedhim dhe mënyrë. Folja ka numrin njëjës: punoj, ishte, erdhi, këndoja, etj. dhe numrin shumës, p.sh: punuam, ishim, erdhëm, kënduam etj. Folja ka:

vetën e parë:  *unë lexoj* -  *ne lexojmë*  
vetën e dytë:  *ti lexon* -  *ju lexoni*  
vetën e tretë:  *ai(ajo) lexon* -  *ata(ato) lexojnë*



*Folja ka tri kohë themelore :*

*koha e tashme* - lexoj, shkruaj, vrapoj;

*koha e shkuar* - kam lexuar, kam shkruar, kam vrapuar;

*koha e ardhme* - do të lexoj, do të shkruaj, do të vrapoj.

Ishte një dimër e një dëborë  
Në mes të Shënëndreut,  
Gjinkalla mbetur fort shumë e gjorë,  
Erdhi te miz' e dheut:  
“Më huaj gjë,-tha,-se jam pa ngrënë,  
Pa zoti ta çpërblen,  
Neve të dy miq po kemi qenë,  
Ta jap monë që vjen”.  
Dhe miza i tha:”Ç'bëre në verë?  
As më thua ta di.”  
“Këndoja,-i tha,-un' atëherë,  
Po mbeta keq tani.”  
Miza i tha:”Kush këndon në verë,  
S'mbledh atë q'i duhet,  
Do qajnë pastaj, faqet do çjerë,  
Urije do shuhet.”  
Gjinkalla iku me shpirt nën dhëmbë,  
Po shkante ngadale,  
Miza arriti këmbë për këmbë,  
i tha:”Dale,dale!  
Na pakë gjzë nga ç'na dha zoti,  
Po shih tjetër herë  
Sa pa shtrënguar,pa prishur moti,  
Të mbledhç gjë në verë.  
Mblith posi unë dhe mos e prish,  
Ha, ep dhe të jesë.  
Kush nuk punon,fort mirë ta dish  
Që kurrë s'ka pjesë.



## FJALOR

- mone që vjen* - motin ( vitin ) e ardhshëm.  
*faqet do çjerren* - faqet do t'i gërvishti.  
*se pa shtrënguar* - para se të acarohet, të ftohet  
*shënëndreu* - dhjetor  
*pa ngrënë* - pa hangër.



## BISEDË RRETH FABULËS

- Kush shkoi te miza e dheut në dimër?
- Pse shkoi ?
- Si iu përgjigj miza gjinkallës?
- Cila kishte të drejtë gjinkalla apo miza e dheut?

## KOMENTOJMË



Cilin e përfaqëson gjinkalla ?  
Cilin e përfaqëson miza e dheut ?  
Cila fjalë e urtë popullore i përshtatet kësaj fabule  
( *rretho të saktën* )

1. Kush nuk punon në rini nuk ka paq në pleqëri.
2. Për çdo gjë që ke dëshirë mos pandeh se është e mirë.
3. Punëtori gjen nderë, përtonjësi është i mjerë.



## TË MBAJ MË MEND

Fabula ( përallëza ) është formë letrare më e lashtë epike. Fabulisti më i njohur është Ezopi. Fabula është tregim alegorik në vargje dhe në prozë, me karakter moral e edukativ. Fabula thumbon, kritikon, përqesh veset negative të njeriut dhe shoqërisë përmes kafshëve, shpendëve etj. Kafsha në fabulë personifikon njeriun që ngjason me karakterin e saj, p.sh: qengji përfaqëson njeriun e butë, naiv; ujku njeriun agresiv dhe grabitqar; dhelpra dinakun etj. Në letërsinë shqiptare fabula kanë shkruar Naimi, Çajupi etj.

### Fjalë të urta për punën


1. "Me punë fiton, pa punë në dëm shkon"
2. "Mos e lër punën për pastaj, çdo kohë ka punën e saj"
3. "Punonjësi është i mjerë, punëtorin e gjen në derë"
4. "Njeriu që vetëm për vete punon është si një dru që pemë s'lëshon".







## MODULI - 3



39. *Ushtrime në klasë (Folja)*
40. Gjëgjëza
41. O sa bukur o sa mirë
42. Pasuria më e çmuar
43. Muji dhe Zanat
44. *Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë*
45. *Fjalja e përbërë*
46. Mëma
47. Armiku i vjetër, Ujku delengrënës
48. *Fjalët me kuptim antonimik, sinonimik dhe homonimik*
49. Mëngjesi
50. Kënga me lot
51. *Fjalët me kuptim zvogëlues dhe përkëdhelës*
52. Më fal kanarinë
53. Përgjerimi për jug
54. *Ligjerata e drejtë dhe e zhdrejtë*
55. Macja e preferuar e padronës së shtëpisë
56. Kultura e mediave (radioja, tv etj.)
57. *Pikësimi në ligjëratën e drejtë*



# USHTRIME RRETH FOLJES

Njohim gjuhën tonë

## USHTRIME

*Dalloni kohët e foljeve në këto fjali:*



1. Visari e lexonte lektyrën.
2. Visari e lexon lektyrën.
3. Visari do të lexojë lektyrën.

1. Hana dje u zgjua herët.
2. Hana zgjohet gjithnjë herët.
3. Hana te djelën do të zgjohet më vonë.

1. Jetonte dikur Muji dhe vëllai i tij Halili.
2. Muji dhe Halili jetojnë nëpër librat tona.
3. Muji dhe Halili do të jetojnë edhe shumë shekuj.



Shkruaj dy folje në kohën e tashme: →

Shkruaj dy folje në kohën e shkuar: →

Shkruaj dy folje në kohën e ardhme: →



## DETYRË

Shkruaj dy fjali ku folja do të përdoret në kohën e tashme, dy fjali ku folja do të jetë në kohën e shkuar dhe dy fjali ku folja do të jetë në kohën e ardhme.

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_

**KUJDES:** Në tekstin "Gjinkalla dhe mizë e dheut", gjeni foljet dhe në fletoren e detyrave të shtëpisë shkruani, kohën, numrin dhe vetën e tyre.

# GJËEGJËZAT



## TË MBAJMË MEND



Gjëegjëzat janë thënie të shkurtëra popullore në formë të pyetjeve dhe kanë për qëllim të zbulojnë zgjuarsinë dhe mendjemprehtësinë e bashkëbiseduesit. Aty zakonisht përshkruhet diçka në formë enigme, kurse bashkëbiseduesit duhet ta gjejnë. Këta janë interesante sidomos për të vegjëlit. Gjëegjëzat fillojnë kështu : “ ç’është një.....e ç’është një” dhe në fund përdoret pikëpyetja.


### Ja disa gjëegjëza

- Një poçë ( vorbë ) kos përmbi çati ( Hëna )
- Hija në ujë s’laget ( Dielli )
- Katër motra venë e vinë, njëra tjetrën s’e mbërrinë ( Rrotat e qerres )
- Dhjetë motra me nga një tasë mbi krye ( Gishtat dhe thonjtë )
- Ka s’është e brirë ka, gomar s’është e samar ka “ ngado shkon argjend lëshon ( Kërmilli )
- Kudo vete shtëpinë e ka me vete ( Breshka )
- Një baba ka dymbëdhjetë djem secili djalë ka tridhjetë bija me njëren faqe të bardhë e tjetrën të zezë ( Viti,muaj,dita,nata )
- Dy shigjeta pendëzeza, tek i lëshon atje venë ( Sytë ) etj.



## DETYRË

Shkruani në fletoret e detyrave të shtëpisë nga pesë gjëegjëza!



\_\_\_\_\_


\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Sa më pëlqen blegërima, zër'i ëmbl' e bagëtisë,  
Qengji edhe kec'i bukur, që rri më gjunj' e pi sisë!  
Përhapur bagëtija, në për sheshe, në për brinja,  
Nër lajthi e në për dushnja, ndër murriza, në dëllinja,  
Bijen zilet e këmborët, dhe fyelli e xhuraja,  
Dhe mbleron e gjelbërojnë fusha, male, brigje, maja,  
Edhe gjithë gjë e gjallë, ndjen në zemrë një dëshirë,  
Një gas t'ëmbël' e të shumë. O! sa bukur e sa mirë!  
Pelën e ndjek mëz'i bukur, lopës i vete viçi pas,  
Dellëndyshja punëtore, bën folenë me të math gas.  
Ogiçi ikën përpara, i bije tufës në ballë,  
Me zemrë të çelur shumë, vete si trimi me pallë,  
Zoqtë zënë këng'e valle dhe po kërcëjn' e këndojnë,  
E në për dega me lule, si ëngjëllit fluturojnë,  
Larashi ngrihet përpjetë, thua q'i shpije Perëndisë,  
Një lëvdatë të bekuar për gëzim të gjithësisë.  
...Veç një njeri shoh pa punë dhe të mjer' e të bregosur,  
Të këputur, të mejtuar, të grisur e të rreçkosur,  
Lipën i gjori pa shpresë, se atje e pru përtimi,  
S'i ka mbetur gaz në zemrë, se s'i la vënt hidhërimi;  
Është njeri, si dhe neve, pa ep-i-ni, o të pasur,  
E mos e lini të urët dhe të mjer' e buzë-plasur,  
Se përtimë' i zi, q'e pruri të gjorin më këtë ditë,  
Nuk' e dimë vet' e xgjodhi, apo ja dhanë perënditë;



## FJALOR

**kec** - i vogli i dhisë

**xhuraja** - vegël muzikore

**ogiçi** - dash i madh me këmborë

**parajs** - xhenet



### BISEDË RRETH FRAGMENTIT

- Cili shkrimtar e ka shkruar këtë vjershë ( ..... ) ?
- Për çka bën fjalë poeti në katër vargjet e para ?
- Ne vargjet në vazhdim çka përshkruan ?



### TË MBAJMË MEND

Fragmenti është marrë nga poema, Bagëti e Bujqësi. Këtë poemë e ka shkruar poeti i madh shqiptar, bilbili i gjuhës sonë, Naim Frashëri (1846-1900). Poema është një rrëfim liriko - epik e shkruar në vargje. Poema dallohet nga krijimet lirike dhe epike, sepse këtu kemi ndërthurje të gjendjes shpirtërore të poetit me atë të heroit. Naim Frashëri përmes veprës në vete, te shqiptarët ngjalli dhe zgjoi dashurinë për të kaluarën, për historinë, për traditën kombëtare, për figurat kombëtare, ngjalli dashuri për gjuhën, për shkollën, për diturinë etj. Naimi u lind në Frashër të Shqipërisë në vitin 1846. Ishte ideologu dhe frymëzuesi më i denjë i Rilindjes Kombëtare. Tërë jetën ia kushtoi atdheut dhe popullit të tij. Naim Frashëri ka shkruar shumë vjersha të bukura. Ka shkruar veprat : Histori e Skëndërbeut, Lulet e Verës, Bagëti e Bujqësi dhe shumë vepra të tjera.



### DETYRË

Kërkoni nga mësuesja/mësuesi t'u shpjegojë edhe diçka tjetër nga poeti Naim Frashëri, ose t'u lexojë në orën e mësimit diçka tjetër.



Dionis Bubani

Sahati ecte me tik tak,  
Skënderi sillej kot vërdallë,  
Dëgjo një zë:  
-Afrohu pak !  
....Në dhomë kush i fliste vallë ?

Fliste sahati për çudi,  
siç duket ish sahati i zoti:  
-Po të flas un:djalosh,se ti,  
e kalon kohën kot së koti...


Dhe nuk po bëhesh hiç merak  
se koha shkon me cap të lehtë...  
Un'eci shpejt:tik-tak,tik-tak,  
ti asnjë hap nuk bën në jetë!

Po humb tërë pasurinë,  
mund që ta gjesh ti përsëri,  
po humbe kohën dhe lirinë  
nuk e gjen dot më kurrsesi!



Dionis Bubani u lind në Bukuresht më 18 shtator 1926. Shkollimin fillor dhe atë të mesëm e kreu në Bukuresht në vitin 1940.

Dionis Bubani vdiq në Tiranë më 10 shkurt 2006. Veprat e tij janë: "Aventurat e Çapaçulit nëpër vend e botë", cikël librash, "Dardha e ka bishtin prapa", "Çështje personale", "Pazar i mbarë", "Ujku tre dentisti", "Maçoku te patoku", "Një aventur në Tirnë", "Papagalli në Doganë", "Poezi Shqipe", "Shaka tragjike të jetës sime", "Urgjent sekret dhe rezervat", "Biçikleta me tri rrota" e të tjera.





## BISEDË RRETH POEZISË

Poezia ka katër strofa. Aty mësojmë se koha dhe liria janë pasuria më e madhe për njeriun. Ai që e çmon kohën dhe punën pa ndërprerë, nuk do të vuajë nga varfëria.

- - Çka punonte në dhomën e Skënderit ?
- - Çka i tha ora Skënderit ?
- - Si ecte ora dhe si Skënderi ?
- - Cila ishte më e vlefshme, pasuria apo koha dhe liria ?
- - Strofën e fundit komentoni në klasë bashkë me mësuesin/mësuesen!



## FJALOR

*sahati* - ora

*sillet vërdallë* - sillet nëpër dhomë pa orientim

*kot së koti* - e kalon kohën pa punë ( e humb kohën kot )

*hiç* - aspak

*çap* - hap

*kurrresi* - asesi (asnjëherë)



## TË MBAJMË MEND

Kjo është poezi humoristike . Atë e ka shkruar shkrimtari i njohur Dionis Bubani. Dionisi ka shkruar shumë skica,tregime, skeçe, fabula, komedi edhe shumë poezi humoristike.



## DETYRË

Poezinë mësoni përmendsh dhe recitoni në klasë!

**Fjalë e urtë për punën:**

**“Njeriu me punë fiton, pa punë dëm shkon”**

Na ish që moti , andej lart, në Klladushin e Krahinës kreshnike, afër Jutbinës, një malësor që kish dy djem: Mujin dhe Halilin. Kish edhe një vajzë: Kunjën, Malësori ish i fortë, trim. Siç ish vetë, ashtu i kish edhe djemtë. Muji s' e kish moshën sa e kish shtatin. Dhe ishte i mençur, i matur, i duruar. Ashtu ish edhe Halili, i vogli. Mirëpo i ati, malësori, ishte njeri shumë nevojtar, mezi e nxirrte bukën e kripën. Kështu, sapo hodhi shtat i madhi, Muji, e u bë për punë, shkoi e pajtoi rrogtar për bukën e gojës tek një zotëri. Ky zotëri ish i pasur dhe e bëri Mujin bari lopësh: i dha tufën, e dërgoi në bjeshkë të kullosë.

Këtë punë bënte tani Muji: ngrihej menatë, sapo zinin të faleshin yjet e të vagëllonte dita, vinte një krodhe bukë e ca thërime kripë në trastë, merrte shkopin në dorë, vinte përpara lopët e zotërisë e ngjitej bjeshkëve të larta. I kulloste gjithë ditën, hante bukën e kripën, pinte ujë të ftohtë krojeve dhe prehej mrizeve; s' linte rrugë e shteg pa shkëlur, hidhej sot këtu, nesër përtej, e shpinte tufën nëpër kullota të mira; mbremave e kthente në shtëpi, tek i zoti. Ky dilte i milte e çuditej: qumështi lumë. S' kish enë ku ta vinte. Ama Mujin e mbante gjithë me bukë e kripë.

Sot mirë, nesër mirë, një ditë, s' di se si, Muji i humbi lopët nëpër bjeshkë. I kërkoi pas tragës, s' la lug e shteg pa shkëlur, gjer në të mugëtit. Nuk i gjeti dot. Atë natë nuk u kthye në shtëpi . Qysh të kthehej vetë, pa lopët? I zoti do të bënte potere të madhe, barinj të tjerë, shokët, do ta qeshnin.

Si u lodh së bredhuri shteg më shteg e lug më lug kur perëndoi dielli prapa maleve, Muji u ul i lodhur e i pikëlluar pranë një shkëmbi. Aty e zuri nata. Një natë e zezë pa yje, pa hënë. Me që s' kish ç' të bënte, tha të marrë një sy gjumë, të presë gjersa të agojë dita e pastaj të dalë rishtas bjeshkëve për ta kërkuar lopët.

Mirëpo te shkëmbi , ku kish ndenjtur të prehej na qenkeshin dy djepe me dy foshnja të njoma. Këto foshnja britnin e qanin me të madhe. Muji u afrua t' i shikojë. I pa se ishin shumë të mitura dhe ju dhimbsën. U përkundi lehtë djepët, i vuri në gjumë.

Pas mesante, papritur, u dukën majë shkëmbit dy drita të bardha që të vërbonin sytë. Jo, s' ishin drita, po ishin dy zana të veshura me dritë. Ato e panë Mujin tek po përkundte lehtë djepet e foshnjave, e dëgjuan tek u fliste butë, ëmbël. U çuditën dhe e pyetën.

- Cili je ti ? Ç' kërkon në këtë vend ? A mos ke humbur gjësend e ke dalë ta kërkosh ?  
- Unë jam bari lopësh, rrogëtar për bukë e kripë, - u tha Muji. - Gjithë ditën bredh bjeshkëve pas kullotave. Sot më ndodhi një e keqe e madhe: humba lopët e tim zoti e dola t' i kërktoj.





Nata më zuri në këtë vend e u ula të prehem, të fle. S'munda të mbyll syt, se qanin këto dy foshnja. M'u dhimbsën e u përkunda djepet. Mezi i vura në gjumë...Po ju ç'jini ? Ç'kini tërë këtë dritë të bardhë që ju ka veshur fytyrën e shtatin ?

Ato e njohën sakaq Mujin se e kishin parë shumë herë, nga larg, bjeshkëve e mrizave tek kulloste e mrizonte lopët. I thanë:

- Ne jemi zana, Muj. Dualëm, si çdo natë, lartë e poshtë nëpër botë që të ndihmojmë njerëzit e mirë e të drejtë. I lamë foshnjat vetë. Ti, Muj, paske qenë njeri i mirë, i paske përkundur e i paske vënë në gjumë . Rrofsh e qofsh. Na thuaj tani, O Muj, ç'kërkon të të japim në për të mirën që na bëre? A do forcë, Muj? A do luftë të luftosh ? A do mall e gjë? A do dije ? A do gjuhë? Kërko ç'të duash e ne do të ta japim.

Ja ç'u thotë Muji zanave:

- Mua, moj zana të bardha, barinjët e tjerë më ngacmojnë, më bien në qafë. A e keni në dorë të më bëni të fortë që t'i mund të gjithë ?

- Vetëm kaq do, Muj ?

- Kaq.

I thotë zana zanës:

- Motër, ai i japim Mujit qumësht gjiri, që ta bëjmë të fortë ?

-I japim, motër.

Zanat i japin Mujit qumësht gjiri dhe e ngrijnë me tri pika, Muji e ndejn veten menjëherë shumë të fortë sa mund të shkulë nga rrënja një lis bjeshke. Zanat i thonë:

- Pa të të shohim, Muj, sa i fortë që je tani. Kape atë shkëmb që ke pranë dhe ngrije lart.

Zanat i tregojnë Mujit një shkëmb që peshon tri pendë qe bashkë. Muji ulet, e kap shkëmbin, e shkul nga vendi , peshon në duar, e ngre gjer në te nyja e këmbës. Më lartë nuk e ngre dot. E lëshon poshtë:

Prapë i thotë zana zanës:

- Duhet t'i japim edhe pak qumësht Mujit tonë që të bëhet më i fortë.

Muji pi rishtas qumësht zane, e kap shkëmbin, e peshon në duar, e ngre gjer në gju. Më lart nuk e ngre dot. E lëshon poshtë e ulet e të prehet.

- T'i japim edhe pak gji Mujit tonë - thonë zanat.

I japin edhe një herë gji. Mujit i shtohet fuqia. Merr shkëmbin, e peshon mirë e mirë në duar, e ngre gjer në brez. Më lartë nuk e ngre dot. Zanat e shohin e i thonë shoqja shoqes:

- Prap duhet t'i japim gji Mujit.

Muji pi edhe një herë qumësht zane e bëhet më i fortë se një dragua. E ngre shkëmbin edhe e vë në cep të supit, e mban lart dhe qëndron shtyllë, s'tundet fare. I pyet zanat :

- Më thoni, moj zana të bardha ku ta flak këtë shkëmb? Ta hedh në Lugjet e Verdha apo ta flak në Fushë të Jutbinës?

Zanat e shikojnë me buzë në gaz e i thonë shoqja shoqes:

- Të mos i japim më gji Mujit, se po t'i japim e shemb botën anembanë.

Pastaj zanat nisin e pyesin Mujin hollë e hollë për nënë e babë, për vëlla e motër, për gjithë Jutbinën e Krahinën. Ndërkaq hëna e bardhë, rri lart mbi krye të tyre e i kqyr si kuvendojnë. Hija e shkëmbit të madh nis e zgjatet prapa, mbi gremina. Në bjeshkë del e fryn flladi i freskët i natës. Shushurijnë gjethet e aheve, këndojnë krojet e ftohtë e ua mbajnë zërin lumenjve që hidhen prag më prag.

Si e pyesin mirë e mirë, ja ç'i thonë zanat Mujit:

- O Muj, ne duam të të bëjmë vëllam. Ti ç'thua?

- Vëllam më doni, vëllam më paçi, o zana të bardha, - u thotë Muji. - Kur të jem ngushtë do t'ju thërres të vini të më jepni dorën; kur t'ju fyej ndokush, të më thërrisni e unë do të hidhem t'ju marr krahun.

-Të lumtë goja, vëllam: kur të jesh ngushtë, vikat e do të vimë, kur të na fyejë ndokush, do të të ankohe mi.

Kur u nis të përskuqë qiellin agu i ditës, zanat marrin djepet, i varin me naplungë në shpinë e zhduken, duke lënë prapa një vilar drite. Muji fërkon sytë e mundohet të shohë se ç'u bënë zanat, po nuk sheh veçse tragën e atij vilarit që tretet nëpër bjeshkë. Dhe thotë me vete: "A mos pash ëndërr?" shkron lan syt në prua. Ujët e ftohtë e këndell. Aty pranë sheh një gur të madhë që nuk mbanin dot as njëzet burra bashkë. Ulet, e mbërthen me të dy duart dhe e vë në sup. Qesh e thot: "Jo, s'pashë ëndërr" dhe e hedh gurin, që kërcen gërnx gjersa zhduket në luginë. Oshëtijnë gjithë bjeshkët...

Del pastaj e kërkon lopët. I gjen të nginjura e sisëplota: i merr përpara e nisat për në shtëpi. Kur bie në fushë të Jutbinës, dielli ka marë gjithë dhenë. Aty, në fushë, janë mbledhur gjithë shokët e tij, barinjtë, e lodrojnë shoq me shoq. Kur e shohin Mujin, zënë e i hedhin romuze:

- Zbrite, o ngordhaq?

Muji u vrenjt. S'u përgjegj.

- Nuk të hëngrën ujë me gjithë lopë?

Prap u vrenjt e prap s'u përgjegj.

- A do të luftojmë bashkë ?

Kësaj here Muji qeshi e u përgjegj:

- Dua

- S'ke frikë se të mbërthejmë me krahët për tokë ?

- Jo, s'kam.

Muji përvesh llërët. Kur i afrohet bariu më i fortë e mundohet ta zerë rrokas, ta hedhë poshtë, Muji e përfshin në krahë, e hedh dhe e pret dy-tri herë në pëllëmbë, pastaj e vërtit pesë kunupë përpjetë...

Barinjtë e shikojnë të trembur: "Ç'qenka bërë kështu Muji ynë ?" dhe prapsen, kthejnë shpinën e ikin vrap.

- A ka ndonjë tjetër që do luftë ? - pyet Muji.

Po s'ka kush t'i përgjigjet, se të gjithë ua kanë mbathur me të katërta.

Muji merr lopët e ja shpie të zot.

Merri, or ti, lopët e gjej bari tjetër.

Pastaj kthehet në Klladushë të shohë nënën e babën, vëllanë e motrën.

Që atë ditë Muji nis e punon për vete: gjuan bjeshkëve. Tmerrohet ujëria kur i ndjen hapin.

Më tej nis e lufton për vendin e vet.



### BISEDË RRETH KËNGËS LEGJENDARE

- Me cilin trim legjendar shqiptar u njohëm në këtë pjesë?
- Pse Muji dëshironte të bëhet i fortë ?
- Kush i ndihmoi Mujit për të gjetur tufën me lop dhe të bëhet i fortë ?
- Cilat qenie të mbinatyrshme përmenden aty ?
- Ç'veprime kryejnë zanat në këtë pjesë ?

# FJALIA E THJESHTË DHE FJALIA E PËRBËRË

Njohim gjuhën tonë

## Të rikujtohem

Fjali quhet një togfjalësh ose një fjalë e vetme që shpreh një mendim të caktuar. Për nga përbërja fjalitë mund të jenë të thjeshta dhe të përbëra.

### Fjalitë e thjeshta

Fjalitë e thjeshta përbëhen prej kryefjalës, kallëzuesit dhe prej gjymtyrëve plotësues. Kjo fjalë mund të jetë:

- Kryefjalë + kallëzues + gjymtyrë plotësuese,
- Kryefjalë + kallëzues,
- Vetëm kryefjalë, vetëm kallëzues.

#### SHAMBUJ

1. Nxënësi lexon.
2. Nxënësi lexon librin.
3. Peshkon . Natë . Shi . Mjegull. etj.



Nxënësi lexon.

Nxënësi lexon librin.

Fjalitë

Peshkon

Natë. Shi. Mjegull.

#### DETYRË

Sipas shembujve të lartëshënuar shkruani nga dy fjalë për çdonjërin lloj.



\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

# FJALIA E PËRBËRË

Njohim gjuhën tonë



## TË MBAJMË MEND

Fjalja është e përbërë kur formohet prej dy ose më shumë pjesësh. Kjo fjali ka aq pjesë sa ka kallëzues.

### SHEMBUJ

1. Në mëngjes cingërroi zilja, që lajmëroi fillimin e mësimit.
2. Të gjithë nxënësit u rreshtuan, pastaj hynë brenda.
3. Mësimi fillon në ora tetë, prandaj të gjithë duhet të jenë në shkollë.

Fjalitë e mësipërme janë të përbëra, sepse kanë nga dy kallëzues.

*Në mëngjes cingërroi zilja + që lajmëroi fillimin e mësimit.*

### KUJDES

Kështu veprohet edhe me fjalinë e tretë edhe shumë të tjera.

Nga fjalia e thjeshtë në fjalinë e përbërë kalojmë duke i shtuar fjalisë së thjeshtë edhe një tjetër pjesë. P.sh.

1. Hana reciton bukur. ( fjali e thjeshtë )
2. Hana reciton bukur, prandaj merr pjesë në grupin recitues. (fjali e përbërë)



## DETYRA DHE USHTRIME

a) Plotësoni fjalitë e mëposhtme në mënyrë që të formoni fjali të përbëra :

- 1 Erdhi një shtatori dhe \_\_\_\_\_
2. Dje nuk shkuam në shëtitje, sepse \_\_\_\_\_
- 3 Petriti ishte i sëmurë, prandaj \_\_\_\_\_
- 4 Ata shkuan në teatër kurse ne \_\_\_\_\_

b) Fjalitë e përbëra shndëroni në të thjeshta: sipas shembullit 1

1. Kur vinë mendtë, ikin dhentë.

1. Kur vinë mendtë \_\_\_\_\_

2. Ikin dhentë.

2. Të gjithë e dimë, se toka është e rumbullakët.

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. Agimi prishi kodeksin e shkollës, prandaj e larguan nga shkolla

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

( Secilën e ndani në dy pjesë dhe i shkruani në fletore )

Fjal'e e bukur, fjal'e shenjtë  
thellë zemrë që tingëllon,  
s'ka në botë gjë m'e shtrenjtë  
s'ka si mëmë kur kujton!


Mëmë, mëmë, frym'e larë  
rreze drite, yll qjellor,  
plot mëshir'e mall të zjarrtë

Që nga gjinjtë e saj të dliërë  
vilet jeta pa shterim  
Që nga zemr'e saj ka mbirë  
dashuri dhe mallëngjim.

Si nër gaz dhe nër vajtje,  
veç një mëmë të lartën,  
sa ka frym'e sa ka rrojtje,  
mendjes kurrë s'të harron.

Çdo rreziku rri të ruan,  
bën detyrë si luftar,  
si dëshmori heq e vuan  
për të zemrës' saj thesar

Kush s'di vlerën e një nëne  
është pa ndjenj'e shpirt mizor,  
bir skëterre e frymë nëne,  
është i vet tradhëtor!



### FJALOR

*vilet jeta* - buron jeta (lind jeta)

*shpirtmizor* - pa ndenja ( është pa ndjenjë e shpirtmizor)

*skëterr* - errësirë ( ferr)

*neme* - mallkim ( frymë neme )

*të faleshin* - të shuheshin

*krodhe* - pjesë e jashtme e fortë e bukës, kore

*bjeshkë* - mal me lartësi ku verës barinjtë ruajnë delet

*mriz= hije* - vendi ku në vapë mrizojnë delet ( bagëtia )

*vëllan* - shokë të ngushtë ( pinin gjakun e njëri - tjetrit )

*konop* - litar

Në vargun: *Rreze drite, yll pjellor, hasim figurën e metaforës.*

**Metafora** sajohet atëherë kur me anën e kuptimit të një fjale emërtojmë një fjalë tjetër, me të cilën e para ka marrëdhënie ngjashmërie, p.sh: **buzë mali, grykë pushke, rruga gjarpëron, deti tërbohet etj.**

Metafora përdoret në lirikë, por edhe në të folmet e popullit dhe në çdo rast kryen një funksion figurativ. **Dritarja shikon** kah rruga - folja **shikon** ka kuptimin figurativ, sepse dritarja nuk shikon.

*Bashkë me mësuesen gjeni edhe ndonjë metaforë tjetër.*



### BISEDË RRETH POEZISË

- Poezia mban titullin simbolik "Mëma". Pse ?
- Cilat ndjenja për nënën ngjall kjo poezi?
- Çfarë do të thotë Asdreni me vargjet :

**"Qe nga zemr'e saj ka mbirë  
Dashuria dhe mallëngjim...?"**

- Çfarë thotë Asdreni për të gjithë ata që s'e dinë vlerën e nënës?



### DETYRË

Mësoni vjershën përmendsh dhe bëni gara në klasë se kush do të recitojë më bukur.

Një ditë prej ditësh, Ugurzeza zgjon Shpendin herët. Edhe ma herët së ditëve tjera. Sa kishte nisë fesku.

- Çohu, u ba dreka e pa i lëshue delet!  
- Galosh, Bardhosh, Trumosh! - ndjell qent me i marë me vedi, si për ditë. Kambën nuk e lunte pa ta.

Mirëpo, Ugurzeza nuk do me ia lëshue at ditë. Jo nuk don me ia lëshue at ditë. Ajo don me i mbajtë në shtëpi. Kush e din pse!...Kurse Shpendi nuk ngul këmbë, t'i marri me veti, sepse donte me ia çue fjalën në vend gogës.

Edhe, si del me dele në ledina, shif çka ban Ugurzeza. Galoshin, Bardhoshin e Trumoshin, i mashtron e i mbyll në shtatë dryna. Në shtatë dryna të mëdhaj, mos me mujtë askush me i çelë.

- Edhe, - i përdhunon Ugurzeza. - A ju bana mirë?...A ju bana mirë?...Tash delni në muejshit!...Ehe!...

Kurse Shpendi, pa i shkue mendja se do t'i kërcnohet fare rreziku, u rrin deleve përpara.



Kur, oh fatkeqsi!...

Pa pritë pa kujtue! - i del përpara au armiku i vjetër,

Ujku Delengrënës edhe iapret me za të vrazhdë e krenueshëm:

- A jeeee tiii Shpeeeendiii?
- Po
- Mos të frigohen delet se me ty kam punë!
- Me mue!
- Po me ty edhe me kurrkend tjetër.
- Çka ke me mue, o ujku i malit ?
- Kam që sot të ka ardhë dita e dekës edhe kam me të ngrënë.
- Me më ngranë.
- Pse, o ujku malit ?

- Qe sepse: sot, mu sot, janë mbushë rrafsh pesëmbëdhjetë vjetë, qyshse unë të kam çue te Plaka Ugurzezë me të rritë. Jarani të madhe kam me at plakë! A po sheh qysh ma ka mbajtë fjalën? Sot pesëmbëdhjetë vjetë, sot pesëmbëdhjetë vjetë, i pata thënë Ugurzezës: "Në qoftë se kur të rritet Zogu i njeriut e të bahet pesëmbëdhjetë vjeç, ma çet me e ngranë, unë po ta jap".

E ajo bektaresha me paska mbajtë mirëfjalën. Atëherë ke qenë shumë i vogël, sa grima. Tash qënke rritë emajë, tamam përgojën teme. Unë jam ujk.

Mue më ka anda me hangër diçka majmë, kështu sikurse je ti.

Unë jam ujk, qe ku i kam dhambët e mprehtë me ta ngjitë e me të ngranë!

- Po, i kujt kam qenë, o ujku i malit?
- I Bardhec Shpendit prej Arnjeti, katund jo ma larg se dy sahat prej këtuhit.
- I Bardhec Shpeendiit?!...
- Po
- Prej Arnjeeetiii?!
- Po
- Si kam ra në dorë tande ?

Puna ka qenë kështu: baba yt dhe nana jote, Bardheci e Ajkuna, kishin shtatë çika pa asnji djalë, Nji ditë prej ditësh, Bardheci lëshon delet edhe, pa pritë, pa kujtue! - i humbin sysh prej mjegullës. Dal unë si ujk edhe shof tue i kërkue. Bile isha shumë i untë, mu sikurse sot. E pyes:”Çka të ka humbë? Çka kërkon?”. E ai më përgjigjet: “ Më kanë humbë delet. Kah t’i lypi? Ku t’i gjej?” Unë, si ujk i zotohem se kam me ia gjetë, por me kusht që të ma jepte atë, qe i kishte lindë atë ditë në shtëpi. E ai ma jep besën se po. Sepse kujtonte e mos i ka pjellë Molla, e une po ia kërkoj viçin e saj. Kurse ai që pat lindë at ditë në shtëpinë e Bardhec Shpendit, ishe ti. Shum herë kam qenë n’at katund. Bile tash së fundi u kam ore pesë lopë në fyt e tre gomarë. Edhe kështu, pra,ka qenë puna. A more vesh?

Eu thotë vetëmëveti Shpendi, si paska pas qenë jeta ime. I kujtohet ajo natë te Lulash Daka i Frashnjetit. I kujtohet ai Bardheci, që ia kishte ngulë sytë e nuk ia ndante. I kujtohet gjithçka i kishte folë, gjithçka i kishte tregue. Ai paska pas qenë baba im, thotë Shpendi. Ai. Unë n’Arnjet paskam nanë,babë e motra!...

- Mirë, o ujku i malit, a ban me më ngranë nji ditë tjetër?
- Jo, nuk ban !...
- Atëherë, a i dhambët e mprehtë.

A ka ujk që nuk i ka dhambët e mprehtë?

- Po nji gja tjetër ?
- Hë!

- Mbasi sot paskam me i dhanë fund jetës sime prej dhambëve të tu, a ban veç pak me hypë mbi lisë sa të pëfalem me këto vende, ku u rrita ?

- Ban. Si nuk ban ?

Shpendi hyp pat, pat, pat majë lisi, që ndodhej aty afër edhe ja nis e thëret në tanë zanin:

- Ujt, Galosh!...Ujt, Bardhosh!...Ujt, Trumosh!...Nuk ndëgjojnë.

- Ujt, Galosh!...Ujt, Bardhosh!...Ujt, Trumosh!...Tash dëgjojnë.

Me të gjitha forcat që kishin, thejnë të shtatë drynat e mërthehen me turirin ma të madh kah Shpendi.

Kur mbërrinjë çka me pa ?!..

Ujku Delengrënës, i cili ishte ulë galuc, kah pret Shpendin të zbritë prej lisi, me e ngranë.





- Tej, Galosh!...Tej,Bardhosh!...Tej,Trumosh!...

Ndërsen qent n'Ujkun Delengrënës.

Çfarë vigma e sulmi ngjanë?!...Me mbetë pa mend. Të tre qent ia qesin rrethin Ujkut Delengrënës e t'i gjuhën me shpejtësin ma të rrufeshme, ta bajnë copa copa.

Mandej zbret Shpendi prej lisi. Tanë i gëzuem përqaфон qent, mbledhë delet edhe niset për në shtëpi.

- Tej, Galosh!...Tej,Bardhosh!...Tej,Trumosh!...

Ndërsen qent n'Ujkun Delengrënës.

Çfarë vigma e sulmi ngjanë?!...Me mbetë pa mend. Të tre qent ia qesin rrethin Ujkut Delengrënës e t'i gjuhën me shpejtësin ma të rrufeshme, ta bajnë copa copa.

Mandej zbret Shpendi prej lisi. Tanë i gëzuem përqaфон qent, mbledhë delet edhe niset për në shtëpi.

Fragment nga romani “Lugjet e verdha”- R. Hoxha



### FJALOR

*torishte* - ahuri, përkatësisht radha ku rrinë delet

*dekes* - vdekjes

*jarani* - miqësi

*të majme* - të trashë ( të madhe )



### BISEDË RRETH FRAGMENTIT

- Ku shkonte Shpendi çdo ditë ?
- Cilët i merrte me vete ?
- Pse Plaka Ugurzezë i mbylli qentë ?
- Kujt ia dorëzoi Shpendin dhe pse ?
- Çfarë biseduan Shpendi dhe Ujku Delengrënës?
- Si e kuptoi Shpendi se i kujt ka qenë ?
- Si e përfundon Ujku Delengrënës kur priste ta hajë Shpendin ?



### MËSOJMË

Fragmenti është marrë nga romani për fëmijë “Lugjet e verdha”.

Në romanin për fëmijë shkrimtari bënë fjalë për ngjarje interesante që te fëmijët zgjojnë interesim dhe nxisin kureshtjen e tyre.

Aty hasim tema edukative, arsimore, shkencore, fantastike etj.



### DETYRË

Librin “Lugjet e Verdha” merre në bibliotekë dhe lexoje si lektyrë shkollore, sepse është shumë interesant. Aty do të njiheni me jetën e banorëve të fshatit Arnjet, me Bardhecin dhe Ajkunën, prindërit e Shpendit, me përjetimet e Shpendit e shumë momente interesante.


# SINONIMET, ANTONIMET, HOMONIMET

Njohim gjuhën tonë



## TË MBAJMË MEND

- Sinonimet** janë fjalë që ndryshojnë nga forma, por që kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt p.sh. dhëlpër - skile
- Homonimet** janë fjalë që shkruhen dhe shqiptohen njësoj, por që kanë kuptim të ndryshëm p.sh. Bari-lloj kullose, bari- çoban
- Antonimet** janë fjalë që kanë kuptim të kundërt. Më shpeshë antonimet tregojnë cilësi, p.sh. i mirë - i keq



## SHEMBUJ

1. Në fshat jeta është idilike.
2. Në katund bujku punon arat.  
Këtu fjala **fshat** dhe **katund** janë sinonime, pra janë fjalë të ndryshme, por kanë të njëjtin kuptim.
  
1. Lepuri ka vesh të mëdhenj.
2. Ai ka vesh një pallto të trashë.  
Fjala **vesh** ka kuptime të ndryshme. Në fjalinë e parë fjala **vesh** e kryen funksionin e emrit, kurse në fjalinë e dytë fjala vesh është (folje). Këtu kemi homonime.
  
1. Ai është një djalë i bukur.
2. Ai është një djalë i shëmtuar.  
1. Amdiu lexon shumë.
2. Amdiu lexon pak, por kupton shumë.  
Këtu fjalët: **i bukur**, **i shëmtuar**, **shumë** dhe **pak**, janë fjalë që tregojnë kuptime të kundërta. Ata janë antonime.

## USHTRIME

Tregoni cilat fjalë janë sinonime, homonime dhe antonime në shembujt e mëposhtëm !

- a) forcë-fuqi, rri-qëndroj, mësues-arsimtar,
- b) bardhë-zi, mirë-keq, çelin-hapen,
- c) dhe-dhe, pjek-pjek, degë-degë,



## DETYRË

Në orët e mësimt të gjuhës së bashku me mësuesin/mësuesen gjeni sinonimet, antonimet dhe homonimet në tekstet që do t'i punoni. Mund ta shfrytëzoni edhe fjalorin.

Zgjohu! Mëngjesi me shigjet' e grisi  
perden e Natës. Yjt' i arratisi.  
dhe Dielli gjahtar me rreze kapi  
çdo majë mali e pallati e lisi.

Mbi lulet po pikojnë vesë retë.  
dhe me zë qiellore, bilbil' i shkretë  
Ah, Verë! Verë! Verë! Trëndafil...  
I lyp t'i skuqë faqezën e zbetë.

Shiko luadhe, lule, bukuri  
lumenj kristali, kronj e brohori  
nga dimri Ferr pranvera Qiell na ndriti,  
gëzo mbi Dhe Parajsën me Huri.

Qesh Trëndafili thotë, "Lulëzonj  
dhe botës' bukurinë po ia shtonj:  
pastaj e hap kuletën e mëndafshtë  
dhe përmbi kopsht thesarin po e shtronj"



### FJALOR

- kristali* - lloj qelqi i përpunuar
- arratisi* - zhduku
- ferr* - këtu ka kuptimin errët
- kuleta* - portofoli i parave
- huri* - këtu e bukura e dheut



### BISEDË RRETH POEZISË

- Çfarë ndjenje ngjall poeti te ne, kur e lexojmë vjershën ?
- Komentoni me fjalët tuaja strofën e dytë!
- Përshkruani strofën e tretë duke bërë analizën të hollësishme të vargjeve!
- Kush ia shton bukurinë botës dhe hap kuletën e mëndafshtë ?



### DETYRË

Poezinë mësoni përmendsh dhe recitoni në klasë.



### SHËNIM

Poezia "Mëngjesi" është marrë nga vepra "Rubair" e poetit persian Omar Khajami (1123-?), ndërsa e përkthyer në gjuhën shqipe nga Fan NOLI.

Në majë të kumbullës përpara oborrit u ndal një bilbil. Qukati me sqepin e tij të vogël një dhëmëze. Shikoi njëherë nga kasollja që të fluturonte pas kokrrave të grurit, por pa maçorrin duke u rrezitur në diell. Shkundi krahët, mori frymë thellë dhe ia nisi një kënge.

- Fiu , fiu , fiu , fi-fi-fiuuu...

Disa hapa më larg në një kafaz , në derë të një shtëpie këngë e tij e dëgjoji Gushëverdhi. Këngë e bukur ! Këngë që i këndon gëzimit, lirisë... E mua në këtë kafazin tim nuk më jepet të këndoje këngë të tilla. Nuk lexoi libra. M'i kanë ndaluar gazetat...Ç' do të thotë të jesh i lirë. Të fluturosh mbi fusha, male... Në liri edhe kënga është më e bukur. E ai shoku im, atje, në majë të kumbullës, këndon i lumtur. Nuk e di ai që dikushi në kafaz këndon i lumtur. Nuk e di ai që dikushi në kafaz këndon këngë vajtimi. Mezi i nxjerr fjalët me lot nëpër këta hekura. Rrallëherë shoh diellin, hënën, yjet...Pyjet dhe fushat e bukura me ujë të kulluar. Sa e shtrenjtë është liria !

- Fiu, fiu , fiu, fi-fi-fiii...

Këtë këngë e dëgjoji bilbili në majë të kumbullës. Këngë plot dhembje, plot lot.

- O burra ! Derisa unë këndoje, dikushi qan !

- Pse qan, o shok ? - e pyeti bilbili nga maja e kumbullës.

- Qaj lirinë, - iu përgjigj Gushëverdhi.

- Qysh qahet liria, o burrë!

- He or vëlla ! Nuk e di si qahet se e ke . Po të mos e kishe do të qaje edhe ti si unë.

Njerëzit kanë bërë shumë luftëra të përgjakshme ta fitojnë lirinë. Po , liria me gjak fitohet.

- Atëherë, kush të ka mbyllur ty në kafaz?

- Njerëzit.

- Nuk besoj ! Ata ia dinë vlerën lirisë.

- Po , po, njerëzit.

Bilbilit nuk i erdhi mirë. Ç'dobi të jesh i lumtur, kur dikush rri në kafaz ? Ia kanë rrëmbyer lirinë. Këngët e tij janë plot lot. Fluturoi i dëshpëruar kah malet...





### FJALOR

**qukati** - trokiti ( këtu zuri një dhëmëze)

**kafazi** - shtëpizë për shpezët, bilbilat...

**i dëshpëruar** - i pakënaqur ( i hidhëruar )



### BISEDË RRETH TEKSTIT

*Bilbili pasi u ndal në majë të kumbullës ia nisi një këngë.*

Kush e dëgjoji atë këngë ?

- Pse Gushëverdhi këndonte këngë vajtimi ?
- Çka i mungonte Gushëverdhit ?
- Çka i tha Gushëverdhi bilbilit që këndonte në majë të kumbullës ?
- Pse qante ai ?
- Çka kuptoni me shprehjenë
- “- He or vëlla ! Nuk e di si qahet se e ke . Po të mos e kishe do të qaje edhe ti si unë.....Po liria me gjak fitohet.....”



### DETYRË

Këtë tregim të bukur lexoni në shtëpi dy- tri herë dhe nxirrni porosinë e tij. Porosinë me pak fjalë shkruani në fletore.



### KOMENTONI MENDIMIN

“Ç’ dobi të jesh i lumtur kur dikush rri në kafaz ? Ja kanë rrëmbyer lirinë.”

# FJALËT ME KUPTIM ZVOGËLUES DHE PËRKËDHELËS

Njohim gjuhën tonë

Prapashtesat më të shpeshta me kuptim përkëdhelie e zvogëlimi janë:  
- **th**

Prapashtesa - **th** u shtohet emrave mashkullorë, si p.sh:

<b>Birth</b>	<b>Djalëth</b>	<b>Ishullth</b>	<b>Kryeth</b>
<b>Gurth</b>	<b>Vëllimth</b>	<b>Fjalorth</b>	<b>Zogth</b>

Prapashtesa - **zë - z** u shtohet emrave femërore, si p.sh

<b>Zogëz</b>	<b>Copëz</b>	<b>Folezë</b>	<b>Hënëz</b>
<b>Nënëz</b>	<b>Fletëz</b>	<b>Portëz</b>	<b>Shtëpizë</b>

**MËSOJMË** Të dyja prapashtesat gjejnë përdorim veçanërisht të gjerë në krijimet poetike.

Përveç këtyre prapashtesave me kuptim përkëdhelie ose zvogëlimi rrallë përdoren edhe disa prapashtesa të tjera si - **ush**; - **ushkë**; - **icë**

Prapashtesa - **ush**

**Lepurush**

**Babush**

**Kaush**

**Vogëlush**

**Plakush**

Prapashtesa - **ushkë**

**Fletushkë**

**Llambushkë**

**Qepushkë**

Prapashtesa - **icë**

**Kokërdhicë**

**Rrugicë**

Me një shtrirje dialektore të ngushtë përdoren edhe prapashtesat - **kë e - içkë**. Po ashtu si dialektore kanë mbetur edhe prapashtesa e përkëdhelie - **ko dhe - çe**,

Prapashtesa - **kë**

**çupkë, mushqerkë, yllkë**

Prapashtesa - **içkë**

**guriçkë, deriçkë, koriçkë**

## DETYRË

Në fjalitë e poshtëshënuara nënvizoni fjalët me kuptim përkëdhelës:

Çupa ime çupëz, sa fortë që të dua.  
Gjyshja e pa kësulkuqen në portëz.  
Ajo në shtëpizë e pa gjyshen.  
Ylli e do shumë lepurushin.  
Nëpër rrugicë kalojnë shumë vogëlush.  
Fatoni babin e thirr babush, kurse shokët e tij plakush.



Në mbrëmjen para Ditës së Shën Gjergjit, Pavlit nuk i vinte shumë keq që do të ndahej nga nëna dhe motra e vet e vogël. E dinte se duhej të ndahej patjetër. Nëna e tij nuk mund të fitonte bukë për tri frymë. E ai tani më ishte i madh. Nga ana tjetër, për djemtë e fshtatit është turp i madh të rrinte në shtëpi dhe t'i ushqejë dikush tjetër. Ai mund të punoj çdo punë. Nesër, në Ditën e Shën Gjergjit, do t'i mbushë të katërmbëdhjetat.

Ishte mbrëmje e qetë pranverore, ndërsa nëna me dy fëmijët e saj rrinte në oborrin e gjelbëruar para shtëpisë. Të gjithë heshtnin. Ndoshta të gjithë rreth asaj se njëri prej tyre nesër duhej të shkonte. Dhe të gjithë ishin të qetësuar, të heshtur si mbrëmja pranverore rreth tyre. Pavli e shikonte qiellin e pastër me yje, në të cilin dukeshin qartë degët e gjelbërta dhe të erëta të qershisë. Në gjethe, si ndonjë njollë e zezë dalloi kafazin e kanarinës. Ajo cicëronte ngadalë dhe dhembshëm. Zëri i saj shpërndahej nëpër tërë oborrin dhe derdhej në mendimet e shqetësuar të djaloshit, Pavlit ju duk se cicërima e kanarinës ishte më e pikëlluar se kurdo më parë. Sa me gëzim e dridhte më parë zërin e vet!

Kurse tani...menjëherë filloj të këndojë aq me mallëngjim.

“Ndoshta edhe ajo parandjen se do të ndahemi!”-mendoi djaloshi.

Për një çast i erdhi keq për të prandaj iu drejtua nënës së vetë me zë lutës:

-Kanarinën...mos e harro,nënë...jepi ujë dhe kokrra drithi..Ajo do të këndojë bukur...

-Mirë bir,-përsëriti nëna e diçka e shtrëngoj në kraharor. Mandej, ngadalë, si pa zë, dënesi në errësirë,duke i fshirë fshehurazi lotët që i pikuan.

Pavli nuk e kishte ndierë deri atëherë barrën e ndarjes nga shtëpia ku u lind, prandaj e habiti zëri pikëllues i nënës së vet. Madje, edhe ndihej disi posaçërisht i gëzuar, sepse edhe ai u rrit dhe u bë ta përcjellin diku si të tjerët, si njerëzit më të rritur të fshatit që i përcillnin çdo pranverë. Dhe ishte i vetëdijshëm se edhe ai do të fitojë, kurse ndihma e tij ishte aq e nevojshme për shtëpinë e varfër.

“Vallë, duhej të qaja pse nesër duhet të ndahem?”

Eh, punë e madhe! Qajnë vetëm fëmijët dhe ata...ata që janë të dobët...Kurse unë... unë nuk jam më fëmijë. Dhe askush nuk do të më thotë më:- Hej, vogëlush,mos i fut hundët atje ku nuk e ke vendin!”

Ashtu mendonte kurbetçiu i vogël, por i vinte keq që pikërisht asaj mbrëmje, gjatë mbrëmjes së fundit edhe kanarina nuk është e gëzuar dhe nuk cicëron me gëzim...

Të nesërmen, ende pa gdhirë,nëna e përcolli deri në fund të fshatit me shikim të gjatë,tepër të përvuajtur dhe memec. Fshati në të cilin duhej të punonte, ishte atje përtej bregut. E dinte edhe shpinë. Në oborrin e pronarit e priti një djalë i lazduar nëntëvjeçar. Porsa i zunë qetë, shkuan në arë. Djaloshi i vogël tha:

-Pali, këtu do të lëvrosh!

Dhe u kthye.

Pali as nuk e hetoi tonin fyes dhe nënçmues në zërin e fëmijës. As dhe atë “Pali”. Lëvroi. Kishte vullnet dhe fuqi. Nën këmbët e zbardhura e ndiente tokën e butë duke u derdhur. Vrullshëm thithte frymën e ngrohtë dhe mpijësë. Merrte frymë edhe ara pjellore. Ajo ishte aroma e këndshme dhe e freskët e fushës. Ajo aromë të përvetëson, të deh, të lëmon...

Dhe sa shumë i pëlqeu ai mëngjesi purpurtë, plot risi! Fusha zgjerohej deri ku ta kap

syri. Nëpër të ka buluar ajo pranverë e ngrohtë jugore. e vullshme dhe e lulëzuar...Nëpër ara duken shumë lavërtarë. Dëgjohet se si dikush fishkëllon, kurse tjetri nën hundë, ngadalë këndon këngë të mirë të vjetër dhe mallëngjyese.. Këtu në fushë shpirtrat e njerëze bëhen të pastër dhe të gjërë sa qielli, madje sikur i harojnë hallet që i bartin me vete. Lëvrojnë dhe këndojnë sikur të mos kenë kurrfarë hallesh, sikur të kenë çdo gjë rrafsh e plot...

Diku sipër arave, në qiellin e pastër dhe pa re, derdhej zëri i zogëzës së shiut, shpezës së lavërtarëve.

“Sa mirë është të jesh lavërtar!”- mendoi Pavli.- Do të lavroj , do të lavroj pa u ndal. Dhe në fund , me të hollat në duar do të kthehem te nëna ime në shtëpi te motra ime e vogël. Ato do të më presin të gëzuara. E Roza sa fort do të gëzohet për fustanin me lara..”

Vija e parë ishte e shtrembër . Ktheheshin qetë sa këndej aq andej. Pengohej plugu në rrënjët pranë megjës. Por më vonë shkonin më mirë. Vijat radhiteshin njëra pas tjetrës, të zeza, të lagta, të thella dhe të thurura, kurse prej tyre dilte avulli i ngrohtë si prej bukës së posathyer.

Kah dreka, kur dielli piqte mirë dhe qëndroj mbi majën e plepit , qetë e lodhur u ndalën në vijë,kurse Pavli u ul në megjë nën hijen e plepit. Nëpër trup i kalonin disa mornica disi të ëmbla,por lodhje nuk ndiente. Sa mendime të këndshme i kalonin derisa rrinte aty në mëngje!

-Pali!- dëgjoi nga prapa zërin që e largoi nga dremitja e ëmbël. - Babai më tha që të hash dhe të shkosh te ara tjetër, tek ajo pas shelgjeve dhe të prashitësh. Qetë unë do t'i shpie në shtëpi...







### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Çka mendonte Pavli atë mbrëmje ?
- Çka mendonin ata kur rrinin në oborrin e shtëpisë?
- Kush cicëroi me mallëngjim dhe pse ?
- Çfarë pune bëri Pavli në fshatin dhe si iu duk puna ?
- Kë do ta gëzonte kur do të kthehej në shtëpi ?

### KUJDES

Shkruani tri fjalë të urta për punën :

---



---



---

Përshkruani me disa fjali Pavlin që ju e njohët në këtë tregim. Sipas këtij shembulli :

Pavli ishte një djalosh që e donte punën  
 Pavli ishte i varfër prandaj shkoi kurbetçi

.....  
 .....  
 .....  
 .....



### DETYRË

Shkruani në fletoret e detyrave të shtëpisë shpjegimin duke e përcaktuar edhe idenë e temën.

Krah shqiponjë po të kisha  
N'vendet tona t'fluturoja  
N'viset tona unë të shkoja,  
Ta shoh Stambollin, Kukushin ta shoh,  
Të shoh djellin a ngroh edhe atje  
Terrshëm e nxe'edhe atje si këtu

Po qe se si këtu edhe atje diell kam  
Po qe se edhe atje terrshëm ndriçon,  
Për rrugë të largëta unë do t'gatitem  
N'viset tjera unë do të tretem,  
Ku diell'ndritshëm shkëlqen,  
Ku yjet qiellin ndriçojnë

Këtu ka terr dhe terri më mbulon,  
Dhe mjegullë e errët tokën kaplon;  
Akujt dhe borë e shkretërim,  
Erëra të egra dhe farfullim;  
Ngulfat mjegulla dhe akullnajat,  
N'prazmë ftohtësia e mendimet terr.

Jo, unë këtu nuk mund t'qëndroj,  
Jo, akujt sytë mu m'i vërbojnë!  
M'jepni krahët, krahë të kem ,  
N'viset tona unë t'fluturoj,  
Në vendet tona unë të shkoj,  
Ta shoh Ohrin,Strugën ta shoh.

Atje agimi shpirtin ta ngroh,  
Dhe dielli shkëlqyshëm perëndon;  
Atje dhuntitë t'i falë natyra  
Me tërë begatinë atje shpërndahen;  
Liqeni i kulluar atje zbardhon,  
Ose me erën kaltrohet e errësohet  
Shiko fushën apo pyjet.  
Bukuri e lartë është hyjnore.

Atje kavailit me zemër t'i bie,  
Dielli t'perëndojë, e të vdes:

Poezinë “Përgjërimi për jugun” e ka shkruar vjershëtari maqedonas Konstandin Milladinov (1830 - 1862).



#### FJALOR

*Kukush*- qytet  
*terrshëm*- thatë  
*tretem*- shkrihem  
*kaplon*- mbulon  
*farfullim*- erë e fortë, e ftohtë, acar.



#### BISEDË RRETH POEZISË

- Pse poeti kërkon krah shqiptonjash ?
- Ku dëshiron të shkojë ?
- Si e mendonte poeti Ohrin dhe Strugën ?
- Ç’do të thotë poeti me vargjet :  
„Atje kavallit me zemër t’i bie  
Dielli t’perëndoj e të vdes”



#### DETYRË

Pyetjet e bisedës shkruani në fletore!

# LIGJERATA E DREJTË DHE E ZHDREJTË

Njohim gjuhën tonë

*I lexojmë me vëmendje këto dy mendime:*

a) Gjatë orës letrare një nxënës i tha poetit:  
“Poezitë tua më pëlqejnë shumë, prandaj i  
lexoj me një frymë”

b) Gjatë orës letrare një nxënës i tha poetit se  
poezitë e tij i pëlqejnë shumë dhe i lexon  
me një frymë.



**Pyesim:** Ku e vëreni ndryshimin ndërmjet fjalisë së parë dhe fjalisë së dytë dhe a dallohen shenjat e pikësimit?

Në shembullin e parë fjalët e nxënësit i kemi përdorur besnikërisht, pra nuk kemi bërë kurrfarë ndryshimi, prandaj themi se shembulli nën (a) është shkruar në **ligjeratën e drejtë**. Shembulli i dytë (b) është shkruar duke bërë ndryshime, respektivisht këtu fjalët e nxënësit janë ndryshuar, por jo thelbi, atëherë themi se këtu kemi **ligjeratën e zhdrejtë**.



## USHTRIME

Dalloni cila ligjeratë nga shembujt e shkruar më poshtë është e drejtë dhe cila e zhdrejtë!

1. “Prej shëtitje kthehesh”, më pyeti nëna. \_\_\_\_\_
2. Të gjithë duhet ta lexoni veprën e Naimit-na tha mësuesi. \_\_\_\_\_
3. Nëna më pyeti se a kthehesha prej shëtitjes. \_\_\_\_\_
4. Mësuesi na thoshte se të gjithë duhet ta lexojmë veprën e Naimit. \_\_\_\_\_



## DETYRË

*Ktheni në ligjeratën e kundërt këto shembuj:*

“Artani është shokë i mirë” - tha Genci.  
\_\_\_\_\_

I panjohuri e pyeti djaloshin se në cilën shkollë mëson  
\_\_\_\_\_

## DETYRË SHTËPIE

Përshkruani 5-6 rreshta nga tregimi me titull “Libri mbi princin e lumtur” dhe të njëjtit përdorni në ligjeratën e drejtë dhe në ligjeratën e zhdrejtë.

# MACJA E PREFERUAR E PADRONËS SË SHTËPISË

Të lexojmë

Xhonatan Suift

Tregim fantastik

Kisha një uri aq të madhe, sa nuk e mbaja dot veten dhe ia shfaqta dëshirën time në një mënyrë të pahijshme, duke vënë gishtërinjtë në gojë, për të treguar se doja të haja.

Ishte gati mesditë dhe një shtëpiak solli ushqimin që ishte një pjatë vetëm me mish, por shumë e madhe. Familjarët ishin kryefamiljari, gruaja e tij, tre fëmijët dhe një plakë e vjetër.

Sapo ishin ulur, kur kryetari i familjes u ul në një distancë nga tavolina që ishte e lartë nga toka një metër.

Ndieja marrje mendesh rrija sa më larg që të mundesha cepit të tavolinës, sepse trembesha të mos bija poshtë.

Gruaja mori një cope mishi dhe e preu atë me thikë. Unë e shihja me zili, mora thikën me pirunin dhe fillova duke ngërë me një qejfë të madh. Zonja e shtëpisë çoi kamarieren për të marë një gotë vere që mbante brenda afërsisht 9 litra dhe e bashkoi atë me një pije tjetër. Unë e ngrita me një vështirsi të madhe duke përdorur të dyja duart dhe e piva me një respekt të madh për shëndetin e zonjës së shtëpisë. Pija kishte një shije pak të thatë, por nuk ishte e pakëndshme.

Pastaj padroni ma bëri me një shenjë për tu afruar te pjata e tij, por ndërsa shkoja drejt tij u pengova në një copë buke u rrëzova, por pa u vrrarë.

U çova menjëherë dhe pashë që ata njerëz të mirë ishin në ankth të madh. Pas pak hoqa kapelën e ngrita sipër për të treguar se rrëzimi nuk më kishte dëmtuar.

Në mes të drekës maca e preferuar e padronës së shtëpisë i kërceu në prehër.

Unë dëgjova një zhurmë shumë të madhe prapa meje dhe, kur kthej kokën shoh se ishte pikërisht macja ajo që bënte zhurmë. Pamja e egër e kësaj kafshe më shpërqëndroi.

Pas pak, nga frika u gjenda në krahun e kundërt të tavolinës, përballë saj. Padronja e mbante të shtrënguar fort sepse kishte frikë se mos macja i shkëputej nga duart dhe më fuste nën kthetrat e saj. Por për fat nuk kishte asnjë rrezik sepse macja nuk u morr fare me mua, edhe pse padronja e mbante vetëm tre metra larg meje.

Edhe pse mua më kishin thënë dhe unë e kisha kuptuar edhe hera të tjera gjatë udhëtimeve të mija që në qoftë se ti ikën me vrap dhe tregon frikë është mënyra më e thjeshtë që një kafshë e egër të të sulmojë. Eca pa pushim 5-6 hapa pikërisht nën hundën e macës dhe përfundova gjysmë metre afër saj.

Ndërkoh macja u spostua prapa sikur të kishte ajo frikë nga unë. Nuk mbaj mend si përfundoi kjo drekë me gjigantët.

Fragment nga romani "Udhëtimet e Guliverit"



## FJALOR

*u spostua* - u ndal

*padronja* - zonja e shtëpisë



## BISEDË RRETH TEKSTIT

- Për çka bëhet fjalë në këtë pjesë?
- Në ç' vend ndodhet personazhi i tekstit tonë?
- Çka solli gruaja e kryefamiljarit në tavolinë?
- Si e kaloi këtë drekë personazhi i tekstit tonë?



## SHËNIM

Në fragment, si dhe në tërë romanin ka shumë fjalë që sendet, fenomenet i zmadhon deri në tepri.



# RADIOJA-TELEVIZIONI KOMPJUTERI-INTERNETI

Kultura e medias

*Në klasë zhvillojmë një bisedë në formë debati për punën e mediave.  
Pyetni nxënësit:*

- 1.Si e kaloni kohën e lirë?
- 2.Çka më së shumti shihni në televizor?
- 3.Si e shfrytëzoni kompjuterin dhe internetin?
- 4.Mendimi juaj për mjetet e lartpërmendura?
- 5.Veçoni një emision të televizionit për të debatuar?
- 6.Debati duhet zhvilluar në formë diskutimi?

Nxënësit i ndajmë në dy grupe:

**Grupi a)** Për të dhënë vlerësimin pozitiv rreth emisionit që është tema e debatit;

**Grupi b)** Për të dhënë vlerësim negativ, pra për të treguar anët negative të emisionit.




## KUJDES

Edhe vlerat pozitive edhe ato negative, duhet mirë të argumentohen nga ana e nxënësve.

Në fund të orës, arsimtari vendos se cili nxënës u veçua në këtë orë debative. A doli në shesh (u kuptua) tema dhe porosia e emisionit të shikuar.

Pas një diskutimi konstruktiv të zhvilluar brenda një grupi prej 2-3 nxënësish më të dalluar, nxjerrim pikat kryesore të diskutimit si dhe përshtypjet nga kjo orë.



# PIKËSIMI NË LIGJËRATËN E DREJTË DHE TË ZHDREJTË

## Lexoni shembujt me kujdes dhe analizoni?

1. "Kafshatë që skapërdihet është or vëlla mjerimi" ka thënë Migjeni
2. - Kafshatë që skapërdihet është or vëlla mjerimi - ka thënë Migjeni
3. Migjeni ka thënë: "Kafshatë që s'kapërdihet është or vëlla mjerimi".

Nëse i keni kuptuar mirë shembujt e shkruara më lart lehtë mund të kuptoni se cilat janë shenjat e pikësimit që përdoren në ligjëratën e drejtë.

### DETYRË

Në fjalitë e dhëna veni shenjat e pikësimit sipas rregullave të drejtëshkrimit në ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë.

1. Punë, punë natë e ditë ka thënë Naimi
2. Populli thotë shoku i mirë njihet në rrezik
3. I panjohuri e pyeti vogëlushin se në cilën lagje banon



### TË MBAJMË MEND

Në ligjëratën e drejtë pjesa përmendëse shkruhet me thonjëza, ose fillon me vizë dhe mbaron me vizë. Shembulli 1,2 dhe 3

Në ligjëratën e zhdrejtë përdoret pikësimit normal, sipas llojit të fjalisë, pra pika, pikëpyetësi, pikëçuditësi etj.



### DETYRË

Shkruani dy fjali ose pjesë nga libri në ligjëratën e drejtë dhe të njëjtat ktheni në ligjëratën e zhdrejtë?

---



---




---



---







## MODULI - 4

57. Si e gjete folenë moj dallëndyshe

58. *Përdorimi i shkronjës së madhe*

59. Gabojnë prindërit

60. Nënë e madhe e kësaj bote

61. Festa e shkollës

62. *Shenjat e pikësimit*

63. Ideja mbi artin filmik

64. Prendvera

65. Për ditën e festës

66. Njeriu mëson nga e bukura

67. *Përdorimi i pikës*

68. *Pikëpyetja dhe pikëçuditja*

69. Pal Golemi e Nik Peta

70. *Përdorimi i presjes*

71. Një letër dhe diçka tjetër

72. Bota do të jetë një

73. Pulëbardha

74. *Përdorimi i drejtë i shkurtesave*

75. Mesazhi në celularë



Nga mesi i prillit familja e Erës dhe e Drinit hyri në një pallat të ri.

Sa u gëzuan vogëlushët për këtë shtëpi të bukur! Por gëzimi i tyre nuk kishte kufi kur dolën në ballkon. Ç'të shikonin? Në qoshe ishte një fole dallëndyshesh!

- O, o! -ia bëri Era, pa i hequr sytë nga foleja. Kjo është një mrekulli e vërtetë!

- Gjithmonë i kam pasur zili shokët që kanë fole dallëndyshesh në ballkonet e tyre, - tha Drini.

- Po sikur të vij edhe një dallëndyshe dhe të ndërtoj fole edhe në qoshin tjetër të ballkonit? - tha Era me vështrim ëndërrues.

Të dy, vëlla e motër, ndoqën me sy dallëndyshen që hyri në fole dhe nuk lëvizte.

Vetëm herë-herë nxirrte kokën jashtë dhe lëshonte ca cicërrima të zgjatura.

- Pse nuk fluturon më dallëndyshja? - pyeti Era. Drini ngriti supet. Nëna, që po vendoste një vazò lulesh në parmak, iu përgjigj:

- Është duke ngrohur vezët.

Fjalët e nënës ishin si një lajmërim për festë. Ata filluan një bisedë të re për zoçkat që do të çelnin. Sa pyetje! Sa pyetje kishte në atë bisedë vogëlushësh!

Kaluan ditët. Zoçkat dolën dhe u ritën. Foleja u mbush plot zogj e këngë.

Ballkoni ishte vendi më i dashur për vogëlushët. Koha shkonte dhe një ditë prej ditësh erdhi vjeshta.

Sa u hidhëruan Era dhe Drini një mëngjes kur vunë re se dallëndyshet nuk ishin më në fole.

- Mos u mbërzitni, - u tha nëna, - në pranverë ato do të kthehen përsëri.

- Edhe sikur të vijnë, kushedi se ku do ta ndërtojnë folenë, - tha Drini me zë të përvojshëm.

- Jo, - e kundërshtoi nëna, - dallëndyshet nuk e harojnë folenë, ato do të vijnë përsëri në ballkonin tonë.

- Si ka mundësi? - pyeti Era e çuditur. Ato do të shkojnë larg vendit tonë...

- E, megjithatë kthehen në të njëjtin qytet, në të njëjtin pallat, në të njëjtën fole, - i siguroi nëna.

Ato fjalë u dukeshin të pa besueshme vogëlushëve, por, përderisa i thoshte nëna, ishin të vërteta.

Përsëri ditët vazhduan rrjedhën e tyre. Përsëri po afrohej pranvera. Era dhe Drini çdo ditë dilnin në ballkon dhe pritnin dallëndyshet. Sa dëshpëroheshin kur nuk shikonin se në ndonjë ballkon të fqinjëve ishin kthyer, ndërsa në ballkonin e tyre jo!

Por dëshpërimi dhe pritja e fëmijëve nuk zgjati shumë. Një mesditë të bukur rreth e rrotull ballkonit u vërtitën dy dallëndyshe. Njëra, ajo më e madhja, kishte në këmbë një kordele të bardhë. Ish pikërisht kordelja që Era i kishte lidhur një ditë, kur dallëndyshja kishte hyrë në dhomë dhe vogëlushët e kishin kapur. Tani nuk kishte asnjë dyshim: ishte po ajo dallëndyshe që kishte qenë vitin e kaluar!

Dallëndyshja, duke cicëruar, sikur donte të përshëndeste miqtë e saj të vegjël, u vërtit rreth folesë, u ndal në hyrjen e saj, zgjati kokën dhe, kur u bind se ishte e zbrazët, u fut brenda. Pas saj hyri dhe dallëndyshja tjetër.

- Erdhën, erdhën! - britën fëmijët në kulmin e gëzimit dhe u sulën t'i jepnin lajmin e gëzuar edhe nënës. Pastaj dolën përsëri në ballkon.



- Sa çudi më vjen, - tha Era, si u ktheve përsëri në ballkonin tonë? Si e gjete rrugën, moj dallëndyshe?

Dallëndyshja cicëronte e cicëronte pa pushim. Dukej se edhe atë e kishte marrë malli. Me ato cicërima të bukura u tregoi dy vogëlushëve një përallë të shkurtër dhe të vërtetë:

...- Atë mëngjes vjeshte, kur u largova prej këtej, më piku në zemër që nuk u përshëndeta ,me ju, të dashur vogëlush. Cicërova disa herë te dera e ballkonit, por zëri im nuk ju zgjoi dot. Shoqet po largoheshin. Dielli, që sapo kishte lindur, më tha: “ Tani dallëndyshe, hap sytë mirë dhe ki mendjen të më ndjekësh me kujdes. Po u hutove, më humbe nga sytë. Dhe kjo do të thotë të humbasësh drejtimin nga do të shkosh”. Kjo ishte vërtetë e tmershme, sepse nuk do të arrija dot në vendet e nxehta. Bëra ashtu si më këshilloi dielli. Me dy të rrahura krahësh, i arrita shoqet. Udhëtua e udhëtua. . . Kaptuam fusha e male, lumenj e dete. Më në fund arritëm në vendet e nxehta, ku kaluam gjithë ata muaj.Një ditë prej ditësh, dielli na lajmëroi se kishte ardhur koha të merrnim udhëtimin e ri. U përgatitëm dhe u nisëm për rrugë të gjatë... dhe...siç e shihni, u kthyem përsëri këtu, në vendin tuaj të bukur.

- Po si e mbajte mend shtëpinë? Nuk u ngatërrova në gjithë ato qytete, në gjithë ato pallate që ke hasur rrugës?
- Jo, nuk u ngatërrova aspak, - u përgjigj dallëndyshja, - sepse gjithmonë ndjek drejtimin e diellit. Drejtimi i tij është i pagabueshëm.
- Çudi, çudi! - tundte kokën Drini.
- Po zogjtë që çele vjet, ku i ke: - e pyeti Era.
- Zogjtë u shpërndanë nëpër pallatet e reja që janë ndërtuar pasi kemi ikur ne. Vetëm njëra, ajo që e patë do të vijë me mua.
- Do të jetoni së bashku? - Drini nuk e fshehu dot gëzimin kur mendoi se do të kishin dy dallëndyshe.
- Jo, dallëndyshja e re do të ndërtojë çerdhe të re në qoshen tjetër të ballkonit. Vogëlushët rrahën shuplakat të gëzuar!
- A të thashë vjet, e mban mend apo jo? - i tha Era Drinit. - a të thashë: "Ah, sikur të kishim një fole dallëndyshesh në qoshen tjetër të ballkonit!"
- Ja, erdhi dallëndyshja bijë! Shiko, shiko e vendosi baltën e parë në qoshe! - thirrën vogëlushët njëzëri.
- Mos thërritni kaq shumë, se do t'i trembni! - u tha nëna. Lerini të qeta sa të mbarojnë folen e re!
- Eja të zbresim në oborr dhe t'i shikojmë që andej! - tha Era duke e tërhequr të vëllanë prej dore.

Komentoni me fjalët tuaja shtegtimin e zogjve, ku shkojnë gjatë vjeshtës dhe dimrit.  
 Çka dini për zogjtë shtegtarë?  
 Lexoni pjesën prej...Atë mëngjes vjeshte...deri te: Dhe...siç e shihni...  
 ...të bukur dhe çka përshkruan aty shkrimtari?



### FJALOR

*supet*- shpatulla  
*zoçka*- zogj të vegjël  
*përvajshëm*- me mallëngjim  
*vërtit*- u rrotullua  
*kaptuam*- kaluam



### DETYRË

Bëni një hartim të shkurtër me temë:  
 "Mirëserdhe dallëndyshe"

Kujdesi ndaj shpezëve gjithnjë duhet të jetë në nivel të lartë.



### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Ku u vendosën familja e Drinit dhe e Erës?
- Çka panë ata në njëren qoshe të ballkonit?
- Si e pranuan ata ndërtimin e folesë, pse u gëzuan?
- Pse dallëndyshja nuk lëvizte nga foleja?
- Çka ndodhi në një ditë vjeshte?
- Kur u kthye përsëri dallëndyshja?

# PËRDORIMI I SHKRONJËS SË MADHE

Njohim gjuhën tonë

*Lexoni me vëmendje tekstin: Gjyshi i Arianës, dhe shihni ku është përdorur shkronja e madhe.*

Të gjithë thonë se nuk njohin as një plak më të moçëm se gjyshi i Arianës. Sa herë që vijnë në shtëpinë e saj, krenohen me shëndetin e tij. Njerëzit nuk mund të ndahen nga gjyshi i Arianës pa e pyetur se sa vjet i ka mbushur se sa her ka qenë në mjek. Gjyshi plak qesh. Atëherë atë botë i duhet vetëm një dhëmb i gjatë që i varet nga një anë e gojës....Plaku qesh dhe rrudh ballin e gjërë.  
-Nuk më kujtohet.....Nuk e di se a kam qenë ndonjëherë te mjeku.



Në këtë tekst me shkronjë të madhe janë shkruar fjalët:

Ariana - **emër i përveçëm.**

Sa herë..., **fjala e parë pas pikës,**

Njerëzit..., **fillon rreshti i ri,**

Nuk më kujtohet...Nuk e di ..., në ligjëratën e drejtë dhe pas shumëpikëshit.



## TË MBAJTMË MEND

Me shkronjë të madhe shkruhen emrat e përveçëm, p.sh. Gjergj Kastrioti, Ismail Qemali, Çajupi, Gavril Dara i Riu, Laroja, Murkojës, Balashi, Kuçali etj.  
-Me shkronjë të madhe shkruhen emërtimet gjeografike: Adriatiku, Ballkani, Drini i Zi, Sharri etj.  
-Emrat e gazetave, revistave dhe të librave shkruhen me shkronjë të madhe dhe vendosen në thonjëza.  
“Fakti”, “Koha”, “Lajmi”, “Lumi i vdekur”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”  
Shkurtimet që rëndom shkruhen me shkronja të mëdha, kur shkruhen nuk kanë pikë ndërmjet p.sh.: RM, SHBA, OKB, NATO, UNICEF etj.  
-Por emrat e përgjithshëm shkruhen me shkronjë të vogël p.sh rruga,.....,sheshi.....,hotel.....,kinema....., Njerëz...

## USHTRIME

Lexoni tekstin Gjyshi i Arianës deri në fund, gjeni pikësimin duke u munduar të kuptoni se pse është përdorur shenja gjegjëse.



## DETYRË

*Shkruani si duhet fjalët në këto fjali dhe rregullo pikësimin*

- Urime festën e nënës
- Dje ishte dita ndërkombëtare e punës
- Petrit pse nuk erdhe në shëtitje
- Vjollca është në kl. e dytë, kurse diana në kl. V.

-Pse më thire,Mario?-e pyeti Lina dymbëdhjetë vjeçare të vëllanë e saj dhjetëvjeçar,Miron

-Qe,jam duke bërë listën e gabimeve të prindërve.Ulu të më ndihmosh!

-Gabimet e prindërve?!Ç'të duhet kjo ?

-Xha Alberti më tha në besim që të shkruaj një artikull për gazetën e tij. Si duken prindërit në sytë e fëmijëve të tyre dhjetëvjeçarë?

-Po a do ta botojnë me emrin tënd?

-Kurrsesi! Po të mirret vesh kjo gjë, do të më rrahin.Afrohu, dëgjo se ç'kam shkruar.Shto edhe ti diçka, nëse të kujtohet!

Prindërit japin premtime që nuk i plotësojnë kurrë.Dhe kur i pyet pse nuk ta kanë dhënë këtë ose atë gjë, ose pse nuk kanë bërë këtë ose atë, ata thonë:ai nuk ishte premtim i vërtetë, por vetëm një -ndoshta.

E dyta - prindërit nuk veprojnë ashtu sikurse nuk u thonë fëmijëve ta flasin të vërtetën ta mbajnë disiplinën e pastërtinë etj.

-Ke të drejtë - e ndërpreu Lina.- Prindërit nuk u lejojnë fëmijëve që të vishen ashtu si dëshirojnë. Prindërit, nëse shkojnë në ndonjë kremtim, vishen ashti siç u'a do qejfi, edhe po të mos jetë kjo e pëlqyeshme,ose edhe po t'u vijë ftohtë me ato roba, ose edhe po t'u vijë të ngushta.

-Shkruaje edhe këtë,-i tha Lina,-prindërit asnjëherë nuk duan të kuptojnë që fëmijët mund të dëshirojnë ndonjë gjësend.Për shembull:ngjyrën e fustanit, qepjen ose madhësinë.Madje, madje edhe kur blej diçka me të hollat nga librezja e kursimit,nëna dhe babi ndërhyjnë në zgjedhjen dhe nëse revoltohem, më gjen e zeza.

-Mirë,mirë!Ti vetëm për rrobat,sikur ato të jenë më kryesore!Dëgjo edhe çfarë kam shkruar:"Prindërit gabojnë,edhe pse asnjëherë nuk pranojnë gabimet e tyre.Nëse dikush ua tërheq vërejtjen se kanë gabuar, gjithnjë përgjigjen dhe arsyetimin e kanë në maje të gjuhës.Prindërit shpesh na dënojnë për gjëra të parëndësishme na i marrin lodrat,na lënë pa drekë ose pa darkë,nuk na lejojnë në kinema ose që të luajmë me shokët.Herë-herë nuk na lëdojnë për gabime më të rënda.Fëmija kurrë nuk din se përse e pret rrafja e përse jo.

-Edhe kjo është me rëndësi,Mario-u kujtua Lina-nëna dhe babai gjithmonë kritikojnë dikënd.E nëse veprojnë kështu fëmijët-prindërit,do të thonë se fëmijët janë të këqinj dhe se nuk i respektojnë të rriturit.

-Ashtu është!-buzëqeshi Mario.-Kam edhe dy shënime-"prindërit gjithnjë bëjnë fjalë për të holla,për llogaritë që duhet të paguajnë.Flasin,pra,gjithnjë e pandërprerë për të holla.Përkundër kësaj fëmijëve u thonë se të hollat nuk janë aqë të rëndësishme.Dhe meqenëse prindërit gjithnjë folin për këtë gjë,duket sikur të hollat janë gjë kryesore në botë.Dhe në fund -nënës dhe babait u interesojnë fshehtësitë e fëmijëve.Gjithnjë dyshojnë në ta dhe paramendojnë njëfarë dëmi.Më shpesh këto fshehtësi të vogla fëmijore janë ndonjë dhuratë për ndonjë shok,për ditëlindjen e nënës ose të babait.Qe,kaq kisha.Po në atë çast arriti dhe xha Alberti!

-Mirë dita,fëmijë të mirë!-përsëndeti xha Alberti.Duket se ke punuar mjaft,Mario.Më jep të shoh se ç'ke shkruar!

Pas pesë minutave ai buzëqeshi dhe tha:

-S'është keq,Mario! Kur të rritesh do të bëhesh kritik i mirë.Por këtu ke harruar atë që është më me rëndësi.

Ç'është ajo?-pyetën njëzëri Mario dhe Lina.

-Kjo është: prindërit gjithnjë kallëzojnë se ç'kanë bërë kur i kanë patur dhjetë vjet. Deri sa i dëgjojmë, nuk na duket aspak e vërtetë ajo që kallëzojnë. Ndërkaq, prindërit dhe të gjithë të rriturit harrojnë se ç'do të thotë ajo: të kesh dhjetë! Dhe aq më pak të kujtohet se sa të mirë kanë qenë atëherë.



### FJALOR

*artikull* - material për në gazetë

*gjësend* - diçka

*paramendojnë* - parashikojmë

*kallëzojnë* - tregojnë



### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Për çka biseduan Mario dhe Lina ?
- Cili ishte titulli i artikullit që do ta shkruante për në gazetë?
- A i plotësojnë prindërit gjithnjë premtimet?
- Çka mendonin prindërit rreth të hollave dhe si vepronin?
- 

### Pyetjet për komentin debativ

Ç'do të thotë autori me shprehjen:

“Si duken prindërit në sy të fëmijëve të tyre dhjetëvjeçarë”



### DETYRË

“Si duken prindërit e mi” - tani pasi lexova këtë tregim (Shkruani në fletore, fshehtëzi nga prindërit - Atyre do t'u tregoni pasi të lexohet në klasë)

### Fjalë të urta për mirësjelljen

1. Mejto pa fol, mos thuaj ç'do, mejto pa bëje, mos u nxito.
2. Veç e vërteta të jep kalli, nuk korrë grurë, po mbolle hi.
3. Shiko faqebardhë të rroshe e përpiku të bësh mirë.
4. Fjala lipset me vend, mos fol po s'qe me mend.

Vitore Leka

Kudo që jam, kudo që shkoj,  
më ndjek pas fjala jote.  
Mirësi na rrezaton,  
o nënë e madhe e kësaj bote.

Ku ishte dhimbja më e rëndë  
ku lëngata ish më e gjat.  
Ti atje hape zemrën,  
si një qiell të pamat.

E dhimshur ish kjo dora jote,  
ju zgjat njeriut mes mjerimit.  
Shembell tyre prej shenjtoresh,  
je bërë sot për të gjith njerzimin.

Ti je emri i mirësis,  
ti je emri i vet shpresës.  
Nënë e madhe e dashurisë  
shenjtëresha Nënë Tereza!



## FJALOR

*rrezaton* - shkëlqen ( me mirësi)  
*lëngata* - mundimi



## BISEDË RRETH VJERSHËS

- Cila është Nëna e madhe e kësaj bote ?
- Ku e hapte zemrën kjo Nënë e madhe, nënë shqiptare ?
- Pse sot Nëna shqiptare shenjtoresh është bërë simbol i gjithë njerëzimit ?
- Strofën e fundit analizoni varg për vargu në fletore?



Ti je emri i mirësisë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Ti je emri i vetë shpresës:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Nënë e madhe e dashurisë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Shenjtorja Nënë Tereza:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



## DETYRË

Vjershën mësoni përmendsh dhe recitoni në klasë.

E bukur është festa  
Që ne sot festojmë,  
Dhe në çdo vjetorë  
Ne do ta festojmë.

Gëzuar shkolla ime  
Festën me shumë gëzime  
Urime ju mësues  
Të kësaj shkollës sime.

E gëzofsh këtë ditë  
Ti moj shkolla ime,  
Të dëshiroj nga zemra  
Për shumë vjet urime.



## BISEDË RRETH POEZISË

- Për cilën festë flitet në poezi?
- Cila është festa e mësuesit?
- Cila është festa e shkollës suaj ?



## FJALOR

*vjetore* - çdo vjetë



## DETYRË

Mësoni vjershën përmendsh dhe  
bëni gara në klasë se kush do ta recitojë më bukur.



## Aktivitet

Hartim me shkrim me temë:  
“ Dita e Mësuesit”

# SHENJAT E PIKËSIMIT

Njohim gjuhën tonë

Lexoni këtë pjesë dhe vëreni cilat shenja të pikësimit janë përdorur aty:

## *Khaxha sa është ora?*

- Xhaxha-e thërret vogëlushi rrobaqepësinë dhe pyet:
- Sa është ora ?
- Ora?-thotë rrobaqepësi dhe i përgjigjet pa e shikuar fare:-Dymbëdhjetë. Vogëlushi ia ktheu menjëherë:
- Nuk është dymbëdhjetë,por dymbëdhjetë pa dhjetë minuta. Rrobaqepësi e shikon me habi.
- Ti paske orë!-i thotë
- Po,kam - i përgjigjet vogëlushi.

## *Mësojmë*

Në këtë pjesë janë përdorur këto shenja të pikësimit: **pika, presja, viza,dy pikat, pikëpyetja dhe pikëçuditja.**  
Përdorimin e çdonjërës do të shohim në tekst.

## TË MBAJMË MEND



Shenjat e pikësimit janë: pika (.), pikëpyetja (?), pikëçuditja (!), presja (,), pikëpresja (;), dy pikat (:), shumëpikëshi (...), thonjëzat(„”), kllapat ( ) dhe viza (-).

Shenjat e pikësimit përdoren për të shënuar pauzat,ngritjen dhe uljen e zërit.



## USHTRIME

Sot mungon Fatosi.  
Kush mungon sot?  
Fatosi nuk erdhi në shkollë,sepse ishte i sëmurë.  
-Sa është ora?-pyeti vogëlushja.  
E gëzofsh këmishën e re!  
Dje lexova veprën “Picimuli” .



## DETYRË

Veni pikësimin e duhur në fjalitë e mëposhtme.  
Gëzuar festën e 7 MARSIT  
Kush e vizitoi shokun e sëmurë  
Hana u gëzua shumë  
Amdiu dje shkoi në kinema sepse luante një film i mirë  
Ti paske orë i tha rrobaqepësi

# IDEJA MBI ARTIN FILMIK

Para se të vijë ora e mësimit,ku nxënësit duhet të njihen me artin e filmit, arsimtari lajmëron nxënësit të ndjekin një film edukativ,shkencor ose fantastik dhe të mbajnë një shënim të vogël për atë që shohin.

Për çka duhet të kenë kujdes gjatë ndjekjes:

- emri i filmit
- tema e filmit
- personazhet pozitive
- personazhet negative
- mesazhi i atij filmi

Kurse në orën e mësimit që do të vijojë nxënësit do të njihen me artin filmik dhe komponentët që e përbëjnë atë. Pasi të diskutohet filmi të shikuar fillon shpjegimi si vijon.

-Filmi është art që shprehet me anë të fotografisë së gjallë të shoqëruar prej fjalës.

-Filmi është fryt i punës kolektive ku marrin pjesë një grup i madh njerëzish,aktorësh,punëtorë teknik,ekipi realizues i filmit, etj.

-Ekipin kryesor të filmit e përbëjnë:


- regjisori
- skenaristi
- aktorët (artistët)
- operator filmi etj.
- filmi i gjatë zgjat gati 2 orë

dhe në të ka 2500 m/ shirit

-Llojet e filmit janë:

- filmi aristik
- filmi dokumentar,
- filmi vizatimor,
- film kukullash etj.

Sipas tematikës filmi aristik mund të jetë: historik, kriminalistik, komik ,dramatik, shkencor, luftarak, horror etj. Për këtë temë nxënësit kanë njohuri, prandaj mund të zhvillohet një diskutim në klasë.



Jeni lodhë, dallëndysha t'shkreta  
Je molisë, i ziu bylbyl;  
Ah! Pushoni n'streh' ku u gjeta,  
Pusho n'kopshtë te njaj zymbyl.

Mbi krahë tuej prej dhenash tjera  
Ju, prendverën na prutë këtej;  
Shplodhn'ju,pra,dallëndysha t'mjera,  
Rri,bylbyl,n'lulzim që kthej.

Se qe 'j prrue prej malit ulet  
E t'tanë fushës ushqim i nep;  
E nën borë po shpërthejn'lulet  
Porsi fëmij' që zbulohen n'djep

Fllad i let me vapë dashnijet  
Puthi pemën gemb për gemb  
U zgjue pema, e qe prej shijet  
Buloi mbarë nëpër nëpër kopshtë tem.

Ndej'bri votrës nieri myket:  
Vrapo, bulk, ku puna t'thëret:  
Tuj vrue fushën kau bërluket,  
Lyp m'u vue për lavër t'vet.



## FJALOR

*molisë* - i zverdhur

*fllad* - frynë erë e freskët



## BISEDË RRETH POEZISË

- Për cilën stinë bën fjalë poeti ?
- Kujt i drejtohet poeti ?
- Çka sollën ata prej vendeve të tjera ?
- Çka përshkruan poeti në strofën e katërt ?
- Komentoni këtë strofë:

“ Ndej'bri votrës nieri myket:  
Vrapo, bulk, ku puna t'thëret:  
tuj vrue fushën kau bërluket,  
Lyp m'u vue për lavër t'vet”



## DETYRË

Shkruani ese me temë  
“ Pranvera në vendin tim ”,



Ditë dhuratash  
për mësueset e qeshura  
për nënat tona  
Në dorë te Gonit  
qeshin lulet  
qeshin si Bona.

Ditë dëshirash  
laramane  
n'klasën tonë ndodh  
edhe ndonjë mahi;  
ditë dhuratash  
ditë dëshirash,  
dëshira - si dashuri.


N'dorë t'Gonit lulet  
plot aromë e ngjyra  
- Këto lule Bonë  
dhuratë për ty.  
Dora lehtë dridhet  
skuqet fytyra,  
sakaq pyetjet  
slakërojnë sy më sy.



- Goni, ende nuk jam nënë  
lule për t'me dhënë...  
Ende festa s'është për mua.  
- Krejt njësoj Bone  
kur unë vetë dua...

Pse mos ta luajmë sot  
Bone një lojë të bukur  
unë të bëhem zog  
ti të bëhesh flutur.  
Kush pret deri n'mot  
të të dhurojë një tufë lalqe  
që t'ledhin në faqe?...

- Të dua si shok!  
- Të dua si motër.



### FJALOR



*laramane* - lara-lara

*aromë* - erë e këndshme

*sakaq* - menjëherë



### BISEDË RRETH POEZISË

- Cila është festa e nënave?
- Çka mbante në dorë Goni?
- Pse Gonit i dridhet dora ?
- Si i përgjigjet Bora Gonit?
- Çka do ti dhuroni nënës, mësueses?



### DETYRË

Mësoni vjershën përmendsh dhe recitoni para shokëve!

### Aktivitet

Tema për hartim me shkrim: “Dhurata për nënën”

Erdhi një nxënës me flokë kaçurel, me fytyrë si të hequr, me sy të zgjuar në klasën tonë. Për çudi e pranuan edhe pse kishte kaluar gjysëmvetori i parë, pjesërisht edhe i dytë dhe ishim në pranverë. Më vonë u pa që ai flokë kaçureli kishte qenë një nxënës i mirë. Kaloi bile shembullorë. Mësuesi i tha të ulej në bankën e pestë afër dritares. Ai zuri vënd. Por gjatë asaj ore, ai vazhdimisht shikonte degën përtej dritares. Në degë ishte çerdhja e kumrisë. Në çerdhe ishin dy zogjtë e saj. Ata ishin të verdhë, të njomët, të artë!

E puhiza luante me degën, luante me çerdhen, luante me zogjtë e njomë.

Vogëlushi kurrë nuk kishte parë çerdhe aq afër. Ishte hutuar duke e parë saqë mësimin e kishte harruar fare. Mbas pak erdhi nëna Kumri. Zogjtë hapën sqepat e artë. Ajo u lëshoi ushqim nga sqepi i saj. Zemra e vogëlushit rrahte nga gëzimi.

- Ti që erdhe sot?! - u dëgjua zëri i mësuesit.

Kot. Vogëlushi ishte hutuar duke parë dashurinë e nënës Kumri ndaj të vegjëlve.

- Afrim! - u dëgjua një zë në klasë.

Kot. Ai ishte hutuar duke parë syçkat e zogjve në çerdhe.

- Ty, po të flas! - këtë herë e trembi zëri i thekshëm i mësuesit. Ai u skuq. U ngrit në këmbë.

- Urdhëroni?!

- Ç'je hutuar?!

- Kjo çerdhe kaq e bukur, shoku mësues, më falni...

- Ih, çerdhja, u dëgjua një zë që përherë „ia mban” krahun mësuesit duke u shtrir më i miri në klasë. Mësuesi vazhdoi mësimin. Nuk e qortoi nxënësin e ri. Ne menduam që do ta qortonte, madje, me zë të lartë, por jo. Duke shpjeguar mësuesi ndoshta ka menduar: Këtë mësim që po e shpjegoj do ta mësosh, por çastin e bukur të çerdhes në degë dhe të zogjve s'do të mund ta zësh kurrë më në jetë. Punë e madhe pse s'më ke dëgjuar për disa çaste. Njeriu mëson nga e bukura, nga dashuria, nga puplat e verdha, të arta të zogjve, nga gjethet, nga gjithçka që na rrethon...







### FJALOR

*zgjuar* - i mençur, i ditur

*çerdhe* - fole zogjsh

*puhiza* - erë e lehtë

*kumri* - zog, guguqe

*hutuar* - i habitur



### BISEDË RRETH TEKSTIT

Kush erdhi në klasë?

Kur erdhi nxënësi në klasën tonë?

Ku u ul nxënësi?

Çka shikonte ai ?

Pse ishte hutuar Afrimi?

Pse mësuesi nuk e qortoi Afrimin?



### KOMENTOJMË

-Komentoni fjalët e autorit!

Këtë mësim që po e shpjegoj do ta mësosh,  
por çastin e bukur të çerdhes në degë dhe të zogjve  
s' do të mund ta zësh kurr më në jetë.



### DETYRË

Të shkruhet ese me temë: „Njeriu mëson nga e bukura”

# PËRDORIMI I PIKËS

Njohim gjuhën tonë



## TË MBAJMË MEND

Pika shënon mbarimin e një fjalie si dhe mbarimin e një periudhe me një fjali dëftore. Të gjithë nxënësit shkuan në shëtitje. Vapë. Në shtëpi. Të isha në vendin e tij ndryshe do të veproja. Pika përdoret pas numrave romakë dhe arabë kur shënojmë radhën e një kreu, ose radhën e pikave të një çështje.

1. \_\_\_\_\_ 1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_

Pika vihet në datat e plota pas numrit.

7.03.1887; 7.III.1887 Dita e Mësuesit është në 7.3.1887.

Pika përdoret edhe te shkurtimet siç, janë:

-Pas shkronjës së parë të personave edhe në shkurtesa, p.sh. N.Frashëri, E.Çabej etj.

-Pas shkronjave të para të fjalëve që shënojnë gradën apo profesionin: prof.,dr.,gjen. etj.



## USHTRIME

Veni shenjat e duhura të pikësimit në këtë tekst Afërdita e vogël u tremb në gjumë. Kishtë parë një ëndërr të trishtueshme bërtiti me frikë dhe ja plasi vajit. Ç'të trembi ashtu Afërdita e pyeti ajo me kujdes ujku nënë i tha vajza me vaj në buzë.

Pasi të keni provuar vetë, atëherë bëni korrigjimin dhe shihni gabimet tuaja. (Afërdita e vogël u tremb në gjumë. Kështu pa një ëndërr të trishtueshme. Bërtiti me frikë dhe ia plasi vajit.

-Ç'të trembi ashtu, Afërdita?- e pyeti ajo me kujdes.

-Ujku, nënë!...-i tha vajza me vaj në buzë.)



## DETYRË

Shkruani 5 fjali ku do të përdorni pikat.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

# PIKËPYETJA DHE PIKËÇUDITJA

Njohim gjuhën tonë

*Lexojmë tekstin dhe shohim ku përdoret pikëpyetja dhe pikëçuditja:*

- .....A është ora jote e saktë, këtë deshe ta vërtetosh?  
-As këtë jo. E di se ora ime është e saktë.  
-Atëherë?  
-Njashtu.....  
-Më trego, të lutem!  
-Desha të vërtetoj se a përtoni të shikoni orën kur ju pyet ndonjë fëmijë...  
Ja edhe një shembull tjetër:  
-Nënë!  
-Bir!  
-Dua bukë!  
-Mëma hesht.  
-Nëno!  
- Ngriva!



## TË MBAJMË MEND

Pikëpyetja përdoret në fund të fjalive pyetëse dhe në fund të periudhave me fjali pyetëse. P.sh. Si erdhët? Do të shkojmë apo do të rrimë edhe pak? Pikëpyetja përdoret rregullisht pas fjalive të ndërtuara me përemrat pyetës, me ndajfolje pyetëse ose fjalive të tjera që përdoren si pyetës: **Kush? Cili? Me kë? Ku? Kur? Pse? Ashtu?** P.sh. **Kush** erdhi? **Ku** ishte? **Kur** do të shkojmë? etj. Pikëçuditje përdoret në fund të fjalive ose periudhave thirrmore, pra përdoret në fund të fjalive që shprehin gëzim, hidhërim, habi, urdhër. P.sh. Rroftë atdheu ynë! Gjithnjë të doni gjuhën edhe popullin tonë! Rrofshi sa malet! Ju lumtë, djemtë e xhaxhait! etj.



## DETYRË

Shkruani 5 fjali ku do të përdorni pikëpyetjen dhe 5 fjali ku do të përdorni pikëçuditjen.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*“ O Balë më lër të fle përgjithmonë, këtu në mes të kokave që kam prerë! Më lër të pushoj nën palat e flamurit tim që e kam njomur me gjak dhe I thuaj Skëndërbeut...  
“Edhe i vdekur Pal Golemi do ti tmerroj armiqt “ !*

Aty mbi shkëmbin, që rrihnin valët e detit, plaku Balë me flokë e mjekër të bardhë vazhdonte t’i tregonte nipit ato që i kishte parë e dëgjuar, luftërat që kishte bërë.

Nipi nuk i dëgjonte ato ngjarje, po i përpinte dhe i skaliste në kujtes.

- Më dëgjo , o nip i dashur, se unë kam marrë pjesë në të gjitha betejat.

Kam luftuar përkrah Skëndërbeut e Vrana Kontit, përkrah Lekë Dukagjinit e Arianitit dhe sa e sa princave dhe kapedanëve të tjerë. Pa kam marrë plagë mbi plagë. Janë plagë të trupit e të zemrës për shokët që na ranë, Arbërinë që e humbëm... Edhe në betejën e Vajkalit mora pjesë. Luftuam si luanë e vramë ca më shumë osmanë. Vetëm Ballabanin s’e vramë dot atëherë. Po e vrau Gjergj Aleksi ca më vonë atë qen! Më vjen keq që nuk vrava dot më shumë...Ja për këtë do të tregojë tani, shpirt i gjyshit. Dhe mos harro kurr, gjakun, Arbërinë. T’i duash siç do nënën e babën!

Pastaj vazhdoi:

- Atje, në Vajkal të ngriheshin përpjetë qimet e kokës nga ato që të shikonte syri.

Fjala s’i tregon dot të tëra, po ti shumë gjëra merr me mend. Zjarri e kishte kthyer gjithçka në hi, toka ishte bërë e kuqe nga gjaku, fusha ishte mbushur me të vranë e mbi kufoma krrokatnin korbat.

Një luftëtar arbëresh mbylli sytë në duart e mija duke thirrur: ”Nënë”! Pak më tutje një tjetër trim ishte mbërthyer fytafyty me një osman dhe dukej sikur luftonin me njëri-tjetrin edhe të vdekur...

Bëra nja dy hapa më tej dhe pashë një kalë që tërhiqte zvarrë shalën. M’u duk se kishte të vizatuar një luan me ngjyrë të gjelbër. Zemra më ndolli keq. Diku e kisha parë atë stemë.

Pranë kalit ishte edhe një luftëtarë i mbytur në gjak me dhjetë ushta të ngulura në krahëror. Flamurin e mbante me dhëmbë dhe pëlurën e kuqe me shkaben në mes e valëviste flladi. Në dorë shtrëngonte ende kordhën, ashtu siç e shtrëngonte kur luftonte me osmanët.



As nga pamja, as nga mburoja e argjendtë, as nga shqiponja në gjoks nuk e njoha dot. E njoha nga trimëria që kishte treguar. Ishte Pal Golemi!

U ula, i hoqa parzmoren, i vura dorën në gjoks dhe ndjeva se zemra i rrihte ende. “Qenka gjallë!” - thashë me vete dhe e tërhoqa në një anë dhe i njoma buzët e faqet, i fshiva gjakun. Pali u përmend një çast, më pa me sytë e mjegulluar, buzëqeshi dhe më tha:

- O Balë, më lërë të fle përgjithmonë këtu, në mes të kokave që kam prerë! Me lër të pushoj nën palat e flamurit tim që e kam njomur me gjak, dhe i thuaj Skëndërbeut, mbretit tonë të lavdishëm, këto fjalë: “Edhe i vdekur Palë Golemi do ti tmerrojë armiqtë! Pastaj briri i luftës, ai do të ngrihej dhe do të luftoj tok me ju!”

Pal Golemi buzëqeshi për të fundit herë u mbush me frymë dhe vazhdoi:

- Kam edhe një lutje për ty, O Balë. Unë e di që do të ma plotësosh, prandaj do do të flej i qetë e do të tretem si qiri. Merr mburojën dhe perzmoren dhe vari tek ky lisi që më bën hije. Përmbi do vendos kordhen time. Kur të shkëlqej dielli, rrezet e tij do të bien mbi armët e mija e ato të shkreprijnë. Kur ta shohin atë flakë e atë zjarr armiqtë, do të dridhen nga tmerri. Kur të fryej era natën, ato do të tunden e do të gjëmojnë dhe qenëve osmanë do tu duket se kam ende gjallë dhe do të hidhen mbi ta!

Kaq tha dhe perëndoi sytë. Vdiq i lumtur, se hetën e gjakun ia fali Arbërisë! Thirra shokët dhe i hapëm një varr. E varrosëm me brengë në zemër e me lotë në sy....

Tokë më të varrosëm edhe një pjesë të zemrës sonë...

Pastaj bëmë pak më tutje dhe pamë se drejt nesh po vinin disa luftëtarë me nje trim të plagosur rëndë. Në flamurin që valonte mbi kokat e tyre, vumë re një skifter dhe zemra na u ça në dysh...

Trimi kishte në çafë një plagë të kuqe si shegë e çarë, që i rridhte gjak pa pushuar.

Në ballë kishte të prera jataganësh e në gjoks shigjeta e ushta të ngulura thellë. Si mund të ishte gjallë ende me gjithë ato plagë që kishte marrë? Si i duronte dhimbjet e nuk ankohej e nuk psherëtinte? Preh hekuri të ishte vallë?

Ai na pa me dhembshuri dhe me zërin e shuar na tha:

- Sot është dita më e lumtur e jetës sime. Dua të këndon i të hidhni valle, se kjo është dita e Arbëris fitimtare!

Ai fliste dhe ne mezi i mbanim lotët. S’na qante syri, po na qante zemra!

-O vëllezër më dëgjoni se po ju flet Niku juaj! Mu vërsulën njëqind qenë nga prapa dhe të njëqind po hanë nga kordha ime. Po nga pas më qëlloi tinëzisht Ballaban tradhtari dhe më hapi plagën që më shihni në qafë. Pastaj, kur u rrëzova u lëshuan përmbi mua qentë osmanë dhe ja si më kanë bërë...Më kanë prerë e më kanë grirë, por unë nuk vdes!

- O Balë, shko te nëna ime dhe i thuaj se do ta marrë një rrugë të gjatë e që ska kthim, prandaj të mos më presë...Në vendin tim i lash një bijë i lash Marën.

Të ma ruajë e të ma dojë si vajzën e vet!

Pastaj shkoni e takoni në ballkon bijën e Lalës, që më kujton. S’më harron kurrë e do të më mbajë përjetë në zemër. I thoni se Niku i saj u martua me nje plakë të keqe të zezë prandaj mos të më presë, por të martohet e të gëzojë jetën.

Kështu tha Niku dhe u shua si kandil që s’ka pikë vaj...

Ne po mendonim si ta varrosnim me sa më shumë nder trimin Nik, kur para syve na u shfaq një vajzë flokëlëshuar e fustan grisur, me sy të zgurdulluar e me këmbë të gjakosura.

Sa na pa na foli apo qau nuk e kuptuam dot :

-O vëllezër arbëresh, mos ma patë Nikun tim ?

Ne na u kyçën buzët e sytë na u mbushën me lot. S'thamë dot as një fjalë.

Atëherë bija e Lalës hyri në mes tonë, pa trimin përtokë dhe u shtri në krah të tij duke uluritur.

Fragment nga vepra “ Kënga e sprasme e Balës” - G. Dara i Riu



### FJALOR

*skaliste* - gdhendte, nguliste

*krrokatnin* - bënin krra-krra ( korbat )

*stemë* - shenjë dalluese e një shteti, familjeje ose njeriu

*kordhe* - lloj shpate e shkurtër

*ushe* - armë sulmi e kohëve të kaluara me bisht të gjatë dhe majë hekuri

*mburojë* - pjesë e armatimit në kohën e lashtë e në mesjetë si pllakë e rumbullakët a katërkëndëshe prej metali

*shqyt* - mburojë bakri ( bronzi, lëkure)

*parzmore* - veshje metalike që vishej në krahëror

*briri i luftës* - bri kafshësh që përdorej si bori

*tinëzisht* - fshehtazi, pabesisht.



### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Cili e rrëfente këtë ngjarje ?
- Përkrah kujt kishte luftuar ai?
- Për cilën kohë bën fjalë në tregim ?
- Cilët ishin dy trimat e kësaj pjese ?
- Cili ishte amaneti i Pal Golemit ?
- Cili ishte amaneti i Nik Petës?
- Kujt ia tregoi këtë ngjarje ?



### DETYRË

a) Tekstin ndani në katër pjesë sipas kësaj skeme,plani dhe shkruani fabulën e shkurtër për secilën pjesë:

1. Plaku Balë i tregon nipit ?
- 2.Pal Golemi, qëndrimi dhe amaneti i tij ?
- 3.Nik Peta, qëndrimi dhe amaneti i tij ?
- 4.Kur e pa Mara Nikun të vararë?

### KUJDES

Kërkoni nga mësuesi t'u shpjegojë diç më shumë për poemën “Kënga e sprasme e Balës” dhe për autorin e poemës Gavrill Dara i Riu.

# PËRDORIMI I PRESJES

Njohim gjuhën tonë

*Lexoni dhe vëreni ku është përdorur presja.*

...Paraja është si një aktor, që mban në dorën e vet në marionetë dhe e dredh e përdredh, e zbret, e ngreh, e flak, e uth, e pushton, e shkelmon dhe pastaj e vdes. Marionetë është njeriu. Po, zotëri, njeriu i logjikshëm.



## TË MBAJMË MEND

Presja është shenjë e pikësimit që shënon një pauzë të shkurtër në mes dy fjalëve, dy togfjalëshve edhe dy fjalive.

Presja përdoret për të veçuar gjymtyrët homogjene në fjali.

Presja përdoret për të ndarë fjalitë që përsëriten...

Shembuj: -**Kur u kthye në Krujë, Skënderbeun e pritën të entuziazmuar burra, gra, pleq, djem e vasha.**

Bilibili i bukur, i bukur, sa s'bëhet me këndu.

Në vjeshtë bujku mbledh mollët, dardhët, ftonjtë etj.



## USHTRIME

Veni presjet në këto fjali:

1. Artani vëllai i Mimosës u nis i pari.
2. Besa Vjollca dhe Arta janë në klasë të tretë.
3. Në kuizin e diturisë do të marrin pjesë: Hana Amdiu dhe Agnesa.
4. Sa më pëlqeu blegërima zëri i ëmbël i bagëtisë.



## DETYRË

Në tekstin me titull "Libri mbi princin e lumtur", shkëputni një pjesë, shkruani në fletore dhe tregoni ku janë përdorur shenjat e pikësimit dhe presja.

---

---

---

---

---

---

Lushin e kishin mbuluar djersët mbi një letër.

-Edhe të shkuar që po më bëje! - e ngacmoi motra e tij më e vogël, pasi ia vodhi me bishtin e syrit disa fjalë. Po i haje gjysmën e shkronjave! Ha-ha-ha!

- Nuk e di se nuk bën të lexohen letrat e huaja !? - ia ktheu ai me qortim, pasi s'guxonte t'i përgjigjej ndryshe në prani të prindërve.

Po e keqja ishte se e dinte edhe vetë se një letër e tillë nuk mund të merrte udhë. Le të prisnin shokët dhe shoqet derisa... Mund të mësohej te shkruhej drejt e mirë për disa ditë?! Jo dhe jo, ndaj mësyu për ndihmë Gazmendit, i cili ishte shembullor në hartime.

Gazmendi ia shkroi letrat për Shpendin e për Petritin, ndërsa për Mrikën... Eh, për Mrikën Lushi dëshironte të shkruante tjetër letër...

U mbyll në dhomë dy-tri ditë. Jep e merr. Lexo këtu një fjalë, lexo andej një tjetër. Kot. S'i gjente dot fjalët dhe sidomos jo fjalitë që i duheshin. Nuk i ndihmuan gjithaq as fjalori, as gramatika, te cilat ia solli ndër mend Gazmendi.

Të shtëpisë e shihnin e nuk u besonin syve të vet.

-Po mëson, pëllumbi i nënës, po mëson,- fliste e ëma dhe seç fluturonte nga kënaqësia. Më në fund Lushi e shkroi edhe letrën për Mrikën.

Tamam kur i afrohej kutisë së postës, e befasoi zëri i ëmbël i saj:

-Mirëdita, Lush! - ia zgjati dorën.

Lushi mezi ia ktheu përshëndetjen. Kaq shpejt ishte kthyer ?!

-Si ke qenë? Si kalove këto ditë?

-Mirë, mirë...

-Pse nuk më shkrove, lum Lushi ?

-Të shkrova, por...

-Oh, më fal, - u zu ngushtë Mrika. - Ti më paskë shkruar! Ma jep ta lexoj.

Lushi ia lëshoi letrën në dorë dhe fytyra iu bë lulëkuqe.

Letra e gëzoi Mrikën dyfish. Së pari... kjo le të mbetet midis tyre... dhe së dyti, pse Lushi ishte bërë kureshtarë për fshehtësinë e të shkruarit drejt dhe bukur. Një vajzë as që mund t'i shkruhej ndryshe.

Të nesërmen, kur u takuan sërish, Mrika ia dha një roman me përmbajta shumë tërheqëse.

Lushi ia hyri ta lexonte më tepër për hir të dëshirës së saj, mirëpo e rrëmbeu shpejt bota e heronjëve të tij.

-Ore, a kaq tërheqëse janë të gjitha romanet? - e pyeti Mrikën kur u takuan sërish.

-Posi, iu përgjigj ajo. - Ka edhe shumë më interesante se ajo që lexove. Nuk e ke ditur?!

-Ku ta dija pa e provuar? - ia ktheu me shpoti Lushi.

-Unë mendoja se leximi i librave ishte vetëm një mundim i tmershëm i zbuluar nga arsimitarët dhe prindërit.

Kështu, pasi i qëroi hesapet me riprovim, Lushi lexoi edhe dy libra deri në shtator, pa e kuptuar se ç'kthesë e madhe po bëhej në shpirtin e tij.

Po të tjerët përreth e shihnin. E shihnin dhe kënaqeshin.





### FJALOR

*mësy* - iu drejtua për ndihmë  
*shpoti* - tallje



### BISEDË RRETH TREGIMIT

- Me cilin u njohëm në këtë tregim ?
- Çka i tha motra më e vogël ?
- Kush ia shkruajti letrat ?
- Cilën letër e shkroi vetë ?
- Përshkruaje me fjalët tuaja çfarë ecurie kishte takimi i Lushit me Mrikën?
- Çka kuptoi Lushi kur ia filloi leximit të librave ?

Çka donte të thoshte me fjalët: **“Ku ta dija pa e provuar ?”**



### DETYRË

Lexoni tregimin, shpjegoni kuptimin dhe mundohuni të dramatizoni dialogun që u zhvillua mes Lushit dhe Mrikës.

Pyetje për shpjegim: Sipas temës që trajton si mund ta quajmë këtë tregim ?

-Bota do të jetë një  
Të gjithë njerëzit do të jenë të barabartë  
S'do të ketë uri  
S'do të ketë kufi  
Krahu i Alaskës  
Do të përshëndetet me krahun e Siberisë  
Buzëqeshja e tokës së zjarrtë  
Do të buzëqesh Froideve të Veriut  
Të gjithë vëllazërisht ajrin duke thithur  
S'do të ketë armë dhe atome  
Zogjtë do të fluturojnë të lirë  
Peshqit do të notojnë të lirë  
Nesër në botën e lirë  
Në botën e bukur...





## FJALOR

*Alaska* - shtet në Amerikë

*atome* - grimca më e imët e çdo elementi kimik



## BISEDË RRETH POEZISË

Pasi ta lexoni dhe ta analizoni poezinë do të përgjigjeni në pyetjet e mëposhtme.

- Pse poeti thotë: „Bota do të jetë një “?
- Si duhet të jenë njerëzit në botën e re ?
- Kundër kujt shprehet poeti në vargun “ S’do të ketë armë dhe atome “
- Në botën e re si do ta ndjejnë veten zogjtë dhe peshqit?



## DETYRË

Poezinë mësoni përmendsh dhe recitoni në klasë. Njëkohësisht në klasë zhvilloni një debat në temë: “Çfarë bote duam ne fëmijët “

## KRIJIMTARIA

Bëni një hartim të shkurtër me temë : “ Duam shkolla, paqe dhe liri “.

## KUJDES

Vepra e Adem Gajtani „Lule më lule “ është vlerësuar si njëra nga veprat më të mira të letërsisë sonë për fëmijë. Gjeni dhe lexoni si lektyrë shkollore.

Për rikujtim të përkujtojmë vargjet e Xhoni Radonit

*„ Çdo zog ka këngën e tij ,  
Çdo popull gjuhën e tij,  
Por njëllonj- së bashku këndojnë:  
Luftë- Jo!  
Paqe- Po!*

*Të duam dhe të mbrojmë kafshët dhe natyrën.*

Pulëbardhën në rërë e lagur e gjetëm,  
e kishte thyer këmbën nën gjurin e bishtë,  
e kishin lënë shoqet në bregun e detit vetëm  
e kishin lënë e askush nuk e priste.

Pulëbardhën në dhomën tonë e shpëmë  
e u mësua me ne si njeriu i shtëpisë,  
veç nga dritarja shikonte detin me shkumë  
dhe valën që ngrihej mes shiut e stuhisë.


Jetoi pulëbardha shumë në dhomë,  
po humbi papritur një ditë,  
një ditë kur deti hidhej mbi rërën e njomë,  
një ditë kur vinin stuhitë...

Dhe shkum në det ta kërkonim,  
kur vala me valën si deshët kokan kishin  
përpjekur,  
kur era dhe retë rënkonin,  
dhe gjetën pulëbardhën të vdekur...

E pamë!  
Kish hapur krahët e bardhë në rërën e njomë...  
E pamë!  
Ndofta nuk donte të vdiste në dhomë...



**DRITËRO AGOLLI** (1931) lindi në Menkulas të Devollit Veprat e tij kryesore janë librat me vjersha: “Në rrugë dola”, “Mesditë”, “Udhëtoj i menduar” dhe romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”.





## FJALOR

*brishtë* - e ndryshme, thyhet shpejt

*pulëbardha* - shpezë që rron afër liqeneve e detrave, ushqim i saj janë peshqit.

*rënkoin* - ankohen

*ndofta* - ndoshta



## BISEDË RRETH POEZISË

- Poezia na orienton të duam kafshët shpezët dhe natyrën.
- Në cilat vargje shfaqet ky mendim, ide?
- Pse e kishin lënë shoqet pulëbardhën?
- Sipas mendimit tuaj si vlerësohet sjellja e atyre që e morën dhe e mjekuan pulëbardhën ?
- Pse pulëbardha u largua?
- Ku shkoi ajo dhe çka ndodhi atje ?



## KOMENTONI STROFËN E FUNDIT

„ E pamë !

Kish hapur krahët e bardhë në rërën e njomë...

E pamë !

Ndofta nuk donte të vdiste në dhomë...



## MËSOJMË

Në strofën e parë : në vargun e 2,3,4 përsëriten fjalët...e kishte...Në ato raste poeti përdor figurën letrare- anaforën. Ky është shembull i anaforës.



## DETYRË

Mësoni përmendsh një pjesë të poezisë, Mundohuni të gjeni në libër ose revistat për fëmijë një poezi apo një tekst prozë, në të cilën bëhet fjalë..., pastaj diskutoni në klasë temën e ekologjisë ( ruajtja e ambientit )

# PËRDORIMI I DREJTË I SHKURTESAVE

Njohim gjuhën tonë

Në gjuhën tonë ne shpeshherë përdorim edhe shkurtimeve e ndryshme. Në shënimet e mëposhtme do të ju njoftojmë me disa rregulla përdorimi të shkurtimeve. Shënimi do të ketë për qëllim që t'ju pajisë me njohuri të reja rreth kësaj teme.

1

Emrat e shteteve, të organizatave të ndryshme, emrat e partive të ndryshme politike shkruhen me shkronja të mëdha dhe ndërmjet shkronjave nuk vëni pikë.

P.sh.: RM, SHBA, USHT, NATO, OKB, PTT, UNICEF etj.

Por emrat e popujve, të ditëve të javës, të muajve, të stinëve, të vitit shkruhen me shkronjë të vogël.

P.sh.: shqipëtar, e hënë, e premte, janar, mars, pranverë, dimër.

2

Shkurtimeve e fjalëve si: Bie fjala (b.f) dora vetë (d.v) era e re (e.r) për shembull (p.sh) etj. Shkruhen me pikë pas secilës fjale (shih fjalët në kllapa)

3

Te shkrimet e datave përdorim pikën pas datës dhe muajit: p.sh.: 03.01.1993 ose 02.X.1992, por nuk e shkruajmë kështu: 03-01-1993 ose 02/10/1992

kur shkruajmë data pas emrit të vendit vihet presja dhe data shënohet kështu:

Strugë, 03.01.1993 ose kështu: Strugë, më 2 dhjetorë 1992 etj.

4

Kur shkruajmë emrat e personave pas shkronjës së parë të emrit, kur atë e shkruajmë shkurtimisht përdorim pikën, p.sh. N. Frashëri, F. Konica, M. Isaku etj.

5

Kur fjalët që shënojnë gradë a profesion, i shkruajmë shkurtimisht dhe përdorim pikën. P.sh: prof. Adi Dani, dr. (Doktor Ibrahim Temo) gjen. (Gjeneral Tentim Oxha) kol. (Kolonel Dritan Arifi)

6

Shkurtimeve e emrave të njësive të masave si p.sh: m, kg, l, km, cm, etj; përdoren pa pikë.

## DETYRË

Fjalitë shkruaj shkurtimisht

Republika e Maqedonisë

Organizata e Kombeve të Bashkuara

Ditëlindjen tënde

Dardi ndjeu që në celularin e tij arriti një mesazh. Mesazhi u drejtohej atyre, Kokëgjëmbit dhe Fluturushes. Vinte nga Diellori dhe nga Mareshalli kapiteni i anijes “Delfini i dy deteve”. Ata shkruanin,” E dimë që jeni aty në kalanë e Kaninës.

Tani që po ju dërgojmë këtë mesazh ne ndodhemi me “ Delfinin e dy deteve “ te kepi i Gjuhëzës. I kemi kthyer sytë nga kalaja e Kaninës të bindur që edhe ju tani jeni kthyer me vështrim nga ne...Urime Dardi, Kokëgjëmb dhe Fluturushe ! Urime për vizitën që po bëni në atë kala të rrallë,jua kemi zili”.Më pas, mesazhi vijonte:” Nëse ndodhen aty me ju Këmbëgjati dhe Mjekërverdhi i përshëndetni fortë nga ana jonë. Na ka marrë shumë malli për ata dy. Ata janë kripa e gjellës dhe piperi jetës, era e luleve dhe flladi i detit, kaltërsia e qiellit dhe bluaja e detit, zjarri në dimër dhe freskia në verë, forca e peshkaqenëve dhe shpejtësia e delfinëve,nxehtësia e diellit dhe ngrica e Antarktidës, luani i xhunglës dhe shqiponja e maleve..

Dardi lexonte mesazhin dhe ndihej i emocionuar. një copë herë të gjithë e ndenjën me vështrimin nga gjiri i Vlorës, në drejtim të mezokanalit, atje ku ndodhej kepi Gjuhëzës ku ishte kufiri ndarës i detit Jon dhe detit Adriatik...Atje ndodheshin miqtë e tyre më të mirë: Marëshalli dhe Djellori së bashku me “ Delfinin e dy deteve “ që lëkundej trimërisht mbi dallgë...

\*\*\*

Vizitës i erdhi fundi. U mblodhën të gjithë në një dhomë të vogël që shërbente si muze. Mbi një tavolinë ndodhej një libër përshtypjesh.Gjyshi ftoi vizitorët që të shkruanin përshtypjet e tyre nga vizita në kalanë e Kaninës. Në fillim ai ju drejtua Alfonsos dhe Vladislavit, pastaj Këmbëgjitit dhe Mjekërverdhit.Por ata nisën të grinden përsëri sepse secili donte që t’i lironin vendin njëri tjetrit por këshillat dhe fjalët qenë të kota. Asnjëri nuk tërhiqej.Më në fund, vendosën ta ndajnë sherrin me votim dhe fitues u shpall Këmbëgjati.

Mjekërverdhi u bë xhind nga zemërimi dhe akuzoi kryetarin e komisionit Alfonso, për manipulim.

- Ka edhe vende të tjera ku mund të ankohem dhe të gjej të drejtën që më takon,- tha ai i revoltuar.

I erdhi rradha Këmbëgjitit, që të shkruante përshtypjet,por ai ia la vendin Fluturushes,dhe ky gjest, u duartrokoi.

Ashtu, duke qeshur e biseduar, nisën të lëviznin poshtë kalasë. Dardi, Kokëgjëmbi dhe Fluturushja vraponin për te fëmijët kaninotë. Do të luanin futboll dhe do të bënin gara vrapimi, kurse Fluturshja do të merrte pjesë në sfilatën e modës. Pas tyre vinin gjyshi dhe dy vizitorët e huaj. Ata këmbenin mendime për pozicionin strategjik të vendëndodhjes së klasës së Kaninës dhe kthimin e saj në një qendër të madhe arkeologjike dhe turistike. Në fund vinte Këmbëgjati, që herë-herë shfletonte librin e tij të madh dhe bënte ndonjë shënim plotësues nga ato që shihte rreth e përqark. Pranë tij ecte Mjekërverdhi. Ai kishte nxjerrë pasqyrën dhe krihte

gjithë merak katër fjetet e mjejrës ,që kishin filluar të rriteshin.Një çast,teksa e afroi pasqyrën shumë afër fytyrës së tij, ai lëshoi një klithmë, që i bëri të gjithë të ndaleshin.Por ishte një klithmë gëzimi. Në mjejrën e Mjekërverdhit kishin filluar të dilnin qime të tjera dhe ai, duke u ndier i sigurt,niste të thërriste gjithë gëzim se shumë shpejt mjekra e tij do të bëhej madhështore, si dikur në ditët e arta të saj.

Nisi të fryjë një erë e lehtë. Një tufë zogjsh fluturonin në qiellin e pastër dhe kishin marrë drejtimin nga qendra e qytetit të Vlorës, te sheshi i flamurit,ku mbi obeliskun dhe shtizën e lartë, era valëviste palët e flamurit kuq e zi...



### FJALOR

*ekspedita* - grup studiuesish dhe kërkuesish që punojnë nëpër dete, male, për të hulumtuar diçka.

*manipulimi* - që ndryshojnë të vërtetat dhe rezultatet për diçka

*qendër arkeologjike* - vend, në të cilin punohet për zbulimet e hershme që lidhen me arkeologjinë.

*obelisku* - përmendore.

*mesazh* - porosi në telefon, tekst i shkruar në celular





### BISEDË RRETH TEKSTIT

- Nga i erdhi mesazhit Dardit?
- Çka shkruanin ata në mesazh ?
- Çfarë ishin Këmbëgjati dhe Mjekërverdhi, sipas atyre që shkruanin mesazhin ?
- Ku ndodheshin miqtë e Dardit?
- Pse gjyshi i ftoi vizitorët, pasi mbaroi vizita në kanalet e Kaninës ?
- Çka mendonin ata për pozicionin strategjik të kalasë së Kaninës?
- Shkruani paragrafin e fundit të këtij teksti në fletore ?

Pasi të lexoni dhe të kryeni me sukses bisedën, atëherë mundohuni t'u përgjigjeni pyetjeve duke rrethuar të saktën:

*Biseda u zhvillua në kohën kur fëmijët gjenden:*

- a) në aeroplan
- b) në tren
- c) në anije

### *Pse fëmijët ishin të emocionuar ?*

- a) Sepse njohin sende turistike.
- b) Bëjnë zbulimin e vendeve strategjike si qendra arkeologjike.
- c) Bëjnë kërkime nënujore.
- d) Sepse për të parën herë pranojnë mesazh përmes celularit.



### MËSOJMË

Metafora sajohet kur një fjalë përdoret me kuptimin e një fjale tjetër dhe krahasohet me të, (pa përdorimin e lidhëzes “s”).

### SHEMBUJ

Ata janë: kripë e gjellës dhe piper i jetës, era e luleve dhe fladi i detit. Po në rast se përdoret lidhëza si, atëherë metafora shndërrohet në krahasim. P.sh.: Ata janë si kripë e gjellës dhe si piper i jetës.



### DETYRË

Gjeni dhe shkruani në fletore metaforat tjera që gjenden në këtë tekst.

### *Temë për diskutim në klasë*

Mbresat e paharruara ditën kur e vizituam me shokët e klasës, liqenin e Ohrit ose Kodrën e Diellit.

